

PG 9672

.T5

Copy 1



Class PG 9672

Book .75

Copyright N<sup>o</sup> \_\_\_\_\_

**COPYRIGHT DEPOSIT.**









# TRADHETOR' I KRISHTIT



JESU KRISHTI

Perkthyerë Prej  
SP. A. THOMAJT

FRAMINGHAM, MASS.

1919, U. S. A.





*Thomas, Spere 9*

1

# TRADHETOR' I KRISHTIT



*1154*  

---

*1310*

JESU KRISHTI  
Perkthyerë Prej  
SP. A. THOMAJT  
FRAMINGHAM, MASS.  
1919, U. S. A.

*Thomas, Spere 9*

7

©CLA530639

TERE JETA EGJAKSHME E IUDHES  
SI U LIND SA VRASJE BERI  
SI HYRI DE PALLATET TE MBRETIT IRODHI  
SI E TRADHETOJ KRISHTIN DHE GER U VAR

Perkthyerë Prej  
SP. A. THOMAJT  
FRAMINGHAM, MASS.  
1919  
U. S. A.

PG 9672  
TS

Copyright, 1919

By Spiro A. Thomas

AUG 25 1919

# Parathenje

Me shume se shtate qindra miliune njerës kane gjetur dhe nga ditësh po gjejne chlodhje, pandeme, dhe udhen e jetes se pasketajme qe ish mbushur plot me gëmba, si dhe sot ne mest te renkimeve, chlodhen dene degët te ati drurit se Krishterimit, ay qe mbivi nga vdekja e Krishtit be Kryqin, dhe ati qe gjaku i rodhi ne Golgotha.

Prej ati gjakut se Krishtit u vadit dhe mbivi ay druri qe maren heren e paqme tere keta miliune njerës sot.

Perendia e shume meshirshme, si pa udhen qe kishin mare njerezia, ate udhen me te paudheshme, kuturisi te dergoje fjalen e saj be stere (be dhe) te mare trup njeriu, te rihet, te peshtyhet, te chpohet me shishet trup' i Tij, dhe dyke mberthere be Kryqin ne Golgotha si donje me katili i asaj kohe, te jape shpiritin be Kryqin, te xbrese de Sketeren qe te shpetoje njerezine prej mekatave, dhe te tretën dite te ngjallet.

Po per kete te gjakshmen drame te Golgothase, dhe qe te viheshe themel' i fese se Krishterimit prej Krishtit, undodhe dhe ata qe me tradhetimin te genjeshter, u ngrit be Kryqin te Golgothase shpetim-tari i njerezise dhe uvar, ay qe ka varur stërene be uijet.

Keta surate qyheshin kesisoj. Iudha Iskarioti, Pondi Pilat Igemon (qeveritar), Kryepriftijnte Anna dhe Kaiafa: Dhe prej ketyrve Iudha e tradhetoj, Anna dhe Kaiafa deneshkroanë qe Krishti

te vritet be Kryqin pasi e gykoane verberisht dhe jo me drejtesi.

Katili mi tmershme ish Iudha pas Istorise qe ka shkrojtur ky Chifut i asaj kohe qe rone Krishti i qyojtur Ennea, dhe keto te shkrojtura prej keti Chifutit, ukthyene Latinisht prej nje se parit te vendit se Romes i qyojtur Nikodhimo, dhe prej Latinishtes Greqisht ukthyene prej nje Asketiu ngaj Mali i Shente i qyojtur Averko, dhe prej Greqishtes kthehen prej neve Shqip, ku do te shikojne lechitesit kush eshte drita, dhe si lindet nje njeri katil dhe tradhetor.

# TRADHETOR'

# I KRISHTIT

---

## KRYE I.

---

### PIESA E PARE

---

Pas detit se tiverise gjenche nje i vogle Qytet be nje vent te bukur dhe an' embane shume soesh drure pemesjellesh, njerezia e keti Qyteti me punra te dheut dhe me bageti shkonin jeten e turve shume te lumtur.

Gjashte vjet pa lindur Krishti ronte de ate Qytet nje chifut i qyojtur Rovel dhe i pasur shume.

Ky perpara pak ditesh porsa ish martuare me nje vaize shume te bukur te pasur dhe jo me shume se gjashtembedhiete vjet.

Ntenjesit te Iskarise se keshtu qyheshe ay Qytet, e lumteronin shume kete te lumtur chifut po me shume per bukurine, pasurine, dhe dashurine qe kishin demest te tyrve.

Roveli nuku kish mbushur me shume se njezet egjashte vjet, i bukur, i shendechme, dyke pasur dhe nje emblesi te vechante i bente qytetaret e tij te fjalosen githnje per ate.

Gruaja e tij chifutke e bukur me leshra te gjata dhe te shumta ngyre geshtenje, edhur bi supet e saj pas zakonit te asaj kohe, bente njerezine te thone kudo qe ishikonin, si lum ky chift i dashur.

Nje dite dyke shkuare ky chift be nje vent atje ku undodhe shume qytetare atá qe porsa e pane Rovele me gruan e tij te bukur thane: sate dashur qe jane, Perendia uka dhene tetera temirat, dhe dyke fjalosur kesisoj nje prej atá pyet nje plak qe ish atje prane dhe ekish peshtetur koken be nje stap dyke degyare. Ay fqjinjesi i thote plakut? Thuna xhaxha Iakov nuku eshte ilumtur ky chift;

Edhe plaku dyke pergegyr dhe dyke tuntur koken i thote. Te kota jane tetera sa shikoni, de kete bote sa shikoni jane genjeshtra.

Kush edi se chuare fundje dote kete jeta e keturve njeres qe po i lavderoni sot. Kush edi se chuare farmaqe do kete qe te farmakosen pleqerine eturve ne funt te jetes se turve.

Fjalet e plakut mbaruane dhe fjalet e baskeqytetarve, po ata nuku pushuane se lavderuari shtepine te Rovelit.

Nje mbrema Roveli me te shoqen etij ukthyene nga nje aenk qe ishin thirur prej ca miqve se tyrve dhe dyke kenaqyr shume, e shoqja peshtetur be kraun e Rovelit fjaloseshe dhe e nkiste ate per bi aenkun qe kishin bere, dhe pas shume fjalesh dhe me dashuri te madhe umbylle de odat te flene.

Dy ore paskesaj qe prej Rovelit dhe tere nje-rezia ger be sherbetor' e funtit, te githe ugentne be kembe, dhe te trembur hyne de odat te Rovelit atje ku degjoshe ze prej gruaje dhe dyke qjare thirte dhe chfilitshhe dhe pa si hyne tere sherbetoret de odad te se zotit, dhe porsa pane Rovele qe po mbante te shoqen de dyart etija dhe ajo qjante, pernjeresh kupetuane qe do kete pare do nje endre te tmershme, dhe ashtu pasi i ndimuane dhe bene ate qe muntne zune te iqen. Po zonja Roveli dyke qjare julut te



qendrojne atje ger de mengjest, dhe dyke ardhur ner ment utregoj endren qe kish pare kesisoj.

Pashe si kur linda nje djalke shume te bukur ay qe de nje minute, ube nje gjarper shum i math, dhe me shume koka, dhe dyke apur gojat veshelente me forchat te math, dhe dukshe si kur nxirte zjar nga gojat te pa nemberuara, dhe bente frike te madhe de njerezine. Kete sprie e shikonin tere njerezia dyke mbledur reth, ajo qe dukshe si kur do perpinte githesine.

Pas pak u oth bi Rovele dhe si i chopetoj barkun, jackuli zembren, dhe dyke thethitur gjakun eperpoqi perdhe dhe e shkeli.

Pasi i beri tere keto me njerem goje, shtrijti nje tjtatre koke bi muva, dhe me gjuen e saj me lepinte, ajo qe nuku dukshe te ish aqe etmershme.

Njerezia me frike te madhe dhe me chudi i shikonin tere keto, po asnjeri nuku kuturiste ta vriste a ti afroshe prane se nuku kishin donje arme, po me shume se spria me te shumtat koka i bente njerezine te dridhen nga frika.

De kete chasht daksafise xbriti nje zocke e bukur prej larti si flori, dhe kjo zocke me melludhin' esaj i beri njerezine qe u mallengyene shume nga melludhia qe nuku e kishin degjoare kure.

Zocka ju afrua spries dhe e cimbsi de nje nga kokat me te madhe kur spria pas se cimbsures nxori nje ze kaqe te math sa udrodhe tere njerezia dhe pas zerit plasi, dhe prej asaj qe dolli nje qelbesir' e madhe.

Zocka uduk prape, po si epa qe spria kish plasur, flytyroj dhe me suduk prape.

Kjo eshte etmershma endra teme. Ah? nuku munt tu refej friken qe pashe, dhe me duket si kur ekam perpara gene, oh jam si evdekur, dhe nuku

besoj te mos na ngjase donje e lige, kjo endre me frikeson teper.

Mos ufrikeso, ska gje? erendove shume stomahne dje mbrema, i tha Roveli dyke munduare ta xbutë gruan etij te dashur.

Po dyke thene keto Roveli pesonte me shume se eshoqja, cherja e suratit jundrua, dhe paspak vajti de odat e tij, dhe uplas be nje kanape dyke thene.

Fundja? malkimi i Avraamit ra be shtepine tone, dhe jam sigur q' e keqe e madhe dona ngjase.

Pastaj mori nje flete karte dhe shkrojti endren fjale pas fjale, dyke shinuare dhe ditet, dhe si embylli dolli jashte.

Pse Roveli ufrikesua dhe ay me shume; Kush e beri te besonje qe do tu ngiste e lige de shtepin' e turve;

Pa fjale endra qe pa dhe ay qe ngiste si ajo e se shoqes? po nuku i tregoj asaj se do trembej me shume.

Roveli desh t' aronte endren, ashtu dhe e shoqja, dyke mare me punet e shtepise, dhe dyke shtuare dashurine de Roveli, ashtu nuku kish te mentoshe per liksh.

Pas pak ditesh Zonja Rovel me gezim te math i tha Rovelit qe eshte me bare, po Roveli be vent qe te gezoet, ra ne dyshim me te math, dhe kur upyet prej se Shoqes, i tha qe punra te vechanta e bejne te mentoet pak. Dhe pas ketyrve Zonja Rovel nuku e pyeti me, po Roveli sa vinte dukshe mi eshtur.

Roveli si nje bur' i ditur, dhe pas endres, e dinte qe prej foshnjes qe do lindeshe do vinte e liga per shtepin' e tij, po nuku dinte se e shoqja kishte Iudhen de barkut.

Nje dite kur e shoqja i tregonte, qe shum' here kish dhembje, me frike i tha dhe per dhembjet qe do

iqte ne lindjen.

Roveli dyke lemuare te shoqen itha. Mos utremb, O Edashura jeme, ti do lindesh mire, po e liga do na vije nga foshnja qe do lindesh.

Ah? Rovel, ku i di ti keto;

Te siguroj per kete, se pashe dhe une nje endre si ate tenden.

E shoqja i tha: me keto fjale shikon te me trembesh, po une do duroj se jam e re dhe nuku kam frike.

Roveli ne vent qe te fliste, embaroj fjalen me chesa te puthura de gojen te se shoqes, dhe dukshe mi kenaqur prej asaj, dhe dolli jashte igezuar. Pas kesaj dite qe te dy dukshin me te gezuar, dhe pa durim prisnin ditën te lindjes.

### MAGISTANET

Nuku shkuane shume dit dhe ndenjesit e Iskarise nje mengjes pane de mest te Qytetit de vogle, dy njerës me roba te chuditeshme, po te bukura dhe shume te mbaruara.

Qe nga robat keta dy njerës dukshin te Qyteteruare, te ditur, dhe nga pamja esurateve dukshin t'emble, dhe sillnin nje nder te vechante ne njerezia dhe dashuri. Cillit ishin; prej nga vinin; pse ardhe; si qyeshin; Asnjeri nuku mundi te mbesoje.

Roveli juafrua dhe si udha vathtin, imori be shtepin' etij, si miq dhe te huaj.

Atá vane menjhere de shtepin' e tij, dhe i thane qe jane nga vendet e Anadollit, dhe kane dale vetem per shentetne.

Roveli si njeri iqyteteruare epa tetepre ti pyese me, dhe ashtu ntenj be sofren qe ushtrua me te grenate zgedhura.

Dyke ngrene po fjalosnin per bukurine t'ati Qyteti, kur Zonja Rovel pasi mori ndjese nga te

ftuarit, dyke thene qe, eshte pak paqef shkoj per de Odad e saja.

Te huajte dyke kupetuare qe me pare se Zonja Rovel do lindte ate nate, ndruane nga nje te shikuare de mest te turve pa pare Roveli, dhe ithane Rovelit qe te veje de e shoqja, dhe te mos i duket liksh se ile vete, dyke me qene' e nevojshme te ndodhet prane saj.

Eshte nevoja te ndodhesh prane ithane Rovelit, se kjo nate dotu sjelle nje gje te madhe per shtepine tuaj.

Roveli nuku kupetoj fjalet te se huajve, po kur daksafise api deren nje plake sherbetore, dhe itha Rovelit njady fjale ne vesht, dhe te huajte me njere ungritne te skojne, po Roveli izu per duarsh dhe utha.

O miqte tem te mire, ulutem te rini te bashkegezozoemi se gruaja teme lindi djale, dhe jam shum igezuar se lindi pa te dhembura dhe me shume lethtesi, ulutem rini te kremtojme se bashku.

Te ftuarit e pyetne Rovele. Kush u bente qe kishte frike per dhembjet te lindjes; kishim pare qe te dy nga mje endre te lige, dhe na kish frikeshuare shum' u tha Roveli.

Roveli si utregojti endren, te ftuarit ithane qe vertet, kishte te drejte te frikesoshit per keto endra, po ajo qedo tu ngjase, dote skonje shume kohe dhe vjete, po mbeti te gezuar sot.

Po si muntni te mi chpengkoni keto endra muva.  
O Miq te mire:

De mengjest doti chpengkojme ithane Rovelit, dhe vane te flene se de mengjest do shkonin per udhe. Roveli u refevi Odat ku do flinin, dhe pastaj porositi njerezin' e tij qe ti shikojne mire te huajte, dyke dhene te ane pa ikur, dhe pa ikur ta sqonin dhe Rovele, dhe ashtu ay vajti e pa te shoqen dhe fosh-

njen, dhe si e mori ne duarte dh' e puthi vajti de oden etij te flere.

Pas lindjes te djalit me gith qe ugezuane se lindi me lehtesi Zonja Roveli, dhe foshnja ish e shed-etshme, Roveli gene mentoshe per ato endrat qe kishin pare nente muaj me pare, sikundre dhe nga fjalet tese huajve per endrat.

Rovelit nuku idilte nga mendja fjala mystirioze e se huajve, dhe per andaj nuku fjetei ternatet, dhe dyke mentuare vendosi qete ngriet me nate dhe te bashkoje te dy mystiriozet njerës, dhe per vech endrave, doti pueste, dhe disa gjera tetjera, gith per kete cheshtje, doti pueste dhe per atá prej ngaj vinin, dhe ku do vinin, per udhetimin, dhe cillit ishin.

Pa si umentua tere keto, ngriet dhe thret plaken sherbetore dhe pa si e porositi si ti kenaqe te huajte de mengjest, dha dhe oren qe ti sqonte.

Kur ora ardhi, plaka vajti de Odat, po kur shikon qe nuku kish asnjeri, dhe rendi de Roveli dhe ithote qe te huajte kan' ikur.

Chudi? tha Roveli, edhe rendi vete qete siguroet, po kur hyri ne odat pa qe vertet te huajte kishin shkuare, dhe si hyri ne odet kur shikon be nje softe nje flete karte, me duarte dyke dredhur emori dhe zu ta lechite, ajo qe thosh kesi soj.

### ROVELI TONE IMIRE

Mos kerkosh te mbesosh per neve cillit jemi dhe ku vame, asnjeri nuku do na shikonje, dhe ti kure nuku do mbeshosh per neve.

Evlati qe tu lint dje mbrema dote prishe shtepine tente dhe ti do vritesh prej tij, dhe dote ndynje gjakun tent, pastaj do muntohet te shuanje Fenere te njerezimit po do pervelohet vete, dhe do kete mal-kimin eper jetshme.

**Endra Tente**

**URDHER PERENDJE.**

Letra nuku sillte donje deneskrim po meqe ish shkrojtur prej te huajve Roveli udroth dhe tha: I mjери une? chuare do me ngjase; dhe si dome ngjase; po me gith keto, vajti te shikonje te shoqen dhe porsa juafrua ithote per mystiriozen ikje te se huajve, dhe per te paren here itha se shoqes qe kish pare dhe ay endre si te sajne, dhe prishje e madhe u afroshe. Edhe si jaleciti letren te se huajve se shoqes itha. Be vent qe te me gezoje lindja ekesaj foshnje me helmon shume, dhe duhet te marem masa nje ore me pare.

Nuku shkuane njady minute dhe Roveli sech' i tha de vesht se shoqes, dhe Zonja Rovel me frike dhe me kuides, pasi degoj ato fjalet upergeq. Bashkoem me mendjen tente, bej chke per te bere nje ore mepare sa pamare vesh njeri, po me kuides?

Roveli itha gene chtete them, nuku me besohet te shpetojme gene, po lete bejme keshtu.

Dhe dyke dale Roveli jashte, Zonja Rovel derdhi njady lote te idhur bi suratn' esaj te bukur.

Paspak Roveli vjen me nje sendyq peshtelle me mushama, evuri foshnjen brenda me gith roba, dhe dolli jashte me chpetesi dhe me kuides, dhe mori udhen per ne detin.

Nuku kish shkuare gysme ore dhe Roveli ukthye vetem dhe ichliruare prej foshnjes, se foshnja qe dote sillte prishjen etij, Roveli e odhi ne detit e Galilese. Roveli kur ukthye ne shtepi nuku ish gdhire dhe asnjeri nuku epa, po vetem e shoqja e tij dhe plaka sherbetore, dhe idhane funt qe te thone jashte se atá njeris ishin Magistane, dhe e vodhe foshnjen dhe ikne, se dyke shkuare de mest te nates mystiriozet, e dinin qe nuku ikish pare njeri, dhe ashtu njerezia besuane qe vertet e vodhe, dhe dyke besuare dhe

fjalosur keshtu njerezia e Iskarise, Iudha po plivaste bi dallget te detit se Galilese megith sendyq.

## KRYE II.

---

### DETI I GALILESE

---

Ky det qyheshe prej vendesve dhe Gjoli Genisaret, de kete vent Krishti beri shume chudira, nje vend shume i bukur, sa natura dykshe si kur nuku kish lene donje peme pa mbire, si vendi i bukur ashtu dhe pemet e xbukuronin vendin.

Nje Chifut tha per kete vend qe vetem nje natyre dhe jo tjatr' eben kage te bukur.

Prane keti detit ish nje mburim ku dilte uije shume dhe te paqte, pas mesdite po u epnin uije bagetive se tyrve dy Barijn te qyotur Fodharam dhe Aradhak, kur keta shikuane me chudi nje gje te plivase bi detin dhe po afroshe b' anen e detit. Keta barijnte te kulluare, me njeresh rentne dh' emuare dhe kur shikojne qe brenda de ate sendyq ish nje foshnje.

Barijnte si emuare foshnjen rentne, ta ngrohen se nga te ftotit nuku dukshe te ish i gjalle, dhe pa si e ngroane pak, zuri te qjante me nje ze fare te paket, dhe pa si e deguane qe foshnja nxori ze, ukenaqne shume dhe rentne ti japen qymesht prej dhenve se turve. Foshnja si pivi prej ati qymeshtit, zu i ndritte syte si kur skish peshuaregje.

Ate mbrema Barijnte e muare foshnjen ne kali-vet eturve dh' e qyajtne Iudha.

Me shume se nente vjet pas keturve, jo shume lark prej Jerusalimit nje vend i egert, atje uduk nje njeri i egert vetullat e tij leshuare gjer dene syte,

dhe me ca roba te pa zakonshme dhe me pamjen e tij te egert refente qe ish nje Kusar i tmershme dhe ky ja upinte gjakun njerezive, per kete njeri nuku dote flisnim fare pote mos kish lidhje me Iudhen.

Ky Kusar i tmershme dyke mare nje udhe po Jegjoheshe, barit ore djall, afrou ketu prane, do veme be nje vend lark qe te shpetosh. Ku do veme; lermë ketu, nuku munt te baras, ulodha, upergeq djaloshi.

Nuku munt eh; te besh katilesira munt eh? barit se dote te. . . .po dale se ke te drejte ulodhe qendro ketu te chlodhesh, dhe do kthehem prape tete mar se checharova. Dhe Kusari ukthye me Shpetesi se pa ca njerë qe po vinin, dhe me atá nuku desh te bashkoshe se ethame qe ky njeri pervech qe ish vjedharak dhe gjakpires, kish dhe embrin njeriu i nates, se ky njeri as vatan kish as fe, po vetem malet t' egert kish vatan, po xdo ta bente djalen;

Ky vetem qe do ta shishte per do ca te holla, pa sa per katilesine qe kish bere djali, kaqe ibente ati s' egertit, po vetem q' e umbi djalen shkaku i disa njerësve qe afroheshin, dhe se nuku bariste dot djali me qe kish tri ore qe bariste pa reshtur.

Djali si ulezua nga ky njeri qendroj te chlodhet, dhe po mentoheshe qe nuku desh ta shikonte kete njeri gene dh' emori gjumi.



## KRYE III.

### MBRET IRODHI

Nuku shkuane pak minuta kur arine atje dy njerës atá qe fjaloseshin vechanerisht.

Pas keturve tridhjet a dyzet chapje po vinin donja dhjete njerës te tjere po keta dukshin njerës te urdhrit, se vishnin roba ushtari dhe me arme. Keta kish pare prej largu njeriu i nates dhe me s' uduk ngaj vajti.

Atá te dy njerezit te pare qendruan' atje njady minuta, papare fare djalen, kur njeri eshikon dhe eze per dore ta ngrere, po djali pa apur syte zu revitte dyke thene: lërme ketu, nuku vijn me ty te them; Ashtu ezune te dy djalen, engritne dhe dyke degjuare keto fjale te djalit p' apur syte, e puetne.

Cilli je ti, ore djale, si ugjente ketu; Djali ngriti syte dhe si ipa upergeq. A? jyve ini njerës te mire, une thashe se do me merte gene ay njeriu i egert dhe kam frike se mos vijnje te me mare, nuku me mer ti, be vend te tij; Ky si qeshi pak me djalen itha; dote te mar po te jesh djal' i mire dhe te besh si tete urdherojne mete mbedhejnte.

Ashtu, vertet? vertet? po mos me lene pa ngrene; Jo? Jo? i thane te dy njerezit dyke qeshur. Dhe njeri prej turv' epyeti Iudhen. Pa thuame djali jem, nuku ke printer ti; Kisha po imori lumi, dhe me lane ne te pese udhet.

Djali genjente ketu sich do shikojme me poshte.

Keta dy njerës ishin Mbret' Irodhi dhe i vellaj Filipi.

Ky Irodhi eshte qe irembevi gruan se vallajt Filipit, prej asaj qe lindi nje vajze shume te bukur, kjo

vajze qe kerkoj nga Mbreti si chperblim te nje val-  
leje qe lojti kur Irodhi kish nje aengq dhe qene  
thirur dhe shume njerës te fameshme.

Duva Koken t' Joannit de nje dhisk, itha Irodhit  
e bija pa si epueti Temen.

Mos arojme qe Mbreti si mbaroj vallen vajza,  
ethret dh' e puet chuare do, si chperblim; Qe prej  
gysmes te Mbretërise dhe poshte kerko chte duash?

Pse Vaiza pyeti Temen; dhe pse e Jema, itha  
qe te kerkoje koken e shent Joannin; per keto do  
shikojme me poshte, dhe lete shikojme si hyri Iudha  
de Pallatet dhe si ronte me djallezit' e tija.

### IUDHA DHE PALLATET E IRODHIT

Thame me pare qe Iudha genjente kur itha  
Irodhit qe nuku kish Printer, dhe Irodhi si nuku  
desh ta pyes' ate minute me, dhe si arine dhe njerezit  
e tij qe vinin pas, emuare dhe Iudhen de Pallatet.

Iudha de kete kohe ish nente be dhjete vjet, po  
me gith qe ish kaqe iri, syt' etija ndritnin dhe ish gati  
te jepte chkoqitje per sedo pothuaj qe pyeche prej  
Irodhit dhe se vellajt te tij Filipit, keta qe dyke  
chuditur me Iudhen epyetne.

Ore voc? Chubene Printet tent; vertet rane de  
lume;

Keshtu me thane? po une thashe se me mori  
lumi dhe muva, po kur thone qe tere sa bjene de  
lumen nuk' u mbytkerkan' sesi shpetova prej ati njer-  
iut te egert dhe tashi ndodhem perpara jyve i lumtur  
as une nuku di?

Po site qyajne ore voc; Iudha me thresen.

Nuku ke tjatr' embre;

Chta duva? sado eshte ky.

Iudha pa arire de pallatet dhe perbi keto fjale  
me gith qe ikupetojti se cillit ishin ata njerës sipa

qe ushtaret qe u benin nder, beri si kur nuku idinte, dhe epueti Irodhin. Po Zoterine Tuaj si uqyajne;

Irodhi, upergeq ay: Genjeshtre tha Iudha. Pse; Se Irodhi eqyajne Mbretin tone. Une jam Mbreti Irodhi, dhe ky Zoti ketu eshte vellaj Tem. Dhe Iudha ira ner kembe, dh' e puthi. Irodhi engriti, po Iudha nuku desh te ngrinte as syte te djallshme, gjoja si kur ibente nder.

Irodhi engriti gene dhe itha mos udeshpero po fol pa frike.

Shum' isqyate itha se velajt Irodhi. Vertet upergeq ay. Pastaj si arine de Pallatet, Irodhi ja dorezoj nje prej te pallatit Iudhen dyke thene. Mere kete djall te vogle dhe vishe me roba te bukura dhe ta kesh kujdes, duhet te dergohet de skolle, po ap syte se eshte vete djalli dhe chevalle tjadalesh dot.

Qe ate dite Iudha uvu de radhet me djemt' e Pallatit dhe tere sherbetoret e Pallatit ibenin nder.

Mbesonjes' i Iudhes ish shum' igezuar se Iudha mbesonte shume, dhe padonje ndalim.

Iudha dyke ritur dhe dyke mbesuar, fitovi nje dashuri te vechante de Pallatet prej tere Pallatit po me shume prej Mbretit. Keshtu Iudha zu te mentohet si te arinje shkallen mete larte dhe site benje shume te holla, se ish shume miku i te hollave sich do shikojme me poshte.

Irodhi edesh shume, per andaj e deshne dhe tere Pallati dhe me shume se Iudha dinte te kullandrisesh dhe ashtu merte shume dhurata nga njerezia e Pallatit. Irodhi shume her' ethriste dhe fjaloseshe me te nga ay qe kenaqshe shume dhe i jepte dhurata.

Ta leme ketu Iudhen dhe te kthehemi te shikojme si ube ne shtepin' e Rovelit dhe si ngjajti atje.

## KRYE IV.

### SHTEPIA E ROVELIT

Thame me sipre qe Roveli si evuri de nje sendyq peshtelle me mushama foshnjen dhe ela te plivase bi dallget te detit se Galilese a Gjolit Genisaret me qe kish dy embra ky det, ukthye be shtepin' etij atje ku gjeti sherbetoren te beses Elisavet prane Rahilit se shoqes te tij, ashtu dhe Roveli juafrua se shoqes dhe po ijepte shpresa per ngjarjen t' asaj nate.

Paspak kohe Roveli dhe Rahili pothuaj sede aronin fare dhe ronin de dashuri dhe gezim.

Nje dite uftuane prej ca miqsh jashte Iskarise be gosti, dhe ventosne qe pas dy didesh de vinin, po kur daksafise usemur plaka Elisavet sherbetoria ebases dhe shoqja e Rahilit eperditshme dhe vdiq. Roveli dhe Rahili uhelmuane shume, dhe ashtu nuku vane de ate gosti fare.

Pas vdekjes se plakes Zonja Rovel mbet vete dhe ashtu zu mentoshe gjene per fosnjen qe e um-pne vete.

Keshtu Rahilit zu ti fishket surati nga dit, dhe dukshe qe ish de mejtim te math, kur nje dite Roveli dyke hyre be shtepi ithote se shoqes. Rahil, ja nje dhurat' emire per ty dhe besojn qe te shkosh ditet me gezim: kur shikon Rahili nje grua njadyzet epese vjet, dhe porsa epa i hyri ne zembret, se surat' isaj refente qe ish endershme dh' e dashur, dhe keshtu epyeti Rovele si qyahet, dhe ay itha.

Esthir, po ta duash me gith zembre.

A? idashur Rovel kenaqem shume qe me solle kete grua kaqe te urte dhe te mire.

Kesi soj Esthiri mori deturen esaj te shtepise be punrat dhe silleshe kaqe bukur sa Rahili egezuare shume, edesh pa mase, dhe dyke shtuare dashurine dhe de Roveli ithosh. Jam egezuar tashi: Roveli ekish pare te shoqen me pare qe po fishkeshe dhe ne dyshime po nuku desh ta pyeshe, pasi degjojt ketë fjale te gezimit nga Rahili ugezua dhe ay.

Ish mbushur nje mot pas lindjes dhe pas umbjes se foshnjes kur Rahili dyke pare qe nuku mbeti me bare, zuri gjene te deshperuot dhe thos: Mekata nga Perendia na zuri se prishme ate engjullushke vete, dhe dyke mentuare kesi soj Rahili sa vinte po fishkeshe aqe sa Roveli ufrikesua per shentetin e saj.

Nje mbreme, Roveli dyke pare keshtu nuku judurua dhe eze te shoqen per jake, dhe izemberuare eshkunt njhere dhe ithote: Kam kaqe kohe qe po duroj? Thuame tashi, tashi, perse fishkesh nga ditesh;

Rahili itha, joperse.

Te pyes, dhe te me thuash tashi cheshte shkaku; Thuame chpeto nuku me durohet me.

Rahili si pa qe nuku mundej ta fshinte shkakune me, upergeq. Ja po shkon nje mot qe kur linda djalen ay qe tashi dote ish nje mot, po per vech keti nuku me duket te lindem me, dhe dyke umbur te parin dejale, tashi duket qe Perendja na dergoj mallkimin, se foshnja eshte qe e lith buren me gruan me teper: Dy njeres si kukumjachkat sado dashuri qe te kene, pa femmije eshte kot.

Dushe te duronim pa mos dhene donje rendesi endrave qe pame dhe aturve Magistanve mystirioze, se sido qete jete nga Perendia neve nuku mundet te largoemi, a te fshiemi, dhe chte vinte nga Perendia lete vinte.

Keshtu sot po ta kishme foshnjen dote ishme me te gezuare, ay qe dote ish pothuaj trembedhjete muaj, dhe zembrim' i Perendise nuku dote ish bi neve sot.

Roveli dyke degjoare te shoqen me kujdes udroth, dhe dyke perqjafosur itha. Rahil, kur me thua keto fjale me lendon zembren, dhe dofta ke te drejte po te lutem haroi keto te shkuarat tashi, se per vech donje te lige te mire nuku na sjellen keto mentime, pasa per foshnje ka Perendia.

Keto fjalet e Rovelit idhane funt qe te mos mentoen as mos fjalosen me per keto te ngjara.

Nuku kish shkuar nje muaj qe kur ubene keto fjale ne mest te se dyve, dhe nje mengjes te bukur, dyke ndenjor Roveli me Rahile ne ballkone te shtepise, po shkonin dy njeres te huai, dhe keta dyke shikuare me chudi udhet e Iskarise, po vazgonin udhen, dhe si kur deshne te pyesen donje njeri per udhen etyrve.

Rahili ithote Rovelit. Keta njeres duken te jene te huaj: vertet, upergeq Roveli. Po shiko thote Rahili, njeri ng' atá ka nishan e zise kushedi chika vdekur, ivarfi paska dhe nje foshnje ne duart' etij. Shiko Roveli sa ebukur foshnje shiko sa te bukura leshka qe ka. Roveli thote, vertet duket si donje, engjullushke dhe nuku dote jete me shume se nje mot.

Kaqe do te ish dhe djalka jone, tha Rahili.

Of? thame qe mos fjalosemi me, per te shkuarat tha Roveli. Rahili itha Rovelit, iflasem te shikojme se chnjeres jane; Pse jo: dhe me njhere Rahili ungrit dhe te huaive utha. Te mire njeres, prej ngaj jni dhe ku vini;

Jashte prej fshatrave jemi Zonje, dhe arthme

ketu per ca punrat tona. Kini ardhur tjatre here<sup>s</sup>  
de kete vend;

Jo? heren epare sot.

Ay djalka ikujt eshte;

Jemi zonje, itha ay q' e mbante.

Po per se emerni pas dhe kete te varfe, pse  
nuku elini be shtepi;

Nuku kam asnjri, zonja jeme emire, kush ta  
shikoje; Nena eketi perpara tre didesh vdiq, dhe une  
mbeta vete me kete foshnje dhe me tim vella sich  
na shikon.

Rahilit zu po igodidte zembra, dhe shikovi  
Rovele si kur doti thosh gje.

Roveli ekupetovi dhe me nje te shikuare si kur  
itha bej si te duash.

Menjhere Rahili itha te huaive; nuk' urdheroni  
mbrenda te chlodhi pak, dhe dofta ijni te urtuare;

Me kenaqesi upergeqne te huajte, dhe hyne de  
shtepin' e Rovelit.

Ushtrua sofra, dhe te huajte dyke ngrene, emori  
foshnjen zonja Rovel ne duart' esaja dh' eputhte.

Shiko, Rovel sa ibukur dhe sa isqyate djalkë  
eshte:

Vertet i bukur: Eshte engjullushke tha Rahili,  
po sa mekat, te mos kete nene dhe te jete jetim?

Kur, vdiq gruaja e zoterise suaj;

Perpara tre ditesh.

Ke nje engjullushke Perendia te ta fale. Ken-  
aqem zonje, dhe ky me fatin etij ulind.

Po chta bej qe do sherbim, dhe une mbeta vete  
sich me shikon me tim vella dhe jo gje tjatre, kisha  
pak dhen dhe ato me ngkordhe, kush ta shikonje  
kete foshnje, vetem po te ndodhet donje per shpirt.

Keto fjale ebene Rahile qe te shtere syte be  
te shoqin, dhe si ukupetuane te dy itha mikut. Ke

te drejte ivarfe, dhe me vjen keq, po sa per djalken emar une per djale, ma jep;

Me gezim zonje.

Pas pak te dy te huajte muare nga Roveli cha te holla per shitjen e djalit pa si juzotuane as qe do vinin ta shikonin, dhe jo ta kerkonin me.

Dyke ngritur te shkojne te huajte as qe eputhne djalken, dhe kur po dilnin jashte zonja Rovel tha. A, vertet? si eqyani djalken; Iudha upergeqne. Em-bre i bukur?

Kesi soj shkuane te huajte me gezim, dyke lene Zotin dhe Zonjen Rovel te gezuare megith Iudhen.

### BARIJNTE

Keta te dy njeres qe shitne djalen ne prindet etij, ishin atá barijnte Fodharam dhe Adharak, qe ekishin gjetur djalen de sendyqin pas dëtit.

Fodharami qe kishin dhjete vjet qe ishin martuare po nuku kishin donje foshnje, dhe dyke dorëzuar foshnjen gruas se tij, itha. Martha, te solla nje djalke, Perendia na edergoj, dhe qe sot fati tone do te ndrohet per se mbari, dhe me duket qe do behet nje djalke ibukur, dhe irefevi si egjeti djalken.

Martha ugezua shume dh' eshikonte djalken si nene.

Kur tha Fodharami qe lumtesia do vinte me foshnjen ugenye. Se pas ca kohe si ra semundja be dhente, dhe ngkordhe tetera, nuku shkoj shume dhe usemur eshoqja Martha dhe sado qe umunduane ta shpetojne dyke prishur dhe ato pak te holla qe kishin, vdiq. dhe ashtu mbetne te dy vellezrit me Iudhen.

Me dyket se nara zjari be shtepine tone qe kur muarme kete foshnje be shtepi, ithote Adharaku se vellajt Fodharam.

Ke te drejte, o byrazer? po chta bejme as une nuku di, te shikojme ta japem ne donje famile ta



kete kujdes.

Dhe ashtu te nesermen vane de Iskari sich pame me siper. Barijnte si ulezuane nga Iudha qe uduk-she si donje djall, ndjenin nje chlodhje be zembrat eturve, dhe kur itha Fodharami zonjes Rovel qe ivdiq e shoqja nuku genjente, po genjente kur itha qe ish djali tij, dyke qe ay ekish gjetur, sich epame me siper.

Nje dite dyke fjalosur te dy vellezerija, Fodharami itha Aradhakut. Me dyket se ulargua eliga prej neve qe kur eshitme ate djalen.

Chfjalosesh ore vella, ay ish nje gjarper, nuku ish njeri, kush edi se chdopesonje familja qe jashitme. Po ay ish djall me forme njeriu, na prishi fare, dhe kush edi chdoti ngjase asaj familes se ndershme, po kush ika faj, vet' e kerkuane, neve vetem te mbajme fjalen qe idhame se as do pyesim as do veme ta shikojme.

Keshtu Iudha gjenche ne duart' e prindeve te tij, pa mos ditur ato se eshte djali turve, si kundre dhe barijnte nuk' edinin kete mystir.

### KAINI DHE AVELI

Besoj qe tashi te jesh pa donje renkim itha Raveli se shoqes, se ate qe kerkonje egjete.

Idashur Rovel, nuku mund teta tregoj gezimin tem te math, me duket se qe sot ekesaj dite ardhi lumtesia de shtepine tone, me te ardhur ky djalke ate q' embante ne duart' esaj dh' eputhte si nen' evertete.

Raveli itha, tashi kemi tere te mirat, dhe vertet zonja Rovel ish shum' egezuare, dhe as qe ishkonte ner mend ato te parat, dhe keshtu Raveli megith te shogen dhe Iudhen shkonin jo me mire, pa mos shkuare ner mend qe ay djalka nje dite do perbyste

shtepin' eturve. Pas dy vjesh nje dite Rahili me gezim te math ithote Rovelit qe mbet me bare, dhe Raveli me gezim eputhi te shoqen dhe itha. Vertet lumtesi vjen, ja, kishme nje djale dhe per pak kohe dote kemi dy, nuku te thosha une qe te kesh durim; Eh: se mos kisha faj une; Jo? po vetem zembra jeme.

### DJALI DYTE MATATHIA

Dyke shkuare koha uafua dita dhe Rahili lindi djale, lumtesia dhe gezimi de shtepin' e Rovelit ushtuane, dhe ditën e embrit se djalit qe uqyajt Matathia, ishin mbledhur shume nga miqte dhe soj, anin dhe pinin dhe pergezoin Rovele per lumtesin' eturve.

Iudha pothuaj tre vjesh kur ulind Matathia dhe qe ate dite qe ulind Matathia Iudha refejti zili dhe armiqesi kundre foshnjes se re.

Keshtu dyke shkuare ditet Raveli dhe Rahili eshtonin dashurine per te dy, po Iudha dyke shtuare armiqesine eshikonte nga dit me sy te lik ate.

Iudha ezileps shume Matathine itha Rahili Rovelit.

Djemka jane, dhe dyke ritur do duhen dhe do ujdisen upergeq Raveli.

Nuku besoj te ujdiset Iudha se duket qe ka shume zili tha Rahili.

Oh? Rahil, kur ve re dhe foshnjat per tatilla gjera? Dhe umbyll fjala.

Raveli nuku kish te drejte ne kete, se Iudha vertet nuku desh ta shikonje te vellan' e tij Matathine, idukshe si kur imori gysmen elumtesise dhe pasurise, ashtu Rahili kish te drejte.

Shum' here Iudha egodidte Matathine kur umadhua, dhe pa bere donje faj, po Iudha qe pa goditur

egjende shkleken qe ti thosh prindevete te tij per se egoditi.

Kishin shkuare gjashte vjet per Matathine, dhe Roveli me Rahile kur shikonin Iudhen si sillche me Matathine helmoshin shume po gjene thoshne mundet te ujdisen; dashurija eprindevete ish nje per te dy djemkat, Matathia zembre mir' edesh Iudhen, po Iudha kur shikonte dhuratat qe merte Matathia po jo me shume se Iudha nga prindet etij, sido qe dhe Iudha merte ngabara me Matathine, ay mentoshe dhe thosh, po te mos ish Matathia une doti mernja tetera ato, si dhe pasurine.

Po une nuku duhet te umbas kohe, ky duhet vrare.

Dhe keshtu dyke mentuare Iudha egjeti shkleken si ta vrase dhe temos imbetet bara ati.

Nje dite pas dreke po vinin ne skolle te dy vellezerit, po Iudha edinte qe nuku kish mbesime ate pas dreke se kish mbesuare prej nje shokut te tij, dhe kur uafruane prane skolise dhe usiguruane per ate, Iudha, ithote Matathise.

Vemi atje lart de ate kodret te lozem; Dhe idha pak te emble.

Jo itha Matathia se mos vonohemi?

Jo itha Iudha nuku vonohemi me shume se nje ore, po jake te vemi se ka drure te bukur, dhe une di nje fole me tri zochka, une kam vajtur dhe tjater here, dhe porsa te marem ato shkojme per ne shtepi.

Matathia porsa degjojti per folene me zochka, tha, veme, dhe ashtu shkoane, dhe kur uafruane ne ate vend Iudha idha Matathise dhe ca te emble dhe itha, shko qendro atje dene hije, dyke refere nje shkemb pesembedhjetete kembe te larte, dhe une prej ati shkembit be ate drun' emath doti mar zochkat dhe folene dhe pastaj teti jap tune.

Matathia egelltiti te emblen dhe vajti qendroj dene shkembin.

Iudha si djall qe ish menjhere ugjent bi shkembin, dhe kur shikon te vellane qe ish shtrire dene hijen te shkembit, me sy te lik shikon an' embane, dhe si usigurua qe nuku kish njeri tha, nuku mund te gjej rast mete mire, dhe mer nje gur te math dhe jaleshon se vellajt bi koken, dhe ay ivarfi nuku beri as gek, se guri rende jashtypi koken me njhere dhe ne minutet ugjend ivdekur.

Iudha masat ikish mare dhe per prindet <sup>eti</sup>, dotu thosh me qe nuku kish skoli, vajtne te gjejne fole, dhe Matathia dyke ndejnur dene hije, dhe une dyke ipur te mernja folene urakelle nje gur dh' evravi, dhe keshtu ta ithte baren.

Mire po dyke edhur Iudha gure qe vravi te vellane, uduk nje njeri prane Iudhes, dhe si jashtiri doren bite, tha. Bre, katil xbere ashtu; ky njeriu epa se xberi Iudha, se kish ipur be nje dru dhe ruante de xvishte ca njeret qe do shkonin atje dhe nuku kish shkoare shume qe kish goditur nje grua dhe jakish mare te hollat, po dyke pare si evravi Iudha te vellane tha, ky dote jete mi madhi katil i botes.

Iudha si eshikoj mire ate njerine itha, pse me mban; Nuku e pe ate gure qe urakelle dhe vravi tim vella; Dhe zu sikur te qjante. Po ay njeriu inates itha. Aspokerkon te me genjes dhe muva? Ajde kete: Kush edi se xdote benje ti, si kur te ishe njapese vjet mi math? Ti bekerke per muva, dhe ashtu vertet katili me katile, se po te ish ndodhur donje qytetar be vend te tij, Iudha dote dergoshe de Gjykatoren.

Po ky katili itha Iudhes mos utremb, ajde me muva do tete kem si djale.

Iudha si ekupetovi kete njeri dhe me shume nga robat qe ish i maleve dhe i egert, tha. Prej keti kure nuku mund te kallezohem, se ky nuku bashkohet me njeres. Dhe kusarit itha, qendro ti ketu dhe perkujdesu per trupin e tim vellaj, sate vete ti them ates te vijnje ta mare kete.

Po katili plak dyke kupetuare djallezite te Iudhes qe desh te ike, eperfshiu per xverku mire dhe itha. Je nje gjarper ifarmakosur, je nje egersir' e tmershme, ajde barit chpeto me muva; dhe muare nje udhe.

Njeriu inates edesh Iudhen vetem qe ta shese ne doca kusare te tjere, dhe kur shkonin udhes, Iudha nuku mentoshe fare per te vellane q' evravi, po vetem thosh qe vale do te vete te mar pasurin' e prindeve, dhe kesi soj mallkonde dhe fatin qe ra ne duart' e kusarit. Katilet te dy si baritne me shume se dy ore ne per prejnte, ulodhe dhe qendruane de nje mburim dhe gllaposne nga ca buke te thate qe qish kusari.

Kur unisne per udhe gjene, Iudha ithote kusarit, tine me xvaros shume po une nuku mund te baras sa tyne?

Dhe kur arine be udhen te madhe qe dote ithshin per ne ballet te nje mali tjatre, Iudha qendroj dhe itha une nuku mund te baras me, lerre ketu te chlodhem, dyke shkuare ner mend qe dofta shkonte donjeri, dhe kusari trembshe dh' elinte Iudhen te lire.

Dhe ashtu ube, si kundr' e epame me sipre qe kusari dyke pare se Iudha nuku bariste dot, dhe si pa qe po afroshe dhe Irodhi me njerezin' etij, ela Iudhen dhe ube ipadukur, atje ku egjeti Irodhi dh' emori ne Pallatet.

Iudha dyke hyre de Pallatet te Irodhit, Prindet etij po cfilitnin umbjen e te dy djemve, se nje bari kish pare prej se largu kur e iqte Iudhen ay i egri, dhe dyke rendur bariu nuku epa me te egrin me Iudhen, po kur uafhua be ate vend shikon Matathine te vrare dhe me koke te shtypur, me njhere rendi de qytetin dhe itha prindeva te turve dyke chpenguare si egjeti Matathine te vrare, dhe si te madhe emori nje kusar i egre.

Roveli megith qytetaret besuane qe kusaret erembyene djalen emath dhe te voglin evrane.

Bashkeqytetaret e Rovelit nuku mundnin te gjenin fjale qe ta ngushellonin shtepin' e Rovelin per kete ngjarje kaqe te madhe atje ku nuku degjoshe tjatre po vetem te cfilitura.

Po Iudha qe kish mare vendin e Kainit qe vravi te vellane Avel, keshtu dhe Iudha vravi te vellane Matathine, dhe si hyri de Pallatet te Irodhit as qe shkonte ner mend chkish bere.

---

## KRYE V.

---

### IRODHESHA

Merani kete djallushke dhe visheni mire, dyke dorezuare Iudhen Irodhi denje sherbetore perpara se vellajt te tij Filipit.

Eilipi i vellaj i Irodhit ato ditsh porsa kish ardhur te vizitonte te vellane Irodhin prej Iturie se Trahonise megith te shoqen Irodheshen.

Ituria e Trahonise ish dene urdherin te Filipit, per andaj Filipi te nesermen shkoj per de ate vend, si ela te shoqen te rinte pak dit de shtepin' e te vellajt Irodhit.

Ky Irodhi i qyotur dhe Antipa, ish i biri te madhit Irodhi qe urdheronte tere Paleshtine, dhe ish qe urdheroj te theren tere foshnjat te ati vendi qe prej tre vjesh e poshte pas lindjes se Krishtit, dyke besuare qe bashke me ato foshnjat do therche dhe Krishti.

Antipa Irodhi ish martuare me Areten chupe e Mbretit se Arabise, grua edashur ebukur dh' e kulluare, e ngitur pas se shoqit te saj Irodhit, si kundre dhe populli edesh shume per gjera te mira qe bente.

Irodhi ronte me kete grua jo me mire. Kete rojtjen e Irodhit me Areten, ardhi ta chkateronje Irodhesha e shoqja e te vellajt.

Irodhesha grua e bukur, me bukur nga e shoqja e Irodhit, dhe me bojen te larte ngiste si per Mbretereshe, dhe chuditeshin tere te Pallatit me bukurin' esaj.

Nje pas dreke dyke pare Irodhi sjelljet esaj itha.

Mos duani te me fjalosni per sevda gisendi;

Jo une, po besoj Madhesia Tuaj. Irodhesha dashurine ekish me te madhe ne Irodhi po nuku desh te chfaqeshe sich ekane zakon shume gra, dhe ashtu itha Irodhit. Dajte perenduare djelli tete bashkoj ne gradinet.

Shume bukur tha Irodhi.

Dhe sich perfunduane dajte ngrysyr ubashkuane vertet, dhe Irodhesha dyke dashur ta ngkase dhe si kur ta largonje Irodhin itha: pse nuku ardhi dhe Mbreteresha; Irodhi upergeq. Ca Zonja bashkefjalosen perte ndimuare ca te varfer.

Dhe dyke fjalosur po afronin dhe fjalet e sev-dase, kur shikojne qe dyke rendur po vinte Iudha, dhe si juafrua Irodhit itha. Shiko se chmekadhenë

Mbesonjesi sot, dyke refere ca te embla dhe nje gje perte lojtur.

Irodhesha epyet Mbretin. Ikujt eshte ky djale kaqe isqyate; Irodhi dyke shikuare te shoqen e te vellajt de syte itha: eshte djali Tem. Irodhesha dyke shikuare Irodhe itha. Thuame te lutem, cilli eshte ky; Dhe Mbreti dyke qeshur ja tregoj tetera si egjeti Iudhen dh' emori de Pallatet.

Po Iudha nuk' umbet as minuten sido qe up-rishi fjalet e dashurise, epyet Irodhin. Cilla eshte kjo Zonje;

Irodhi itha, Mbretesha, nuku enjeh; Po Juve me treguate nje tjatre Mbreteshe, sa gra kini, dy;

Ashtu po kjo esht' everteta. Nuku eshte me bukur;

Vertet me bukur prej asaj tjatres, tha Iudha. Irodhesha dyke degjoare keto fjalet te Irodhit me Iudhen, ukenaq dhe aqe lartesoshe perpara Irodhit, dhe me ne fund si baritne dhe pak ukthyene ne Pallatet.

Kur ushtrua tryesa per darke zembrat te se dyve dridheshin nga sevdaja dhe dashuria, po asnje nuku chfaqeshe, dhe qe te dy Irodhi me Irodheshen dukshin ne dyshim, po me ta dukshe ne dyshim dhe Areta eshoqja e Irodhit dyke pare te shoqin me nje dryshim, dhe kish te drejte, se kupetovi sech rithte, dhe dote chkatroshe dashuria me Irodhe dhe tere Pallatne.

Po dyke gotitur zembra e Irodhit dhe Irodheshes per dashuri, zembra e Aretes pesonte qe shikonte prishjen esaj dhe te Pallatit.

Iudhes i kish thene Irodhesha kur ishin me Irodhe ne gradinet, qe ta vizitonte de odat esaj, se doti jepte ca dhurata, dhe Iudha nuku haroj te vizitonte Irodheshen, po te nesermen evizitoj, dhe si



mori ca dhurata nga Irodhesha zu te dale, po Irodhesha epyet, ku do vech tashi;

Dote vete de Mbreti ti refejn dhuratat?

Po xdo ti thuash;

Mir dita?

Jo, ti thuash kujdes?

Po pse; xdomethene ajo;

Thuaj ti keshtu dhe dote qeshe. Kujdes? itha Iudha Irodhit me te hyre. Bre; ku embesove ate; Mathane, Tja uthem: ajo Bbretheresha qe ish de gradinet, dhe ja ku medha dhe keto dhuratat per muva.

Irodhi igrity vetullat se chech kupetovi me ate fjale. Irodhesha kish lajmeruare menje nga sherbetoret qe nuku do vinte be tryeset per darke se ish paqef, per andaj dhe Irodhi nuku shkoj ner mend gjesendi me qe kupetovi nga Iudha me fjalen kujdes, dhe tha, qenka shume erbabke. Areta kur pa qe nuku bashkoshe Irodhi me Irodheshen, ugezua dhe tha qe shkoj reha ezeze, po jo, se ugenye? Iudha hyri de mest, merte dhe sillte lajme dhe letra per te dy.

Apsyte itha Iudhes Irodhesha, po tete pyese njeri gjesendi ti mos apesh donje fjale.

Me shume nuku desh mbesine Iudha, dinte vete ay, dhe per vech kesaj, ish shum' igezua ipaudhi se isherbente Mbretit.

Kesi soj pas pak ditesh imbesoj tetera Areta si dhe tere Pallati ato qe benin Irodhi me Irodheshen, dhe si uplasi cipa enxuare dhe vete de shesht si pa donje te keqe.

Dyke bashkuare Irodhi me Irodheshen sheshit, Mbretesha Areta usemur nga ky shkak, dhe nuku

afronte njeri tjatre de oden esaj, per vech dy sherbetoreve te beses.

Pas pak ditesh Irodhi mori chesa letra prej Ates se Aretes Mbretit se Arabise, si kundre dhe prej se vallajt te tij Filipit atá qe egoditnin ashperisht per paudhesite qe beri, po Irodhi asqe u jepte donje rendesi ketyre letrave.

Nje dite Mbreti Arabise dergoj ta mare te bijen, pasi te dilte ger ne kufite me njeres te beses qe kish pas e bija, dhe ne kufite ne deti ivdekur nje shumice oficere dhe njeres te Pallatit se Arabise epritne me nder, dhe emuare.

Nuku shkuane shume dite, dhe Mbret' i Arabise ideklarroj lufte Irodhit per kete paudhesi, dhe ushtaret e Irodhit pesuane umbje te mbedha, sa popull' i Irodhit renkonin sheshit bi te, dhe protestoshin kundra Tij. Po pak kohe shkoj, dhe lufta mori fund dhe populli aroj te shkuarat.

---

### SALLOMI

---

Kesi soj Irodhesha ube Mbretereshe dhe dashuria me Irodhin ish pa mase. Kur nje dite, itha Mbreteresha Irodhit q' eshte me bare, shume bukuri tha Irodhi, trashegimtari dona eforconje dashurise, pasi dote kete pasurine tone do trashegonje dhe frone.

Kur ardhi koha ulind nje vajze dhe uqyojt Sallomi megith qe ulind chupe, Mbreti dhe Mbretereshua ugezuan teper sa ukremtua dita esaj.

Dyke shkuare koha vajza me leshra ngyre geshenje po riteshe, ate q' edeshne shume Mbreti dhe Mbretersha, po edeshne dhe Iudhen jo me pak se Sallomin.

Nga q' edeshne shume dhe Iudhen, sa here qe dilte Sallomi me sherbetoren e saj, vinte dhe Iudha me lehen te Irodhit.

Sallomi mbushi shtate vjet, dhe Iudha githnje dilte me ate dhe nga donjhere pa sherbetoren. Kaqe ustervit me Iudhen Sallomi, sa githnje edesh pas, se Iudha ibente shume lodra dh' ekenaqte, sa mbremanet Sallomi itregonte prindeve te saj, dhe dukeshe shum' ekenaqjur. Keshtu kenaqeshin Mbreti dhe Mbreteresha, dhe Iudha shtonte dashurine ner ta.

Kur Sallomi arijti te dhjete vjetet, Iudha ish njezest vjet dhe kish mbaruare mbesimet etij nga skollat.

Ashtu dhe Sallomi qe prej dhjete vjehc ila mbesimet, dhe kur dohere qe dilte jashte, emerte dhe Iudhen pas. Iudha kaqe besim kish nga Irodhi, sa mori vend de Pallatet si arketar, dhe shume here Irodhi irefente gjera te fsheura. Iudha si mori kete shkalle, shume here irefente Irodhit si mundte te kur-sente te holla nga te prishurat eshumta te Pallatit be kot, dhe tashi Iudha dukeshe nga te sjellat mi larte se me pare, dhe fjale jo me kedo.

Dyke pasur kete shkalle Iudha, mentoshe t'arin-te shkalle me te larte dhe te mos kupetoshe, per andaj nuku desh te fjaloseshe me kedo.

Me te ketilla sjellje Iudha i umbi tere miqt' epare, dhe vettem prej Sallomit duheshe, me kete qe uritne tok, mire po Sallomi tashi ish trembedhjete vjet, dhe qe te dy me Iudhen endruane dashurin' epare. Tashi ndjenin ndruse, tjatre soj dashuri, ugoditnin zembrat dryshe, se hyri sevdaja de mest te se dyve.

Sallomi kur shikonte Iudhen ndjente nje tjatre, nje gje te fsheur be zembret.

Iudha ekish kupetuare Sallomin mire, po nuku desh te refeshe, dhe nga donjhere nuku vinte jashte me Sallomin, dhe ithosh qe nuku kam ngke, dhe kam pune, sa eberi Sallomin qe chfaqi sevdane dhe dashurine per Iudhen. Iudha mentoshe dhe thosh. Ketu kam nje fat te math, Sallomi me do, te behem dhen-ter i Irodhit, dhe ashtu fitoj Sallomin dhe tere pasurin' etij.

Fati ger ketu me ndimoj, dhe ashtu do me ndimoje ger sa te mbush deshiren teme.

Endrat etij dyke mentuare Iudha, bente sikur nuku kish gje me Sallomin, po gith mentoshe.

Nje dite Sallomit nuku judurua dhe Iudhen epyet. Dukesh de mentim, Iudha, muntet te mbesoj shkakun; Dhe zembra e Sallomit zu godidte me shume kur juafrua Iudhes.

Jo gje, po vetem per nje llogari qe doti dorezoi nesre Mbretit, qe me kete logari muntet de kursenje a te fitoje dy tri mij lira ne mot.

Shikoj qe re pas ikonomise dh' e umbe ate ncheljen qe kishe me pare.

Eshte detyra jeme per kete pune, se per andaj me ka dhene besimin Mbreti, O elarte Prinxese?

Ipaudhi dinte se xbente.

Sallomi itha. Po nuku mentohesh, se per vech logarive, ke dhe tjatre detyre;

Dofta po vetem koha. . . . .Nuku ele kete kohe, dhe te dalem te ndrojme pak heren; O? me shume kenaqesi, elarte Prinxeshe, dhe dualle dyke barritur.

Po qe kur Iudhe ubere kesi soj ne sjelljet tende; Apo qe kur ubere arketar i Pallatit;

Iudha kupetoj pernjheresh dhe upergeq. Jo elarte, me mohoni keshtu, une nuku jam pervech nje sherbetor ibeses de Mbreti, dhe krye unjur de larte-

sia Tuaj, dhe dyke mbaruare porosite te lartesisë Suaj, kesisoj, dhe de kam donje nihet, nuku mund ta chfaq dyke qen' i bindur dene urdherit te lartmadhesisë se Tij Mbretit dhe atit Tuaj.

Vertet miku tem me lidhe me keto fjale, po une nuku dote fjalosnja kesi soj po te mos nijshim qe de vogeli, dhe un' edi qe áta dhe nena te duane ty.

Keto fjalet e Sallomit ishin mja per Iudhen, dhe tha qe, dashuria eshte pa mase. Dhe vertet Iudha kish te drejte qe te mos zgjateshe shume per dashurine me Sallomin, se puna etij ashtu edesh, ate q' ekupetoj dhe Sallomi.

Tregome donje pralle ng' ato te parat tashi si tu chfaq, apo je izemberuare; Une; Dhe de mest tone; Kure donjhere? Une dyke pasur lartesisë Tuaj bi kry' e sipre, jo vetem qe nuku zemberohem, po dhe jeta teme eshte ne duarte Tuaja, per andaj o engjell i dashur, u athom keto qe te mos me mohoni.

Sallomi kur degjoj fjalen engjell, ukenaq shume, dhe keshtu dyke shtuare dashurine, ukthene prape de Pallatet. Iudha me Sallomin bashkoshin me dendur pasketaj.

Irodhësia dyke kupetuare dashurine dhe sev-dane te Iudhes me Sallomin, u egersua nga zilia, dyke edhur sev-dane dhe ajo be Iudhen, dhe priste rastin qe tu prishte endrat te Iudhes me Sallomin.

Keshtu Iudha uthir de odet te Irodhësies, dhe Iudha dyke hyre dhe dyke unjur pastaj qendroj be kembe dhe priste fjalen e saj.

Te thira te me chkoqitesh ca gjera itha Mbret-erësia. Tradhetim? tha Iudha me mendjen e tij.

Dhe Mbretëresia vazgoj, kam shume kohe qe po kujdesem per ty, dhe me dukesh shum' imentuare dhe si pa shpirt.

Tashi thuame, chke; Ti djale ne lulezimin njezet ekatre vjet dhe i bukur, prane neve je, besimin tem dhe te Mbretit eke ploterisht, si kundre dhe dashurine dhe me duket se pasketaj dota kesh dhe fatin shume te math.

Jo, tha Iudha skam gje, po vetem per punrat dhe deturen qe pata fatin te kem besimin de lartesia Tuaj, si une qe isha nje djale i lene ne mest te udheve. Iudha genjente ketu. Jake ketu leri ato ashi, ato fjale nuku jane per ty, fati tent eshte imath.

Afrou prane dhe ri ketu te chpengohemi.

Kur uthir Iudha te rinte prane Mbretereshes dhe dyke qene vetem te dy, Iudha ufrikesua se mos binte de gracket dhe Mbretereshes itha.

Me lehen Tuaj duva te qendroj be kembe. Kjo fjale e ashperoj Mbretereshen, dhe dyke ngritur itha, une desha te mbesoj shkakun te eshtjes tende dhe ti kerkon ta mbash te fshehur, po un' edi semundjen tende, dhe shko jashte. Dyke refere deren me dore.

Iudha vajti de glykatoren (shkronjetoren) etij, dhe si uplas benje fron, tha. Utradhetuame dhe endrat uprishne. Po jo? tha paspak minutash, do te leftoj dhe me kete dhe dota mund.

Mbreteresha si dolli jashte Iudha, ardhi ner mend nga pesimi qjor, dhe si ekupetoj fajn' esaj tha, shum' unxitova, dushe ti jepnja kurajo, po adje pa e ujdise gene une.

Ate mbrema Iudha nuku vajti be tryeset per darke, nje sherbetor utha qe Iudha eshte pa qef ukerkon ndjese.

Shendet, thuaj nga muva tha Mbreteresha.

Dhe Irodhit itha, nje bashkefjalim kishim me te, sech e pyeta, dhe me qe sme tregoj, i fola pak rende. Ja tha keto Mbreteresha qe te refeshe epaq-

me de Irodhi, dhe Irodhi ti thosh Iudhes q' ajo te sillet si nene. Te nesermen Irodhesha ebashkoj Iudhen, ay q' e unij koken porsa epa. Jake ketu Zot itha, une sete duame shume, perandaj te pyeta ato fjale die, dhe nuku mora donje pergegje, po pasketaj te sillesh me mire.

Iudha zu te mentohet, Mbreteresha sevda, chupa sevda, Mbreti besim dhe dashuri, tetera per muva jane tha, po cillen udhe te ze; Me dyket po te kem dashuri me Mbretereshen ashtu do ti kem tetera te mirat, jo po skam dashuri me ate, tetera do perbysen, dhe keshtu idha fund qe te kete dashuri me Mbretereshen, qe te mos umbiste dhe Sallomin trash-egimtaren e pasurise.

Kesi soj Iudha ate mbrema vajti i nchelet per darke pa si uthir nga Irodhi.

Tere ishin te gezuare, po me shume Irodhesha se epa Iudhen q' ekupetoj gabimin, po dhe Sallomi se ajo thosh qe Iudha gezoshe me te, keshtu dhe Irodhi pakupetuare gezoshe se tere ishin de gezim.

Gezimi ish pa kufi, po nga fjalet te Iudhes de Mbreteresha, Sallomi sech kupetoj dhe tha, duhen mare masa.

---

## JOANNI PAGEZIMTARI

Shent Joanni ronte anes lumit Jordhan de kete kohe te Irodhit, dhe atje de ate lumet Jordhan, ithirte njerezine dhe i pagezonte, dyke thene dhe fjalet te bukura te njerezimit.

"Pendohuni se Mbreteria e Qjellit po a afrohet." Dhe kesi soj Joanni Pagezimtari udigua ne tere ato vise, sa njerezia githnje mblidheshin te degjonin fjalet etij te shenta, dhe te Perendise. Ky profet nuku afroshe qyteteve as fshatrave, po vetem de shkretetirat prane Jordhanit.

Pagezimtari vishte per roba qime prej gamile, dhe si bres nje chope lekure, dhe ronte me mjalte t' egret dhe me nje soj bari i qyotur kreke, dhe jo me karkalece sich doane te thone ca.

Kete Profet kur degjoj Irodhi qe ivinin kaqe njerës pas, dyke degjoare fjalet e tij dhe pagezoshin, dyke goditur dhe Irodhe qe i rembeu gruan te vellajt, urdherovi ca oficere te vene ta zene dhe ta edhen ne burg, po pa pare njerezia, se kish frike se mos ingrinte krye populli me qe ishin gati per ato gjera qe bente Irodhi de Pallatet dyke rembyere gruan e te vellajt dhe tetjera.

Irodhi nga keto pa udhesite qe beri dhe si pa qe populli renkonte bi te, kish vajtur me gith te shtepise de Pallatet te vechanta ne Mahor, dhe ketu dyke kremtuare ditn e lindjes se tij, kish thirur dhe shume njerës te larte. Pasi hengren epine lojtin dhe valle, uthir dhe Sallomi prej Mbretit te loze valle, dhe vallja e kesaj ichuditi tere. Irodhi kaqe ukenaq sa ethiri Sallomin dhe itha. Qe prej gysmes se Mbretëris' eposhte kerkome chte duash. Sallomi me qe nuku dinte chtekerkonte, vajti te pyese temen, ajo qe itha te kerkonje koken e shent Joannit ne dhisk. Shkaku ish se ay Profet' i math godidte paudhesit' e turve, dyke lene ajo te vellan' e Irodhit Filipin dhe umartua me Irodhe, dhe per andaj jukerkua koka de dhisk se Irodheshes nuku i vinin mire fjalet te shenta te Profetit, dhe ashtu Sallomi i kerkoj s' atit koken e shent Joannit de dhisk. Po Irodhi u abit per kete dhe nuku desh qe ti priteshe koka shent Joannit, po si pa qe nuku mundte te bente dryshe se kish dhene fjalen ne mest te njerezive, ashtu urdheroj nje katil qe i preu koken shent Joannit de burg dhe ja solli perpara Mbretit dyke dorezuate Sallomit, dhe ajo me gith te d' e jema. Po posa hyri de odet de e jema



syte te Profetit dhe goja u apne dhe tha “pendohuni, pendohuni,” dhe ashtu Irodhesha me gith Sallomin rane perdhe si te vdekura, dhe vetem gojat lonindyke thene “pendohuni, pendohuni.” Iudha kur degjoj qe Sallomi kerkoj koken e shent Joannit dhe jo gysmen te Mbretrise, ish bere s’ i prishur mench dhe tha, Mendje grash, kerkoj koken te njej te xbathuri ate q’ emernja une kur dohere. Po kur daksafise hyn nje sherbetore dh’ e thret Iudhen, ay qe i vajti pas sherbetores, dhe dyke hyre de odet kur shikon Mbretreshen dhe Sallomin gysme te vdekura, dhe thoshne “pendohuni, pendohuni” pa reshtur. Dhe de pak minuta Mjekesit ish in bi kokat eturve po be kot, ger ardhe nder ment shkoane njezet e katre ore me ato fjalet ne gojat. Dhe Iudha iporositi atá qe undodhe atje Mjekesit dhe sherbetoret, qe te mos refejne ato qe pane, dhe fjalet qe nxirnin Mbretresha me Sallomin.

Kesi soj aengku mori fund dyke prere koka e te madhit Profet, ay qe pageztoj dhe Jesu Krishtin shpetimtare te njerezise.

## KRYE VI.

---

### ATVRASESI

---

Te nesermen Irodhi ungrit me koke te rende, ca nga qe kish pire vere shume, dhe ca nga nje endre te frikshme qe kish pare dyke revitur ternaten.

Kish pare sikur plivaste denje det te math dhe si kur ish peshtelle prej dallgesh te mbedha dhe te zeza, dhe ato qe dukshin si kur dota perpinin.

Me tutje pak shikonte nje drase, afroshe dhe desh te zishe per te, po drasa merte forme anxari dhe nje koke ngkulur be te dyke tundur.

Kur usqya Irodhi tha, kush u jep rendesi en-drave, jane nga lodhja e mbremshme. Pyeti per Mbretreshen dhe Sallomin dhe ithane qe jane semure.

Kur vajti te shikoje dhe si jatregoane ngjarjet tha. Jane frikash prej grash. Dyke ngjare keto de Pallatet de Mahor dhe atje ku ish burgosur shent Joanni dhe me qe Irodhi ish eqjur nga Pallatet e Jerusalimit nga frika e popullit, te nesermen Iudha uporosit nga Irodhi qe te shkonte per de Jerusalem se ish nevoja.

Pasi ardhi Iudha de Pallatet dhe mbaroj punen ate dite, te nesermen kur vajti ne glykatoren (shkronjetoren) dhe shtiri syte prej afsanes (dritares) se tij, dhe kur shikon de nje japi te madhe dhe te bukur, ate japi (shtepi) qe ekish nje i pasur chifut, dhe ay qe kish nje mot qe kish vdekur, dhe nuku rinde asnjeri de ate dertese po vetem ay q' eruante me te shoqen etij.

Ivetemi trashegimtar i kesaj dertese, ish vetem nje djale i ati chifutit te pasur, po ky kish shkoare lark pas vdekjes te s' atit.

Irodhi me Iudhen edinin fort mire kete, se Irodhi kish kohe qe desh ta rembeje, me qene se gradina (kopsha) e Pallatit se Irodhit me gradinen e kesaj stepie nje garth prej ekuri indante.

Iudha dyke ditur qe nuku rinte njeri de ate japi, dhe dyke shtene syte ate mengjes, daxafise shikon be nje ng' afsanat te asaj japie nje grua te bukur, ajo qe po shikonte me verejtje an' embane.

Kjo gruaja ish njadyzet vjet, po dukshe sikur ish njezet epese d.m.dukshe me re sech ish, dhe me bukur.

Bukuria e saj Iudhen egoditi be zembret, dhe me njhere thiri nje nga sherbetoret te Pallatit dh'

e pyeti, cilla eshte ajo grua; esht' e re porsa ka ardhur.

Si, umartua djali Sollomonit pa mbushur motin i jati qe ka vdekur; Jo? Nuk' umartua, po kete dertesen eshitne de keta fqijnte te rijn. Mbesove kur uble dhe ushit kjo japi; Asnjeren astjatren edi, upergeq sherbetori, une di qe perpara ca ditesh djali tij Josifi ardhi ketu megith keta njeres, dhe si uvendosne keta brenda, ay shkoj gene per de Arabi, atje ku dote qendroje per githnje.

Po si i qyane; Ruvim Rovoam, nukudi?

Dote jene te pasur me vertett, porsa qe blene keto Saraje prane Pallatit, dhe Saraje si keto qe nuku mund te blere si cilli.

Keshtu duket, dhe fqijnte rotull ashtu thone. Njeres te kuturisor, tha Iudha, dhe fjala me sherbetore mori fund. Iudha per keto pyetje kish dy fjale vetem, epara ish se porsa epa ate gruan jungkul nje perone be zembret, dh' edyta se ate Saraje desh ta rembente Irodhi po me donje shkak, dhe Iudhes i kish thene shume here per kete dertese.

Te nesermen Iudha dyke shtene syte reth asaj Saraje, epa gene ate gruan, po kete here juduk me bukur, dhe sa e shikonte dhe aqe me bukur idukshe, po ajo asqe shikonte nga Iudha fare.

Iudha dushe te shkonte per de Irodhi gene si mbarojti punen etij te Pallatit, po per shkakun te kesaj gruas nuku shkoj ne Mbreti, dhe ashtu thiri nje oficer, dhe pasi shkrojti nje letre per Irodhin itha: mere kete letre dhe dorezoja Mbretit. Letren eshkrojti kesi soj.

### Lartmadhesi

Porosine Tuaj embarova dhe tetera vene mire.

Njerezia duken te shtruare, dhe te githe kane mare udhen e bute. Me kete mendje jane dhe ofi-

ceret Romane. Pas ketaj nuku kam chte bej, po vetem te vijn atje prape, qe tu chpengoj ca gjera.

Per kete shkak do te mbetem dhe njady dit, keto q' enderesojne dhe Madhesine Tuaj, duva te them per ate dertesen e se ndyerit Sollomon, dhe per kete qe me kishte fjalosur dhe tjatre here.

### I Beses Sherbetori Tuaj Iudha

Mos humb asnje minute itha Iudha oficerit se ashtu eshte puna.

Oficeri shkoj igezuar dyke ditur q' i sherbente Irodhit. Iudha pastaj mbylli deren dhe zu te mentohet, dhe pasnja dy minuta tha. Shume bukur, mentim i mire? mekete letre Irodhi do mbesoje qe porosia e tij umbarua si edhe shkakun qe mbeta ketu.

Tashi te shikojme me kete Fqijnken te bukur qe nuku na kthen as syte fare.

Vertet esht' ebukur dh' e emble po pasuria eben me te emble dhe me te bukur.

Duket te kete shume pasuri, po ajo pasuria duhet te behet jemja, dhe do behet do e mos.

Sa per Irodhin q' e ka syne be kete saraje, e ujdise, pa si te mbaroj qellimin tem, se ay ka pasuri te madhe, grua te bukur vajze te bukur, une skam asgje prej ketyrve. Pasi nuk' umartova me Sallomin, tashi lete martohem me kete Fqijnken te bukur, dhe te marem pasurin' e saj, pastaj shikojme dhe bejme.

Tashi duhet te mbesojme chuare bure ka, donje plak apo donje te ri, se kjo duzetarke ska mbesuare se me thone Iudha muva. Dhe keshtu Iudha zu te pyese per embrin dhe per lagapin po nuku mbesoj dot se atá kishin ardhur te rijn dhe te huaj ne Jerusalim.

Oh? tha Iudha chmeduhet muva te mbesojn per embrat dhe prej nga jane.

Ate pas dreke shikon te dale nje leshbardhe

bure, bukur veshur, dhe ay qe dukshe te ish njapedhjet' e shtate vjet, po ebaritura etij refente te ish njadhjete vjet me shume.

Mos vonoesh, ithiri ajo gruaja ng' afsana. Ama ky qenka buri tent; tha Iudha? Shume chpeto dotte bjesh ne duarte teme.

Iudha nuku mundte te rinte me shume se dy dit atje, dhe shkoj per de Irodhi. Pasi idha chkoqitje Iudha per shume gjera Irodhit itha. Duani te mbesoni dhe per dertesen e Sollomonit; pa durim, tha Irodhi.

Tashi uzbukurua ajo japi, dhe ne pak dit dote jete ne duarte tona, kur them de duarte tona, duva te them qe me muva sherbetore Tuaj ajo japi do vijnje de duarte Tuaja. Nuku kupetoj chthua, fjalosu chkoqitur. Dene urdherin Tuaj. Ate sarajen ebleu nje Famile e huaj prej te birit se Sollomonit ay qe shkoj per de Arabi. Familja perbehhet vetem prej dy veta, bure dhe grua, dhe kjo grua eshte kaqe ebukur sa me nje te shikoare te mberthen.

Me duket kumbeton si donje vjeshetor? Fol me poshte. Duva te them qe te veperoj une me sevdane de ajo gruaja, dhe me sevdane dote vinje ajo de muva, dhe saraja dote behet Tuaja. Po plaku; Oh? Plaku eshte plak? Ajde, kupetova tha Irodhi bej chte duash. Dhe te dy egersirat perfunduane per gjak derdnje. Kesi soj keqberesi dhe rembenjes, Irodhi kish gjetur mbesonjesin etij.

Iudha mentoshe dyke thene, sevdane dhe dashurine ne mest tone me Sallomin, Irodhesha dota ujdise domos do, po me gene se dota ujdise dhe me kete fqijnken te bukur, aturve do tu them qe do martohem vetem qe te mare Sarahen Irodhi, pa nuku eshte martes i verttte, dhe ato dyke deguare dhe prej Irodhit do besojne dhe nuku do zemberohen.

Per andaj djalli japarashtroj Irodhit me pare  
 qe te kete ndimen etij dhe ta kete mire me te dy anet.  
 Me vertet perfundim prej djalli.

---

Po pse; nuku ka dhe sot njerës, megith qe xbriti  
 Krishti dhe la drite pothuaj be tere boten, po atá  
 gjenden edhe ne eresire, megith q' ikane deguare a  
 ikane lechitur, ato porosite dhe fjalet mete bukura,  
 dhe te drites.

Ka njerës dhe sot qe shikon si e si tete rembenje  
 xdo gje qe te kesh a per ca te holla tete vrases, a per  
 ca te holla te prishe nje shttepi a nje Fshat.

Apo nuku ka katile, qe per ca te holla te tradhe-  
 toje dhe te chkateroje Atdhen' e tij, dhe te mare be  
 qjafë qindra mije njerës.

Chuare fund do te kene keta, a kane patur; Me  
 te vertet jo me te mire se te Iudhes sich dote shikojme  
 me poshte. Pa si vuri de program tere chkish perte  
 bere, pas pak ditesh ukthye de Jerusalem, dhe per  
 te mbaruare ate punen me chpet, ate dite qe ardhi  
 de Jerusalem, te nesermen zu ti ndrite syte si prej  
 djalli nga fqijnja e bukur po ajo as qe ikthente syte  
 ati.

Chme duhen keto tha Iudha, duhet punuare me  
 rende, dhe ashtu juafrua gradines dhe vajti zuri  
 gardhin prej ekuri dhe kur shikon qe nga rezda dhe  
 vjetersira ishne kalbur ekurat, dhe menjhere u ap  
 nje vend, ashtu Iudha hyri de gradinet te fqijnve,  
 dhe zu vazgonte an' embane. Dhe dyke ndrojtur  
 se mos e shikoje donjeri, uafhua prane nje pusi qe  
 ndothshe atje, kur shikon nje libre be nje fron. A?  
 ketu duket qe vjen dhe shkon oret plaku dyke lech-  
 itur. Shume bukur: dhe dyke shikoare an' embane,  
 mori nje gur te vogel dhe e odhi brenda ne pust dhe

tha, paska mja uije. Ukthye gene dyke vendosur gardhin, dhe si hyri ne gradinet te Pallatit tha.

Ay plaku duket qe vete lechit atje dene hije mbrema mengjes, po neser de mengjest duhet mbaru-are puna. Te nesermen Iudha si vajti ne glykatoren dhe si punoj pak, ishtiri gene syte nga gradina e fqijnve, dhe kur shikon plakun me nga dale, po i afroshe hijes, dhe frontit, dhe dyke ndenjur be frond mori libren dhe zu te lechite.

Iudha dyke ndritur syte xbente plaku, po xbriste mendje, po plaku nuku vonoj po ungrit dhe shkoj ne shtepi. Eh? pa chka? tha Iudha, dajnate dote vish gene dhe te shikojme.

Vertet plaku dajnate po i afroshe frontit, dhe si ndejn be te, zu te lechite libren.

Iudha pa si pa qe nuku kish njeri tjatre per vech plakut, me njhere ugent de gardhi ku edinte q' apshe vendi dhe jo shume lark plakut dyke thene.

Shikoj i ndershme Zot qe me shume kujdesi per librat, sesa per malle Tuaj. Ja keto ekurat kushdo mundet ti nxjere, itha plakut.

Me ndjeni q' uprisha qetesine, po une si nje sherbetor I Mbretit, dhe dyke qene qe gradina Tuaj me gradinen e Pallatit jane prane, eshte detyra jeme per xdo gje an' embane Pallatit, dhe ashtu duhet te jene te ujditura te tera dhe jo te gremisura, dhe me qe kini ardhur te rijn, per andaj uthem keto fjale.

Dhe plaku, dyke degjoare keto fjale, ungrit dhe si kur umallengye, dyke pasur perpara dhe fjalosur me nje njeri te Mbretit, dhe dyke afruare ithote Iudhes. Kini plot te drejte Zoti tem i kulluare, po neve nuku kemi shume dit qe kemi ardhur ketu, dhe dote marem masat per tere dertimet an' embane japise. Dhe me keto fjale zu ti afrohet plaku Iudhes, po Iudha si vete djalli, si kur ulargua dhe gene

udreqtua de plaku dyke thene, une si mi vogle vij tu shterngoj doren, dhe mbetem i kenaqjur nga fjalet Tuaja.

Tashi qe unjoame muntet te rini me qetesi, dhe te vazgoni lechimin.

Nder te math dhe kenaqesi dote ndjenja, po te mernit mundimin te pinim nga nje kafe ne shtepi, tha plaku. Iudha dyke pergegur itha. Mbetem i kenaqjur shume, po tjatre here, se nuku kam kohe dhe gezohem tepre qe unjoame. Po chuare lechit ashtu; Plaku itha, sklaverin' e Babillones. Duket te jesh shum' i perkujdesur nete lechiiturat? Chte bej une nuku jam aqe plak sa me refejne leshrat te bardha pothuaj njezet vjet me shume, po shume ngjarje shtepiake me bene be kete dite, dhe tashi arthme ketu dhe bleva kete dertese dhe duva te rojn ne qetesi dhe me librat.

Kini gradine te bukur dhe me shume drure pem-esjellesh, po qe nga evaditni; Dhe plaku zu te barase dhe ti refejnje Iudhes nje pellk qe vaditeshe gradina, po pa vajtur atje, dyke shkuare de pusi, Iudha e pyhet plakun: ketu cheshte; pus, ka uije; Vertet pus eshte tha plaku, dhe ka uije ger be tridhjet' epese gjurma, po ja keta guret kane lojtur dhe duva ti ujdin donje dite.

Iudha me sy te egre dhe si djall shikojti an' embane, dhe nje te zene plakun e odhi de pust, dyke rezuare dhe nje gur te math nga buza e pusit bi trupin te plakut, dhe si vendosi dhe libren qe lechidte plaku atje prane pusit, shkoj per de Pallatet dyke ujdin dhe ekurat e gardhit be vend, dhe ashtu umbyll ne glykatoren. Po me te hyre ne ate, zu te dridhet dhe ra poshtte se idukshe si kur endiqnin, e chponin me thika, dhe nje ze degjonte, i mallkuare, i mallkuare. Ky ze eshte qe vetem kaqe arivi te



thote plaku kur e odhi Iudha de pust, vetem i mallkuare, dhe pa pare asnjeri, plaku kish gjetur fundin e pusit, dhe vdekjen te shemtuares dhe te tmershme.

Kur Iudha kish rene poshte dh' e kish umbur fare, nje sherbetor truket be deren te glykatorës po me kot. Dera nuku apshe, dhe sherbetori dyke ditur qe Iudha eshte brenda, thret dhe dy te tjere, dhe si e apne deren, kur shikojne Iudhen gysme te vdekur, dhe me njhere thresin Mjekesin. Iudha mezi ardhi nermend ger daj te perenduare djelli, dhe pastaj judorezua letra, dhe si elechiti uthote sherbetorve qe neser vjen Mbreti. Sherbetoret dyke gezuare se te nesermen do vinde Mbreti, e pyetne Iudhen per shkakun e semundjes, po ay itha qe, dyke menduare me ardhi nje tralisje po tashi jam mire.

Pastaj Iudha dyke menduare tha: Une Iudha te trembem kaqe sa te mos di ku gjendem? Turp per muva? dhe bi keto fjal' esiper udigua nje lebeti ema-dhe nje ze, dhe pas te cfilitura, dhe shume njerës po blidheshin de shtepia e fqijnve. Iudha gjoja si kur nuku dinte gje thret nje sherbetor dhe edergoj te mbesoj shkakun e lebetive, gjoja si kur nuku dinte qe perpara ca minutashe kish edhur plakun ne pust atje ku dha shpirtin.

Gruaja e plakut si pa qe perendoj djelli, dhe plaku nuk' uduk, mori sherbetoren plake dhe dolli te shikoje. Thret dyke shikoare an' embane, po as qe dukshe as qe degjoshe plaku dhe me zemren dyke dredhur kur afrohet prane pusit shikon libren prane, po kur pa dhe gure te rakellere prej buzes se pusit, thiri.

Prishje megithsej? Perendia jeme, tetera te ligat de muva; Kaqe fatkeqe kaqe izi qenka fati jem; dhe de binte ne pust dhe ajo, po plaka Elisavet e zuri

dh' e mbajti. Njerezia te shtepise dhe te jashtme po mundoshin me chuare dosoj fjale ta ngushellonin po be kot, ajo ra e tralisur, dhe pastaj enxuare dhe plakun nga pusi.

Sherbetoret e plakut zun' e po thoshin, fatkeqi Zoti tone qe kur arthme ketu, xgjodhi kete vend dene hije qete lechidte, mbrema mengjes, dhe kush edisi shkeli ne buzet e pusit dhe ra brenda megith ate gure, dhe as qe shkonin ner mend as donje prej turve per donje ngjarje tjatre. Paspak ardhi ner mend e shoqja, po qjante dhe cfilidte dhe megith te, qjanin dhe sherbetoret, atá qe nuku gjenin fjale per Zonjen e turve, ashtu dhe fqijnte reth.

Ato te cfiliturat ebene Iudhen te dergoje nje nga sherbetoret sa per syt' e botes, pa katili e dinte fort mire se nga vinin ato te qjara, dhe kur ukthye sherbetori itha Iudhes. Nje nga fqijnte tone ay plakun ra de pust dhe umbyt. I varfi plak? tha gjakpir-esi, dhe bente si kur nuku dinte gje per ate ngjarjen.

Te nesermen ardhi Irodhi nga fortesat e Mahorit, dhe Iudha rendi ta baskoje.

I varfi plak e blevi kete saraje po nuku rojti ti gezohet, itha Iudha.

Pse; chkerkon te thuash; upergeq Irodhi. Nuku di si beri die mbrema ra ne pust dhe u mbyt.

Irodhi si lojti vetullat, tha.

Me te vertet je i chuditshme? Je vete djalli, itha. Pas dy oresh, Iudha vajti te ngushelloje fqijnjen ng' ana e Irodhit. Jam i derguare ng' ana e mbretit Irodhi qe tu ngushelloj per fatkeqesine qe u ngjajti, dhe me te vertet kjo ngjarje, na helmoj shume te githeve, itha Iudha. Mbetem e kenaqur Zot, upergeq ajo dhe ja ndejti doren. Pastaj Iudha vajti ne odet ku ish i mbyturi, dhe i odhi ca lule bi qevurt, dhe dyke dredhur se i dukshe si kur dote

fishte ay, iku me vrap ng' ajo shtepia qe ay eshtiri ne zi. Po njerezia q' epane Iudhen ashtu dhe te ndroje chere, thane qe, sa zemre mire qenka ay sa ju ndroa cherja, vertet i ardhi keq shume thane.ca, dhe qenka zemre bute.

Iudha si ukthye de Pallatet umbyll ne odat e tij, se ube si donje gysm' i vdekur.

Trup' i plakut u varos me nderime dhe shume njeres e percualle ger ne vart.

---

### DASM' E PAZAKONSHME

Shkuane te parat dite te zise.

Iudha prej glykatores de odat vinte, dhe nuku para dilte, ish bere si donje matuf dhe nje frik' ekish ipur zemren e tij, dhe sa mentoshe keshtu, dhe aq' e ipte frika. Ba? si jam keshtu; thosh vetiu une kure nuku kam ndjere keshtu vetiu frike.

Shtepi e fqijnjesit ish fundosur de zi, dh' e veja nuku desh te shikoje asnjeri nga sherbetoret e shtepise, po vetem plaken sherbetore Esthir.

Shkuane po thuaj tre muaj dh' e veja as njeri nuku kish pare. Plaka me fjale te mira dhe te buta perpigeshe ta pushonte se qjari Zonjen e saj po be kot. Po me de fund, si umbaruane lotet, dhe si um-bush zemra e saj me idherime sa nuku nxinte me, kutuerisi te degjoje chi thosh plaka.

Ka thene Ungkoj qe, sfengyeri kur mbushet me uije, si kur tere detet te bjene be te, as mundet te mare donj pike as te leshoje. Ashtu dhe zemra e saj as nxinte me idherime, as vend kish per gezim. Dyke gjendur kesi soj e veja grua, zu te dale ne per shtepine.

Esthiri plaka e beses dhe tere sherbetoret e

shtepise, ugezuane kur pane te barase de per shtepine Zonja e tyrve.

Nje dite si shkuane dhe ca jave, nje i larte sherbetor i Pallatit trokiii be Portet te se vejse grua, dhe si hyri mbrednda i doreztoj nje letre dhe dyke ujnjur itha? Eshte nga Mbreti. Ajo me duarte dyke dredhur e api, dhe kur shikon qe te nesermen thirche nga Irodhi de Pallatet. Chte jete kjo; tha: muva nuku me duket e mire kjo e thirur.

Po si mundte te bente ndryshe; fjala e Mbretit nuku beshe dy, dhe dushe te vinte do emos.

Dhe ashtu te nesermen vajti de Pallatet be oren qe kish shinuare Irodhi.

Uthira ketu qe tu ngushelloj per fatkeqesine itha Irodhi, dhe te besoni qe u helmuame shume, dhe tashi dyke ditur ne chterezi gjendi, duva qe te xbut plaget e zemres Tuaj. Mbetem e kenaqur nga Madhesia Tuaj, itha e veja, per fjalet simbathitike dhe qe jane nder i math per muva, po plaget e zemres teme nuku xbuten kure.

Genjei shume tha Irodhi kur refej kaqe te deshperuare, une nuku egeij te drejte kete deshperim. Ti kaqe e re dhe si lule, do te kesh dhe fatin me te mire pasketaj: Une umentova dhe kuturisa tu ndimtoj per nje te miren Tuaj, ajo qe do derdhe ballco de plaget Tuaja. Kjo e mire eshte te martohesh me arketare tem Iudhen, djale ne lulezimin, i besuare, i bukur, i sqyate, dhe ay qe ka fituare nje dashuri te vechante prej muva, dhe besoj qe per se shpeti do tu sherohen plaget dhe dote aroni idherimet.

E varfa grua mbeti be vend: nuku dinte si ti pergeqshe Irodhit dyke degjoare keto fjale daksafise, po as qe bente dot ndryshe dhe kondra Irodhit, se ajo e dinte cilli ish ay, dhe si umentua pak tha. Nu-

ku mundet te bej ndryshe, dhe lete behet sich thyani, po un' edi qe zemra teme kure nuku do sherohet.

Irodhi dyke fjalosur bute itha. Mos u deshperose pasketaj dote jete e lumture jeta Tuaj, dh' ethiri Iudhen ay qe pernjeresh uduk.

Ja, tha Irodhi; de ky i riu dote gjeni tere lumtesine pasketaj.

Iudha ezgjati doren dh' ezu te sajne dhe si e puthi ezuri me te dyja duarte, pastaj e percolli gerbe shtepin' e saj dyke kthyerë si ne mentim de Pallatet. Fjala e se vejse ish vlesimi, dhe pastaj prisnin ditën qe te beshe dasma.

Irodhi thosh plani qe shtroj Iudha, do vinte mbare per ate qe te merte shtepine, po edhe Iudha mentoshe ndryshe dyke shtene dashuri te vechante per ate gruan.

---

Pasnje muaj ube dasma e Iudhes me Rahile: Iudha thosh se qyheshe Revejka ajo gryuja, se kesh-tu kish degjoare dhe keshtu edinte, po ditën te vlesimit kur mbesoj qe qyshe Rahil, ukujtua qe dhe e jema qyshe Rahil, po nuku dha donje rendesi se vetem nje shikonte, qe sa vinte po shterngoshe me shume me dashurin' e saj.

Sallomi kur mbesoj keto ajo q' e desh Iudhen shume, ube si e prishur nga mende, po dhe mbretereshes nuku i ardhi mire, po Iudha Sallomit dhe Irodheshes itha qe kjo dasme nuku eshte per gruan po vetetm per sarajet te saja pas porosise se mbretit.

Dhe si umbarua dasma Iudha uvendos de shtepin' e se shoqes, atje ku gjeti dashurine dhe te tera te mirat prej asaj gruas, Iudha ndjente me te madhe dashuri per ate. Dhe keshtu egersira uxbut dhe ushtrua si njeri i nderit. Jeta e Iudhes vazgonte bukur, gruaja e tij edesh pa mase, po dhe ay jo me

pak. Pervech kesaj Rahili, me tere dashurine te Iudhes dhe qe ronin jo me mire, ndjente nje trazire te lige be zemren e saj, dhe nga donjhere kur ndodheshe vete qjante pa mos ditur per se.

---

### XBULIMI

Iudha eshikonte te shoqen te renkoje nga donjhere, dh' e qertonte me dashuri dyke desheruare qe te ish e gezuare, dhe mos renkoje me qe i kishin tere te mirat.

Nje dite ukthye me pare se tjater here Iudha, dh' e gjeti te shoqen qe qjante. Pa thuame se duva te di chke, dhe per se qjan; chte duhet; dofta te thote mendja se chevalle te duva megith zemre; Apo chevalle kemi pasuri dhe shkalle te larte ne populli? Tetera i kemi lumtesisht, dhe ti pse qjan nga dit pa donje shkak; Ajo si mbaroj fjalen Iudha itha.

Tetera te mirat i kemi dhe xdo tjatre dote ish e lumtur per vech meje.

Pse per vech teje;

Degjo Iudhe tete them idherimet teme:

Perpara tridhjetë vjet ronte denje qytet te vogle afre Tiverise nje chifut, bure dhe grua shume te lumtur, ky Iudheu (chifuti) megith gruan nje nate ukthyene nga nje aeng shume te gezuare, po ate nate qete dy pane nga nje endre te frikshme si njeri dhe tjatri.

Ufrikesuan qe te dy dhe shinuane ditet, dhe pas nente muajsh gruaja lindi nje djalke te bukur dhe ate qe, Ata e tij e odhi ne detin e tiverise dyke mare leje dhe nga e jema.

Pas pak kohe ky chifuti ish pentohur per kete gabim, dhe te idheruare besonin qe nuku do lindnin me, po kur nje dite pane dy te huaj me nje foshnje

ne duar dhe jetim. Kete djalke e blene dhe e deshin si te tyrven. Pas dy vjet lindne nje tjatre djalke dhe gezimi tyrve ish pa mase. Shkuane shtate vjet dhe qe te dy djemkat te dashur vinin ne skolle, dhe nje dite nuk' ukthyene me. Te voglin Matathine e gjeti nje bari me koken te shtypur, dhe per te madhe asqe mbesuame dot si ube.

Dyke umbur te dy djemte, ky chift hyri de nje zi te madhe dhe plot helme. Dyke thene keto Rahili Iudha zu dridhej, po Rahili vazgoj gene. De ate qytet ku ronin keta, vendesit zune po benin mbledhje, dyke dashur te edhin poshte dhespotizmen (zoterimim) te Romanve. Renkimi i popullit bi Romanet po shtoshe nga ditesh, dhe ubene dy kryengritje dhe thoshin qe do behet dhe nje me madhe ne tere anet e ati vendi.

Kete here u frikesua ay chifti se mos binin ne do ca duar te liga dhe te pesonin, ushternguane te lene atdhene e tyrve dhe te shesin malle dhe te iken.

Po ku vane; Ketu ne Jerusalem.

Iudha ushti si de ethe dhe nuku mundi te mbashe, dhe dyke dredhur, tha.

Po si qyheshe ajo famile;

Rovel. upergeq Rahili.

Iudhes nuku judurua me, dhe tha.

Une evrava te voglin vellane Matathine?

Un' e vrava Aten e tij?

Une jam atvraseshi?

Une jam i cperlari bur' i nenes teme?

Une jam Iudha.

Dhe te dy mbetne pa ze dhe si dy gure per shume oresh.





# TRADHETOR'

## I KRISHTIT

---

PIESA E II.

---

KRYE I.

---

MJEKESI I SHPIRTEVE

Tipsi

Populli chifut ne kete kohe, gjenche mi lavderuari dhe mi lumtur dene mbreterine te Sollomonit, ay qe vazgonte udhen e Ates se tij Dhavidhit, dhe qe baskoj tere komat Israil de nje te forte mbreteri.

Pas vdekjes se Sollomonit ipi be front trash-egimtari i tij Rovoami, po ky nga miria e rende q' ishtrngojti njerezine te paguajne, dhe ca nga nak-eri de mest te tyrve u ndane be dysh.

Dhe komat Efraim, Dhan, Simeon, Manasi, Is-sahar, Zavullon, Asir, Nefthalim, Gadh, dhe Ruvim bene kryengritje dhe formuane mbreterine Israil, dhe mbret vune xheneralle Jerovoam, me kryeqytet Sihen, pastaj Samarianen. Dhe komat e Iudhes dhe Veniaminit, mbetne te beses de Rovoami megith ca koma te tjera dhe bene mbreterine me Kryeqytet Jerusalimin.

Qe pas kesaj kohe Iudhea (chifuteria) nisi te rjedhe dhe te tretet, dyke bindur de Assirijnte, Bab-illonesit, Perset, Egipthianet, dhe ne mi madhi dhe i ndritshmi jone Aleksandhri i math, dhe me ne fund de Romanet. Dyke gjendur chifuteria dene Roman-et, Qesari i Romes, e kish ndare be katresh qe te

qeverisej me lehte, dhe kish vene nga nje Igemon (qeveritar) dhe ashtu kish derguare nje perfaqes-onjes ay qe ish bi lidhjen te chifutve. Roma nuku i ndalloj fete te chifutve, dhe ashtu populli chifut kishin te drejte te vazgojne pas ligjes te Moisiut a te Profetve, dyke vajtur pas libres se shente Talmuth sich qyshe, dhe keshtu kishin te drejte te vazgonin dhe pas feve t' Aterve se tyre.

I pari i fese urdheroshe nga Romanet, po krye-priftijnte qe chkoqitnin ligjet e Moisiut ishin nje part tjatre te qyojtur Farisejn dhe Glykates (shkronjes), keta kishin te drejte dhe te gykonin, po as gykonin dreq as ligjeve rendesi nuk' u jepnin, dhe vetem shikonin te rembenin nga populli i varfe dhe jo per donje te mire, dhe as qe mernin ner sy protestimet e popullit. Bi keta, populli renkonte dhe thirte qe shkelnin tere te drejtat, si dhe fene megith ligjet e Moisiut, dhe atyrve qe u kishin dhene besim bi ato punra.

---

Dyke gjendur ne keto deshperime populli chifut, uduk nje i ri mireberes per kete popull, dhe qe te shkele udhen dhe ligesite qe benin Farisejnte dhe Glykatesit. Ky i riu bure, si shkeli tere paudhesite te Farisejnve, zu i refente popullit udhen te drejte dhe i mbesonte Perendine te vertete e Aterve se popullit Israil, Avraam, Isaak, dhe Jakov.

Ky zeri dhe mbesimi i keti Profeti, e beri popullin qe te mblidheshin dhe i vinin pas shume dit, dyke degjoare fjalet e tija te shenta.

Kudo qe shkonte ky profet njerezia e shikonin si me te madhe njeri qe mundte tu sheronte plaget e tyre. Ky njerezidashes nuk' u mblloth vetem de mbesimet te bukura dhe per udhen te Perendise, po bente dhe chudira te mira per popullin.

Sheronte te semure prej xdo semundje, te verbe, gagache, uloke, dhe prej xdo semundje qe ti dilnin per para, po jo me ilache po vetem me fjalen e tij dyke thene, shkoni ne shtepite tuaja dyke besuare Perendine te vertete dhe i ini te sheruare. Dhe pernjeresh uloket barisnin, gagachet fjalosnin, dhe si cilli pas semundjes qe kish sheroshe.

Nga keto chudira ky njeriu u dukshe te tjerve si Mesia qe prisnin, dhe ca te tjere eqyanin mete ma dhe Profet qe kish dale be stere, dh' embri i tij u ap ne tere Chifuterine, Samarianen, dhe shume lark nga Jordhani. Keta qe degjonin ate, dhe qe u sheruane prej Tij, shkonin dhe perapeshin dyke perapur dhe embri i Tij, se atá xdo njeri qe gjenin dhe i thoshin, qe ka ardhur shpetimtari i njerezise, dyke refere dhe si isheronte prej xdo semundje vetem me fjale dhe jo me ilache.

Iudha pas xbulimit dhe ngaterimit te gjakut de mest tyrve, dhe si usigurua qe ay ish i chperlari bure i neves se tij, prej asaj qe mbesoj tetera si ulind, mbeti shume oresh pa ze dhe pa livizur.

Rahili qe kish pare me te keqia ger ate dite, urefe me trime dhe ndimoj Iudhen te vinte ner mend me ndimen dhe te sherbetorve.

Ketij te keqi xbulimi Rahili me Iudhen i dhane fund qe ta varosen gene.

Iudha te nesermen ish i kapitur se nuku kish fjetur ternaten, dhe i dukshe si kur i vellaj i tij Matathia, dhe i ati Roveli me koka te shtypura, qendronin perpara tij dhe i kerkonin fjalen te vrasjeve.

Tipsi zuri gene ta mundoje dhe zemra e zeze e tij dridhese si purteka, dhe kudo qe kthente syte mjegull i dukshe. Buka i dukshe e idhur, uija i dukshe e kuqe si gjaku qe derdhi, vendi ku flinte i dukshe mbushur plot gjarpijn, dhe as qe ante as

pinte, Dyke gjendur ne kete gradho Iudha, kur emri i ati profetit ariu ger de veshet e Iudhes. Ky kish mbesuare qe ay Profeti sheronte vetem me fjalen e Tij xdo semundje, dhe shtinte ballco de per zemrat qe pesonin prej xdo gjeje.

Kish shume ditesh Iudhen qe tipsi i tij nuku e linte te qete, po gith e mundonte dhe me qe as ante as pinte dot, kuturisi te shkoje per de ay Profeti, se per vech se tjerave kish mbesuare qe ay Profeti pas-tronte dhe mekatat.

Ethiri Temen a gruan e tij dhe i tha kuturin' e tij dhe ajo nuku jukundreshtua Iudhes qe te bashkonte te Drejten te madhe dhe driten.

Dhe ashtu Iudha vajti bashkoj shpetimtare te njerezive, dhe me qe nxenesit te Krishtit ishin njembdhjete me Iudhen u bene dymbedhjete.

---

### MBESIMI

Porsa qe uradhit i dymbedhjete nxenes Iudha, dhe dyke degjoare fjalet te shenta te Jesu Krishtit zemra e Iudhes zu po xbuteshe.

“Ata i githesise dhe i Qjellit, dergon djellin be te mire dhe be te liq, dhe shirat be te drejte dhe be te padrejte.”

“Mos Kritikoni qe te mos Kritikoi.”



“DOTE VETE TE PREGATIT VEND”

(Shiko Faqen 80)



“Te duani armiqtë tuaj, dhe mire tu beni te nakërit.” Keto fjalë e bënin Iudhën të shpresonte, ay që për pak ish pendohur për të ligat që kish bërë, dhe besonte që të lashe nga mekatat dhe të shpetonte me që degjonte Krishtin të thotë “Ata dërgon djellin bërë të mire dhe bërë të liq.” Dhe vertet do shpetonte po të pendoheshë me vertet, po Iudha nuk u upendoha me vertet sich pame dhe sich do shikojmë me poshtë.

Tashi vinte pas dritës së vertetë që të ndridte shpirtin e tij dhe të cngarkoshe nga mekatat e rënda.

Iudha fjalet e shënta i degjonte me gojë apur, dhe i bënin si ballsam në zemrën e tij, po nuk shkante shumë dhe tipsi i zemrës e drithtë për të ligat që kish bërë.

Po vallë do të mbante gër de fund ato fjalet të shënta që i jepte mbështetjesi;

Jo? Jo? thotë historia jo? kështu thirte dhe tipsi felle në zemrën e Iudhës dhe de zemrën të mbulosur të tij. Po pse; së vetem ay katil, vetem ay djall mundte të tradhetonte shpetimtare e njerezive dhe jo tjetër zemrë, së ashtu do mbusheshin të shkrojturat të profetvë, që do ndodhet bir i umbur.

Dhe ashtu Iudha jo vetem që nuk u la nga mekatat, po tashi i pa besë, dhe i pa cipeti e gërsirë do bëjë me të madhën tradhësi, për atë që njerezia ekerkonin bërë qëllim dhe gjetnë bërë të stere.

Tipsi? po kish dhe ay tips; Pa fjale kish, së për andaj mundoshe dhe pesonte për ato që kish bërë?

Së po të mos kish tips të së mirës dhe të së ligës, dhe po të mos e kupetonte të mirën nga e liga, nuk do të mundoshe, nuk do të dukeshin si kur storaseshin i vëllaj dhe i ati tij Rovel përpara dhe si kur i kerkonin fjalën për vrasjet.

Iudha kish tips, po tips i tij ish plot gjëmba, ish i heret, ish i shtrembër dhe si prej djalli.

Ky tips' i Iudhes zuri te xbutet, te kthjellet, dhe te pendohet dyke degjoare fjalet e shenta te Mbesonjesit te Math, dhe Iudha ish bere si njeri i ri, dhe getesi gjenche be zemret te tij.

“Une jam drita e botes, ay qe vjen pas meje, iku do barase de her sire.”

“Une jam buka e jetes. Ay qe vjen pas meje, kure nuku do jet' i uret.”

“Dhe ay qe beson de muva, kure nuku do sendiset per uije.” Keto fjale thosh Mbesonjes' i Math.

Iudha kur degjonte keto fjale, forcoheshe trup' i tij, dhe xbuteshe zemra e tij dyke pendohur dhe mbushur me shprese.

Per te pasurit, dhe te pa ngkopurit Krishti thosh. “Me mire mundet te hynje Gamilja ne veshet e gjelperes, se i pasuri ne Mbreterine e Qjellit.”

Dyke fjalosur Krishti per te pendohurit, per dashuri njeri me tjatrin, dhe per te varferit, nje grua i tha.

“I lumtur barku i asaj gruaje qe te ka mbajtur dhe sisset qe ke thethire.”

Dhe Krishti upergeq.

“Te lumtur jane atá qe degjojne fjalen a Perendise dhe e mbajne ate.”

Dyke degjoare kesi soj Iudha, tha se shpetoj nga tere te ligat qe pame me sipre, po be kot! Zemra e tij ish rahur me te ligat dhe ish bere si trunch po thuaj se qe kur u lind, dhe se ay ish ritur me Irodhe jo me te mire prej tij, dhe per andaj nuku xbuteshe zemra e Iudhes fare.

Mbesonjesi i Math Krishti, edinte zemren te Iudhes, po e mori pas dhe e mbajti, se ay nuku kish ardhur per njerezine te drejte, po vetem per atá te shtrembrit, per atá qe kishin umbur udhen dhe ishine heresire. Dhe keshtu dyke mbesuare popullin



dhe dyke sheruare prej xdo semundje, emri i tij ube shume i degjoare, dhe githnje njerës i vinin pas dyke lavderuare Perendine, dhe besonin Zotin Jesu Krisht, si Mesine qe prisnin, dhe ca te tjer si me te Madhin Profet. Iudha dyke shikuare kete forcat te Mbesonjesit te Math chuditeshe dh' e besonte ate.

Nje dite dyke shkoare Jesu Krishti me nxenesit e tij, u duk perpara tij nje qe ish lindur i verbre dhe i tha. Meshirome o i biri Dhavidhit.

Jesu Krishti peshtyj perdhe dhe beri balte, ja lyejti syt' e tij dhe shikojti i verbri.

Tjatre dite u mblodhe shume ng' an' e anes se Iudhese (Chifuterise) dhe te Jerusaliment dyke degjoare mbesimet e Tij. Ate dite ardhe dhe ca nga Farisejnte dhe Ligjembesonjesit, qe te degjonin dhe keta per Mbreterine te Qjellit.

Shtepia ku ish Krishti ish mbushur plot njerës si mbrenda dhe jashte, dhe u dukne dy njerës qe mbanin nje ulok me gith shtratin e tij, po nga njerezia te shumte nuku hynin dot mbrenda, dhe ashtu apne chatine dhe jaleshuane me litar Krishtit perpara.

Krishti si epa besen e tyrve itha ulokut.

"Te lihen mekatat tende."

Kur degjoane Farisejnte dhe Ligjembesonjesit, zune te mentohen dhe te kembejne fjale ne mest te tyrve dhe thane: Ky njeriu shan: Se asnje nuku mundet te laje mekatat per vech Perendise.

Jesu Krishi i kupetoj keta dhe i tha:

Chfjalosi me zemrat tuaja?

"Cilla eshte me zor te them, te lihen mekatat, a ngreu dhe barit; Dhe qe te shikoni se pushtet ka i biri njerezise be stere dhe te fale mekatat, i tha ulokut.

Ngreu te them mer shtratin tent dhe shko be

shtepin tende.” Dhe pernjeresh uloku ungrit dhe si mori shtratin e tij shkoj be shtepin' e tij.

Farisejnte mbetne me goje apur kur pane keshtu. Dhe populli ufrikesua shume se kish pare shume chudira ate dite.

Tjatre here nje dite te shtune Krishti jepte mbesime ne synagogi, dhe vjen nje grua esemure prej tetembedhjete vjet ajo qe kur unjeshe nuku ngriheshe dot.

Jesu Krishti vuri duarte bi te dhe i tha.

“U leshove nga semundja.” Dhe pernjeresh gruaja u shtoras e sheruare, dhe lavderonte Perendine.

Kete chudi si e pa Kryetari i kishes, dhe si pa qe populli zu refente dashuri te madhe de Krishti, dhe nga nakeri desh te rezoje Krishtin ne syte te popullit dyke thene se nuku eshte e mire kjo qe bere, se sot eshte e Shtune, dhe kete e kemi vetem per Perendine, dhe vetem ditet e tjera mundet te sherosh njeret dhe jo te Stunave.

Dhe Krishti dyke pergegjur i tha.

Ipokrit, sicilli prej jush, nuku xgith kane a pulishtin qe ti jape uije; Dhe kjo chupa e Avraamit undoth, e lidhur prej dhemonit tetembedhjete vjet, dhe nuku qenka e drejte te xgidhet te Shtune;

Kjo fjal' e Krishtit ish nje plage per Farisejnte dhe Glykatesit, po populli u kenaq shume.

Dyke shkuare koha dhe dyke folur Krishti kudo qe vinte, dhe dyke sheruare xdo te semure qe vinte dhe besonte de Jesu Krishti, dhe aqe me shume riteshe dashuria e popullit de ay dyke lavderuare ate dhe Perendine.

Veten Farisejnte Glykatesit dhe te pasurit dri-

dheshin dhe nuku juvinin mire fjalet e Krishtit, dhe mbechin pa kenaqjur nga fjalet e tij.

Dhe ketyrve u thosh.

“Mos kritikoni qe te mos kritikoi.”

“Pse e shikon peronen de syt' e tite vellaj, dhe trane de syte tend' e aroni; . . . Ipokrit? nxir me pare trane nga syte tende, dhe pastaj shiko te nxjeresh peronen nga syri teti vallaj.”

Po atyrve nuk' u vinte mire, dhe ashtu qertonin te tjerit qe te mbulonin pa udhesit' e tyrve.

Sh. Lechites: lete veme re dhe mos arojme keto fjalet te bukura dhe te shenta te Jesu Krishtit si dhe ato qe do shikojme me poshte, se ate udhen te Farisejnve vazgojne dhe sot shume njeres dhe degjome te thone, ay eshte keshtu, eshte ashtu, eshte i ketille, dhe i atille, beri keshtu, dhe ku tedi une, qe me keto fjale duane te dalen te lare vete, dhe te fajtojne te tjerit.

Kesi soj ishin Farisejnte dhe Glykatesit dhe per andaj Krishti me gjuhen te forte u thosh. “Ipokrit, nxir me pare trane nga syri tent.”

Populli dyke degjoare fjalet qe u thosh Krishti Farisejnve, e lavderonin dhe i vinin pas me shume.

Dhe popullit Krishti i thosh.

Po te mbani fjalet e mija, vertet nxenesit tem ijni, dhe po te mbani te drejten e drejta dotu liroje.

Keta upergeqne qe, evlatet e Avraamit jemi dhe as donje tjatre nuku dime, dhe kerkoane tu chpengonte Krishti xdo methene te liruare.

Dhe Krishti upergeq. Sicilli qe ben mekate sherbetor i mekates eshte: Dhe sherbetoret nuku mbeten ne shtepi per jete, po biri mbetet. Dhe po tu liroje juve biri, te liruaae dote ijni. Pashe qe prej trupit te Avraamit ijni, po duani te thuani qe fjalet e mija nuk' i kupetoni.

Chifutet ishin vertet sherbetoret te mekatave, dhe me shume Paresia, Farisejnte dhe Glykatesit atá qe kishin lene benjane liqgjet e Moisiut dhe popullin te varfe, dhe nga keto qe benin nuku kishin kohe per te tjera, per andaj e umpne dhe Mbreterin' e tyrve pasi rane de shume duarsh me de fund dhe de Romanet.

Ketyrve Krishti desh tu rezonte cipen e zeze qe u kish zene syte, ketyrve desh tu rezonte kryelartesine te kalbur dhe qe nuku kujtonin te tjerit fare, po vetem per vetjen e tyrve si e si te rjepnin te varferit.

Dhe per andaj u thosh, "Sicilli qe ben mekata sherbetor i mekatave eshte, dhe "Fjala jeme nuku gjen vend ner jyve."

Si keta ish dhe Iudha qe nga donjhere fjalet e Krishtit nuku gjenin vend de ky.

Nje dite Jesu Krishti ardhi jashte qytetit Sihen te Samarise. Atje afre gjenche nje pus qe qyheshe pusi Jakovit. Si i lodhur nga udha Jesu Krishti ndejn prane pusit, dhe kerkoj uije prej nje gruaje Samariane qe undoth atje po mbushte uije stamnat e saja: dhe nxenesit te Krishtit kishin hyre de qytetin per ushqyme.

Kjo gruaja u chudit per kuturine te Krishtit qe kerkoj uije prej saj, me qe Krishti ish Chifut: Se ne mest te Chifuteve dhe Samarianve ish nje armiqesi e madhe per shkak feje, se Samarianet kishin lene fene te Avraamit dhe u faleshin gjerave te pa gjendura. Dhe kjo gruaja i tha Krishtit: Si kuturis ti Chifut te kerkosh te pish prej meje une qe jam grua Samariane;

Dhe Krishti i tha: "Sicilli qe pi prej ketij uij sendisen gene, po sa qe Pine Prej uijt tem kure nuku sendisen, dhe mburim u behet qe ta kene per jete."

Dhe gruaja i tha: Zot, nem prej ati uij qe te mos sendisem dhe te mos vijn ketu me. Dyke thene keto fjale gruaja e besoj Krishtin pa si degjoj dhe chesa fjale te tjera dhe i tha. Degjova qe Mesia vjen i qyotur Krisht, dhe kur te vije ay, do na i thote te tera. Dhe Krishti u pergeq. "Une jam qe te fjalos."

Ate minute u kthene Nxenesit e Krishtit dhe u chuditne kur pane qe Mbesonjesi i Math, fjaloseshe me ate gruan Samariane dhe mekatare, po nuku kuturisne ta pyesin per se, dhe e pyetne vetem per te ngrene.

Po Krishti kupetoj dhe u tha: "Yshqimi jeme eshte, qe te mbush qellimin e ati qe me dergojti, dhe te mbaroj punen." Samariana dyke degjoare keto fjale, ela stamnen atje, dhe rendi de qytetin, dhe u tha sa degjojti nga Krishti.

Me te degjoare keto fjalet te Krishtit qe u tha ajo gruaja, dualle shume Samarite dhe julutne Krishtit qe te hynte de qytetin, dhe ashtu Krishti hyri dhe qendroj atje dy dite, dhe shume nga Samaritesit e besoane dhe lavderonin Perendine.

Tjatre dite kur po dilte Krishti ne shkretetire, i vane pas shume njeres qe te degjonin mbesimet e Tij, dhe te sheroshin, dhe pas ketyrve po afronte nata, dhe Nxenesit e Tij julutne ta leshonte popullin te shkonte ne shtepite e tyrve: Ska shkak per se: Tha Krishti, po jepuni te hane:

Dhe nxensit i thane, nuku kemi as gje ketu, per vech pese buke dhe dy pisht vetem, dhe jasualle perpara Krishtit. Dhe Krishti si i mori te pese buket dhe te dy pishtit, i ngriti syte be qjellin dhe i bekojti ato. Pastaj i preu copra dhe jaudha nxenesve dhe atá jadhane popullit, dhe hengren te githe dhe u ngopne dhe teperuane dymbedhjete koshe plot: Keta qe hen-

gren nga keto pese buke ishin pese mije per vech grave dhe femijve?

Dhe kjo chudi u ap de tere Chifuterine dhe Galilene. Pastaj Krishti u tha nxenesve te hyjne de gemine, dhe Krishti ungit ne malt te faleshe, dhe u vonua atje ger ne mest te nates. Gemija qe kishin hyre nxenesit de beshe chopra nga dallget e mbedha, sa u frikesuane nxenesit.

Jesu Krishti si xbriti nga mali po i afroshe gemise dyke baritur bi detin si be stere: Nxenesit dyke pare kete ufrikesuane dyke pandohur se mos ish donje hijrende (fandasme). Po Krishti dyke kupe tuare friken e tyrve u thiri, mos kini frike une jam, dhe porsa ipi bi gemine u qetesua dhe deti, dhe tere sa undodhe de gemit juafruane dhe jufale dyke thene, vertet i biri Perendise je.

### MBESHTETJA E MBESIMIT

De chudirat e Krishtit chuditeshin dhe nxenesit, po per vech turve dhe populli chuditeshe pa ndryshim, feje, dhe deshin githnje ta degjojne, dhe per andaj i vinin pas shume here kudo qe vinte.

Krishtin qe ta besonin nuku duheshin chudira, mjaftte ishin ato fjalet te bukura q' i mbesonte si eshte e drejta, cilla eshte drita, zemre te qeruar dhe dashuri de mest te njerezive, po me gith ato ay beri chudira per vech te semureve qe sheroj dhe te tjera, ngjalli dhe te vdekur.

Dhe dyke fjalosur Krishti thosh.

"Te lumtur atá te qeruarit be zemre. Te lumtur paqebesit. Te lumtur meshironjesit. Te lumtur te ndjekurit per te drejten." Dhe mbeshtetja e mbesimit ish:

"O ti de naker, tjetrit mos i bej."

Me te bukura fjale, me bukur udhe, mi forte

themel, qe u jepte Mbesonjesi atyrve, nuku mundnin te gjenin: Se me keto fjale njeriu mundet te vdese sa do plak, po me ate zemren sich u lind: Se fjala o ti de naker, tjetrit mos i bej, ka kupetimin qe te mbreteroj dashuria de mest te njerezise, dhe porsa qe ta duash tjatin, kure nuku mundet ti besh te lige.

Po Iudhejnt (chifutet) me gith chudirat, me gith te mirat, me gith fjalet e bukura dhe te embla te Krishtit, me gith qe sheroj dhe ngjalli te vdekur, shum' e besonin per te bir te Perndise dhe te tjere thoshin qe ka te bejje me dhemonet, dhe u thoshne atyrve q' e besonin, se ato chudira qe ben ka dhemonet per ndime.

Dhe ashtu vertetoheshin fjalet te Profetve qe kishin thene me pare, qe dote vijnje Krishti, po nuku dote besonet prej terve dhe thote, Profeti Isaia.

“Zot, cili besojti nete degjoarit tuaj, dhe krau i Zotit kujt juxbulua”; Dhe gene Isaia thote. “ Verbohua atyrve syte dhe mpihua atyrve zemren, qe te mos shikojne me syte dhe mos ndjejne be zemre. . . ”

Keto dhe shume te tjera ka thene Profeti Isaia, si dhe Profetet te tjere per ardhjen te Krishtit, dhe popullin dinak, dhe tere keto te shkrojturat te Profetve, i lechitnin githnje Farisejnte dhe Glykatesit ne Synagogit po nuku, i besonin. “Populli qe bariste ne eresir pa drite te madhe: dhe atá qe qendronin be stere hijevdekuresh, drit' e madhe u ap bi ta.” Dhe dyke shikoare kete drite nuku besonin. Dhe me qe nuku besonin flaknin te drejten: dhe keshtu vertetoshin parathenjet te Profetve nje nga nje.

Per atá Iudhejnte qe nuku besonin porosit' e Tij, Krishti ish si donje i flakur, dhe per andaj dyke pare Krishti Chifutet qe ishin te pa bese, te nakerit, dhe zemre liq helmoshe, po shikonte qe te shkrojturat e

Profetve po mbusheshin dhe po afroshin, dhe me keto po afroshe dhe dita e qellimit qe ish dergoare Krishti.

Prej njemije vjet me pare, Profeti Dhavidh tha qe dote vijnje Krishti, dhe paratha:

“Bertitnin tere qe me shikonin, dhe dyke apur buzet lonin koken.” Dhe gene thote Profeti Dhavidh: “Gure, qe se pranuanë atá qe benin mure, ky u lind ne krye te qjoshes.”

Per kete gure qe dote themelonte Kishen te Krishterimit, Profeti Isaia thote: Per andaj kesi soj thote Zoti Perendia: Ja ku vendos de Sion themel prej guri, gur te xgjedhur, te ndershme, dhe themel te forte. Ay q' e beson ate nuku do aratiset.

Profiti Mihaia kish thene per ardhjen e Krishtit. Dhe ti Vithleem Efratha, i vogle po te jesh bashke me mijrat e Iudhes, nga ty do dale bure de muva, qe te jete udheqes be Israile...Dhe dote qendroje dhe te ruaje be fuqine te Zotit, be madhesine te emrit Zotit te Perendise tone...Dhe ky do jete paqja.

Thame qe Iudhejnte besonin Profitet, dhe lechitnin nga ditesh te shkrojturat de Synagogine, po nuku besonin Krishtin nga brudallesia dhe nga zemrat te mbulosura qe kishin dhe keshtu mbusheshin dhe te shkrojturat e Profetve. Dushe te arinte fundin, dushe te mbaronte qellimin qe ish dergoare, dushe ti vere themel Kishes, dushe te shpetonte njerezine, dushe te chperndante eresiren, ate eresiren qe gjenchin njerezia, dhe nuku dinin ku barisnin, dhe te sillte driten e diturise dhe udhen te drejte.

Dhe ashtu vazgonte Jesu Krishti udhen per ate qe ish dergoare, po Krishti kish dhe ay trup njeriu, dhe ashtu ndjente dhe ay te lodhur dhe deshperim



per te pabesit Chitfute. Dyke shikoare Jesu Krishti Iudhejnte kesi soj, u thosh nxenesve.

Be frone te Moisiut kane ndenjor Farisejnte dhe Glykatesit (Shkronjesit). Tetera sa tu thone ti mbani, i mbani dhe ti beni; po pas punrave te tyrve mos beni: thone dhe nuku bejne, po shikojne si e si te rojne me ndirsen te se varfreve dhe si tu rembejne malle dhe xdo te mire qe kane.

Dhe pastaj kthente fjalen de keta Krishti dhe u thosh.

Vaj, jyve, Glykates dhe Farisejn ipokrite, qe mbylni mbreterine te Qjejeve perpara njerezive. Jyve nuku hyni dot po slini as atá qe mundet te hyjne. Vaj, jyve, Glykates dhe Farisejn ipokrite, qe prishni shtepite te se vejave, dhe me buzet, gjate fali... Vaj, jyve, Glykates dhe Farisejn ipokrite, qe spastroni qelqin sa duket jashtazi, po brenda mbushur grabitje dhe padrejtesi. Vaj, jyve, qe u ngisni vareve te gdhendur, atá qe jashtazi duken te bukur, dhe brendazi koska se vdekuresh dhe pa spastrime.

Keshtu dhe jyve jashtazi juduki njerezive te drejte, dhe brendazi te turbull ipokrisi dhe paudhesi.

Pas ketyrve dhe shume te tjera fjale qe u tha Krishti Farisejnve dhe Ligjembesonjesve de mest te mijrave njerës, dhe me ate gjuhen me te forte per Pleqesine dhe Farisejnte, zu te helmohet, zu te ndjente helme be shpirtin e paqme te Tij, dhe ndjente simbathi dhe me te dhembur be shpirtin. "Jerusalim, Jerusalim, qe nxore Profetet dhe i zure me gure te dergoarit ne ate, sa here desha qe te mbleth evlatet tend si kundre i mbleth pula zochkat e saj dene krahet, dhe nuku deshte; Ja ku u lihet jyve shtepia tuaj e shkrete. U them tashi jyve:

Nuku do me shikoni qe tashi ger mos thuani: I bekoare eshte ay qe vjen me emrin e Zotit.”

Tjatre here kur po afroshin Pashket e Chifutve shkoj nga Kapernaumi Krishti dhe u ngit de Jerusolim. Porsa hyri de Kische kur shikon shume qe shishnin lope, dhen, pellumba, dhe te tjera, nuk' umbet kohe po menjhere i nxori jashte dhe atyrve te pellumbave u tha: “Mos beni shtepin' e ates tem shtepi tregetie.”

Iudhejnte si pane keto ardhe perpara Krishtit dhe e pyetne me cillin pushtet ben keto. Dhe ay u pergeq. “Xghidheni kete Kishen dhe de tre dit ta ngre ate.”

---

## KRYE II.

---

### PARATHENJA E DHRAMES

---

#### KISHA E SOLLOMONIT

Keto fjalet judukne te renda Iudhejnve qe tha Krishti, judukne te aspra dhe te kuturitura shume.

Te rezoje Kishen e Sollomonit; Ay te kuturise te fjaloset kesi soj per kete Kische qe eshte nje prej te shtata chudite e botes; dhe te kuturise te hynje brenda dhe te nxjere popullin jashte dhe ta qyaje shtepin' e atit a te tijne; Dyke kembere fjale Chifutet kesi soj ca i thane Krishtit. Dyzet e gjashte vjet u mbushne sa u mbarua kjo Kische dhe ti dota gresh de tre dite.

Pa mos kupetuare Chifutet chdesh te thosh Krishti, Chifutet kishin te drejte te zemberoshin dhe te mburshin per ate Kishen se vertet ajo Kisha ish nje me vjetra, si per istorin' e tyrve si per mjeshterine si per te hollat qe ishin derdhur ne ate pa mase,

dhe vertet shkoane dyzet e gjashte vjet ger sa u mbarua. Me gith keto Krishti nuku desh te thosh gje per kete Kishen kur tha qe prisheni dhe une de tre dite do ta ngre. Ay tha per trupin e Tij qe po afroshin ditet qe do vriteshe dhe te treten dite do ngjalleshe.

Kjo Kiske u be prej mbretit Sollomon nje mije vjet me pare prej kohes se Krishtit be nje kondre e qyojtur Moria, dhe kjo kohe ish me bukura per Iudhejnte, me lumtura, dhe plot gezim per atá. Mbret' i tiros e desh shume aten e Sollomonit Dhavidh, dhe kur mbesoj vdekjen e Dhavidhit dhe ipjen e Sollomonit be frone, i dergoj djemt' e tij de Sollomoni. Sollomoni i kenaqi shume djemt' e Hiramit mbretit se Tiros, dhe u tha atyrve qe kuturisi te benje Kishen e Zotit, dhe i luteshe mbretit Hiram qe ti dergoje mjeshtre te provuare per kete Kiske se ne Iudhene nuku gjenchin te ketille njeres. Mbreti Hiram porsa mbesoj i dergoj shume mjeshtre Sollomonit per te ngritur kete Kiske, dhe per vech mijrave qe kish Sollomoni dhe sido qe ishin pothuaj tere atá qe punonin per te ngritur kete Kiske dyqind mije, bene tre vjet ger i bene guret te bukur dhe druret gati, dhe ashtu pas dyzet e gjashte vjet u mbarua kjo Kisha qe ish nje nga te shtatat chudira te botes. Chifutet kishin te drejte per kryelartesine e tyrve per kete Kiske, dhe ne kete mblidheshin Chifutet te degjojne fjalet e Krishtit dhe te shkrojturat e Profetve, dhe atá qe i lechitnin dhe i degjonin po as u jepnin donje rendesi.

Dyke folur ashpre Krishti bi Farishejnte dhe Glykatesit, qe benjeret ane refesheshin si te shente dhe be tjetret ane i xvishnin te varferit dhe ronin me ndirsen e tyrve, atá zune mentoshin te gejne shkak per kete dhe pyechin njeri me tjetrin dyke thene;

chbejme; Ky njeri shume gjera ben: Po ta leme kete, tere populli do besojte de ky, dhe po te mbesojne dhe Romanet nuku eshte chudi te na edhin jashte dhe ashtu umbasem neve dhe populli jone.

Kryepriifti Kaiafa propunoj dhe tha qe eshte e drejte te vdese nje njeri per popullin, dhe jo populli per ate. Ky propunim u pranua prej te terve, dhe njeriu nuku do ish tjatere, po vete Krishti ay qe u jepete drite dhe atyrve u dukshe eresire, ay qe i mjekesonte prej xdo semundje dhe ngjallte.

---

### CHUDIA E FUNDIT

Thame me sipre qe Krishti beri shume chudira, sheroj te verbe, uloke, dhe xdo semundje qe kishin si dhe qe ngjalli shume, dhe me de fund ngjalli Lazare kesi soj.

Nje dite Krishti u thir de Vithani qe te mjeke-sonte mikun e Tij Lazare me qe ish semure, po Krishti nuku vajti ate dite, dhe pas tre ditesh vajti de Vithani dyke patur pas dhe nxenesit te dymbdh-jete. Po miku i Tij Lazari kish vdekur prej katere ditesh me pare dhe ish varosur.

De shtepine te motrave se Lazarit Marthes dhe Marise ishin mbledhur shume njeret qe te ngushel-lonin ato. Kur arijti Krishti atje te motrat e Lazarit i tane: Zot po te kishe ardhur me pare pa vdekur vellaj tone besonim qe ta kishim te ngjalle sot, po tashi vdiq dhe u varos. Jesu Krishtit juderdhe lotet dhe i pyeti ku e kane varosur.

Te motrat e Lazarit dyke qjare dhe megith miqte dhe sojne qe u ndodhe be shtepine te tyrve, vane dhe i refene Krishtit vare.

Dhe Krishti tha, xbuloheni: Po Martha uper-geq, jo Zot, se eshte prej katere ditesh i vdekur dhe

mbanhere: po Krishti nuk' upergeq de fjalet e saj, dhe dyke gritur syt' e Tij be qjellin u fal de Ata e Tij: Ate jam i kenaqjur se me ke degjoare, dhe gene do me degjosh qe te shikojne dhe tere keta njeres dhe te besojne qe ti me ke dergoare, dhe i thiri te vdekurit. "Lazar dil jashte" dhe pernjeresh dolli nga vari prej katre ditesh i vdekur Lazari lidhur kembet dhe duarte me qirijn pas zakonit.

Xgidheni ate dhe lete shkoje tha Krishti, ashtu dhe u be. Kjo chudi i beri Iudhejnte te chuditen, dhe vane i thane Farisejnve dhe Glykatesve per kete, po dhe nxenesit e Tij u chuditne, se nuku e kishin pare Krishtin te ngjalle tjatre here te vdekur prej katre ditesh dhe te varosur, dhe per andaj e besoane me shume, dhe dashurine de ay eshtuane pa mase, keshtu dhe Iudha po ne vend qeteshtonte dashurine de Krishti, zemra e tij u kthye kondra, dhe qe ate dite Iudha zu te shtroje programin te eret per Krishtin, dyke mentuare dhe dyke thene qe porsa ka jete te pasosur, dhe mbreteri te pasosur, dhe dyke ngritur njeriunga vari vdekja umbet, dhe pse une nukumund tengjallem; perse jo; Mbesonjesi na tha qe potekemi bese mundet ti lozem edhe malet si te duame, po lete shikojme dhe shkoj tok me nxenesit dhe me Krishtin qe u drequane per de Vithfagi.

---

Porsa arijti Krishti de Vithfagi prane Malit te ullijnve dhe pas ngjalljes te Lazarit, dergoj dy nga nxenesit e Tij dyke thene.

"Me te vajtur per balle ati fshatit do geni pulisht lidhur dhe mez me ate, xgidheni dhe silleni ketu. Dhe po tu thote donje, gje, pergjegjuni. Qe Zoti nevoje ka. Nxenesit vajtne dhe e gjetne pulishtin e xgidhe dhe e sualle perpara Krishtit."

Si u be kjo, Jesu Krishti gatiteshe te hynje de

Jerusalim. Dhe populli qe i vinin pas vune roba bi pulishtin dhe ndejni Jesuj. Dhe kesi soj Krishti me-gith popullin qe i vinin pas u nisne per de Jerusalim dyke mbushur dhe fjalet e Profetve. "Thuani vaizes Sion: Ja Mbreti po vjen me butesi, ipur bi pulishtin dhe mijra pas."

Populli qe i vinte pas Krishtit, ca shkonin perpara dhe prisnin dege prej drurve dhe i shtronin be udhet qe te shkoje Krishti bi ato, dhe te tjere shtronin robat e tyrve. Ky udhetim ish nga me te shinuar-it, dhe populli me gezim thirte, "Osana birit te Dha-vidhit. I bekoare eshte ay qe vien me emrin e Zotit, Osana me te lartat."

Keshtu Krishti hyri de qytetin e shente Jerusa-lim, dyke vaitur pas shume njerës, atá qe ndjenin gezim pa mase. Kjo hyrje e ketille i drodhi Farise-jnte dhe Glykatesit, dhe kerkuane chkoqitje nga Krishti qe te mbesojne per se tere ay popull ish mbledhur dhe thirte, Osana, dyke gezuare dhe dyke shtruare dege dhe robat be udhen qe te shkonte ay per bi ato. Dhe Krishti u pergeq. Nuku kini lech-itur, "qe nga goja e foshnjave dhe thethitesve do ngre lavdi"; dhe shkoj prej ati qyteti.

Farisejnye Glykatesve dhe Kryepriftijnve jud-ukne te renda keto fjale si kurdohere, dhe me shume kur shikonin popullin qe e besonin Krishtin dhe e lavderonin ate, po edhe populli zu ti shikoje me sy te lik Farisejnte dhe Glykatesit per udhen te lige qe kishin zene.

Pak kohe me pare kur kishin nje mbledhje, dhe Kaiafa tha qe duhet te vritet nje njeri dhe jo tere populli, dhe ky njeri ish Krishti, po deshin ta zene me rast kur te mos kish shume njerës pas, se kishin frike mos egersoshe populli bi atá dhe e leshonin Krishtin gene. Dhe mentoshin qe si ta zene, kane

perse ta gykojne, se ay kish thene qe ish i biri Perendise, dhe vinte kontra ligjes se Maisiut dyke mos mbajtur te shtunen, dhe qe do prishte Kishen e Solomomit dhe shume, t.t.

Dhe thoshin qe populli dote binche ner atá dyke shikoare kur te gykoheshe, dhe do besonin qe ay ish magistan. Farisejnte dhe Glykatesit kishin te drejte dhe nuku genjeheshin kur mentonin per bindjen te popullit, se populli shume here eshte si donje djalke pa mend ay qe genjehet prej me te madhit dhe nuku kupeton prishjen e tij, ashtu edhe populli shume here peson prej Kryetarve a Udheqesve te tij pa mos kupetuare prishjen, keshtu Farisejnte dhe Kryepriftijnte kerkonin rastin qe ta zinin, pa mos pare populli. Iudha si mbesoj te fsheurat e Farisejnve, zuri te mentohet per programin e tij, dhe priste rastin dhe ay.

---

## FUNDOMENDI

Si shkoj prej Jerusalmi Jesu Krishti, ukthye de shtepine e Lazarit te ati qe e ngjalli, Lazari u gezua dhe e priti Krishtin dyke shtruare tryesen per darke me gith nxenesit e Tij, dhe dyke fjalosur Krshti tha, qe kjo darke esht' e fundit de kete shtepi, po nxenesit e Tij qe ishin prane pa mos kupetuare chdes te thosh Krshti nuku i dhane rendesi asaj fjale.

Pashket e Iudhejnve po afroshin dhe Kisha e Sollomonit po xbukuroshe, se de ate Kishe vinin pervech Jerusalmimit dhe tere Paleshtini, po dhe nga Arabia, qe te kremtojne Pashket atje.

Dhe nxenesit e pyetne Krishtin, ku do kremtojme Pashket: Krishti u refeu nje shtepi dyke thene, chapuni dhe i thuane te Zotit se shtepise, qe koha

mu afrua dhe de tu do te kremtojme Padhket me gith nxenesit tem.

Nxenesit vane dhe bene sich u tha Krishti, dhe mbremanet vajti dhe Krishti me nxenesit te tjere, po perpara darkes mystike, U ngrit Krishti dhe zu tu lanje kembet nxenesve, po atá u kondrashtuane dyke thene, neve duhet te lajme kembet tente dhe jo tine tonat. Po Krishti u tha lermeni te mbaroj punen teme per ate qe jam dergoare, se kjo eshte shembell per jyve, keshtu duhet te silli dhe jyve ne te tjerit. Dhe si u lavi kembet nxenesve zu u thosh be darken, qe ardhi koha qe te pesoj per ligesite te njerezive, dhe u la fundomendin (dhiathiqin) me keto fjale.

“Duaheni njeri tjetrin,” po te kini dashurine de mest tuaj, tere do tu dine qe nxenesit tem jini, se dhe pak jam me jyve, vete te pregatit vendin, jyve nuku mundet te vini pas meje, po gene do vijn tu mar jyve dhe tu shpje de Ata, se asnje nuku mundet te vinje de Ata per vech me muva.

Filipi pa kupetuare mire tha.

Refeme Aten dhe mjafton.

“Per kete Krishti upergeq. Kaqe kohe me jyve isha Filip, dhe nuku me njohe; nuku beson qe une de Ata dhe Ata de muva”; Dhe zu po u chpengonte qe tere sa beri, me fuqin' e Ates i beri, dhe i mallengyere u thosh, po te kini dashuri, besim, dhe te mbani porosite teme, do beni chudira me te mbedha prej meje, dhe ay qe do muva eshte i dashur de Ata tem, dhe une dota duva ate.

Dhe pas shume fjale te tjera Krishti u tha nxenesve dyke dhene kurajo qe mos helmohen, se po mos veje de atá nuku mund te vinte ner 'ta frum' e shentuare dhe u thosh gene, dashuri bi jyve. Do qjani tha, dhe do cfiliti, dhe bota do gezohet, po ay helmi



tuaj do kthehet gezim, dolla nga Ata dhe u perapa ne boten, gene e le boten dhe do vete de Ata.

Dhe dyke kthere fjalen per kohen qe afroshe te pesonte dhe te vriteshe tha.

Ay qe do me tradhetoje eshte me jyve . . . une do tradheto hem, po mjer ay, me mire mosh ish lindur, po keshtu eshte urdheri i Ates, dhe duhet te vdes une, qe te shpetojne njerezia atá qe do me besojne, se ja ariji ora qe do perndai dhe une do mbetem vete, po jo vete se do kem áten prane, dhe jyve mos deshperoj. Dhe dyke ngritur syte lart Jesu Krishti u fal de Ata, si edhe per nxenesit e Tij te dashur qe gjenchin tok prej shume kohe, dhe u tha: Nje prej jysh do me tradhetoje sonte, dhe pernjeresh nxenesit zune te shikohen sy ner sy, kur nje prej nxenesve qe ish prane Krishtit e pyeti: Zot cilli eshte ay qe do kuturise tete tradhetoje tu;

Dhe Krishti si pa qe tere nxenesit u abitne, tha. Ati qe do ti jap nje Fele buke te ngyere me vere ay eshte, dhe mori nje fele buke dhe si e ngyejti me vere de qelqin ja dha Iudhes dyke thene. Bej chke per te bere nje ore me pare? Dhe Iudha nje te mare buken me vere, dhe si degjoj fjalen e Krishtit, dolli jashte dhe dyke ditur se ku do te vinte Krishti pas darke, ay u dreqtua per de Farisejnte dhe u tha si mundnin ta zene Krishtin ne rastin me te mire. Farisejnte dhe Glykatesit porsa degjoane me kujtes Iudhen, i dhane tridhjete ergende si chperblim qe te mbaronte kete pune.

Pas pak dolli dhe Krishti me nxenesit e Tij, dhe u afrua prane Malit te ullijnve dhe hyri de nje gradine te shkrete e qyojtur Gesthimani. Udhes u tha Krishti nxenesve: "sonte do grackosi," dhe Petri i tha: kure nuku do grackosem. Dhe Krishti i tha: Sonte pa thirur kendezi do me mehosh tri here. Dhe

si hyne de Gesthimani u tha nxenesve te qendrojne atje, dhe ay me Petrin dhe vellezerit Zevedhenjes u largua pak qe te falen.

Ora e deshmorit po afroshe, dhe ay e kupetonte, e shikonte, dhe pesonte si njeri, dyke pushtuare prej nje si frike dhe dyke ditur qe do vriteshe, dhe u tha nxenesve: I helmuare eshte shpirti tem ger be vdekje.

“Dhe dyke falur thosh: Ate, po te jete e mundur, le te iqet ky qelq prej meje, po jo sich duva une, po sich de duadh Tine.” Dhe me qe i kish lene Zevedhejnte dhe Petrin pak me lark prej Tij, dhe me qe ish vete Krishti kur faleshe, juduk Engijelli dyke xbritur prej Qjelli dhe i dha kurajo: Dhe kur u kthye atje prane ne te tre nxenesit, i gjeti qe flinin dhe jutha me nje dashuri te vechante.

“Flini dhe chlodhi: Ja ariji ora dhe i biri njeriut jepet ne duar te mekatosura. Greuni, veme, ja u afrua muvadhnesi.”

Farisejnte dhe Glykatesit ishin mbledhur ate nate dhe po bisetonin si ta zene Krishtin, po dhe Iudha qe kur engren darken de Lazari dhe kish mbesuare te fshetat e Farisejnve kish bere dhe ay programin e tij, dhe per andaj pas darkes se pastajme qe u lavi krishti kembet nxenesve dhe u tha qe, ay qe do me tradhetoje eshte me jyve, dhe pas darkes qe ajo darke u qyajt darka mystike, dhe Iudha porsa mori felen buke, shkoj per de Farisejnte, dhe dyke hyre de mbledhjet u tha. Chmejepni qe tu tregoj rastin me te mire qe ta zini Krishtin: Farisejnte kur degjoane u gezuane dhe pernjeresh vune tridhjete ergente perpara, dhe si e degjoane Iudhen me kujdes qe si te zihet Krishti jadorezuane te hollat.

Pas ketyrve Farisejnte dhe Glykatesit dergoane

sherbetoret e tyrve dhe ca te paket ushtare Romane qe u ndodhe atje dyke kujdesur per Kishen, dhe me Iudhen perpara u nisne per ne gradinen Gesthimani, dhe udhes Iudha jutha ushtarve Romane atá qe nuku enijnin Krishtin: Cillin te puth une ate zereni. Dhe keshtu vazgonin udhen qe te zene Perendine.

---

### KRYE III.

---

#### NISJA E DHRAMES

##### Eputhura e Iudhes

Krishti i dinte tere keto, dhe per andaj pas faljes dhe kur i gjeti te tre nxenesit qe flinin u tha. Greuni se ja po afrohet muvadhnesi, (ay qe do me jape) de duarte te mekatarve me tradhesin' e tij.

Dhe porsa u bashkuane me nxenesit te tjere, u duk dhe Iudha megith chifutet dhe ushtaret Romane dyke mbajtur drita qirijnsh dhe feneresh ne duart' e tyrve.

Iudha i mbulosuri nxenes judreqtua Krishtit dhe i tha. Gezou Ravvi (mbesonjes) dhe pernjeresh e puthti.

Dhe Krishti i tha: Me te puthur tradheton bire te njeriut; Dhe popullit i tha: "Cillin kerkoni"; Jesune Nazaretasin u pergeqne atá.

Une jam.

Po ushtaret nuku kutturisne te veneduarte bi Krishtn, ay qe i pyeti gene dhe jutha. "Juthashe; qe une jam: dhe me qe muva kerkoni, lini keta te shkojne."

Dhe kur vune duarte Chifutet qe ta zene Krshtin, Petri nje nga nxenesit e Krishtit oqi thiken dhe i preu veshin nje nga sherbetorve te Farisejnve,

Malho i qyotur. Po Krishti menjhere e mori veshin dhe ja ngjitit, dhe Petrit i tha: Petri? vere thiken de kllëfin: qelqin qe me dha Ata, te mos e pi une:

Dhe e zune Krishtin ushtaret dhe sherbetoret e kryepriftinjve dhe Pleqve, dh' e shpune lidhur ne shtepine te Kryepriftit Kaiafa, atje ku ishin mbledhur Glykatesit dhe Farisejnte si dhe Kryetaret e Synagogise. Pernjeresh nisi gjyqi: Kaiafa e pyeti Krishtin per shkakun te mbesimeve de populli dhe nxenesit e Tij. Dhe Krishti u pergeq dhe i tha: Qe tetera sa bera nuku i bera se fsheura po de mest te popullit, de Synagogi de Kishe dhe kudo qe mblidheshe populli: "Chme pyet; Pyeti atá qe me degjoane chu thashe."

Farisejnte i dinin tetera ato, dhe per andaj pergegja e Krishtit nuku i ardhi mire, po as qe te pyesnin popullin u vinte mire, dhe u ngrit nje me fanatiku nga sherbetoret e Farisejnve dhe i oqi nje shuplake suratit Krishtit dyke thene, keshtu i pergegjes Kryepriftit; Pastaj ardhe dhe te tjere dhe thane qe Krishti ka thene, se une mund ta prish Kishen e Perendise dhe ne tre dite ta ngre gene.

Dhe Kryeprifti kerkoj nga Krishti Pergegje dhe chkoqitje per kete deshmim, po Krishti nuk' u pergeq. Ahere Kryeprifti i tha Jesujt. Te ve me be per Perendine te gjalle, qe te na thuash, de je ti Krishti i biri Perendise." "Ti thua?" upergeq Krishti. Po une juthem, qe perpara e kini.

Dhe kryeprifti u duk si kur u chudit me pergegjen e Krishtit, dhe dyke ngritur u thote te tjervet se mbledhjes. Chnevoje kemi per te tjere deshmimes bi kete; Ky shau, apo nuku e degjoni deshmimin e Tij, qe vetjen te bir' e Perendise e beri; Chkupetoni; "Fajtor per vdekje," upergeqne tere dyke bertitur. Kur beshin tere keto Petri kish rene

pas Krishtit qe te shikoje xdo ta bejne, dhe ashtu hyri me popullin tok de vorot (obort) te Kryepriftit prane nje zjari qe kishin ndezur sherbetoret e Kryepriftit, dhe rinte atje. Po ca nga sherbetoret enjojtin dhe i thane, qe edhe ti nga nxentt esit e Tij je: po ay u tremb dhe e mohoj Mbesonjesit: pas pak ardhi nje sherbetore dhe si enjojti, u tha te tjerve: dhe ky me Jesu Nazaretasin eshte: Petri e mohoj gene dyke thene, as qe e kam pare ate njeri: Ardhe dhe te tjere dhe i thane ati: vertet dhe ti ng' atá je se erefen zeri tend.

Ahere Pettri zu te protestohet me be de atá q' e pyetnin qe nuk' e nijnte fare ate njeri. Dhe ne chast thiri kendezi: Petri u kujtua qe Jesu Krishti i kish thene ate nate, "pa thirur kendezi tri here do me mohosh," dhe zu te pendohet, dhe me qe nuku desh ta kupetonin Chifutet, dolli jashte vorose dhe qjajti me idherim dhe me lot, se i vinte keq, po me shume se u refe besepaket i frikshme, dhe qe mohojti Mbesonjesin e Math.

---

Mbledhja e Kryepriftijnve i dhane fund qe te vritet Krishti, dhe dyke mare Krishtin qe ta shpinin de Pilati Qeveritari udhes e rane epeshtyne dhe e goditne me rypa, po ato buzet e shenta qe me pare nxirnin ato fjalet me te bukura, nuku apshin tashi, po i duronte tetera si pa donje te keqe prej ati te pabesit popull.

Pasi e rane sa deshne e lidhe gene dh' e shpune de Pilati dhe kerkonin prej keti qe te deneshkruante te vritet Krishti.

Ay istoriani i kesaj libre Enea chifut, kesi soj shkroan kur eshpune Krishtin de Pilati.

Qeveritari Pilat po priste dyke pasur dhe ca ushtare prane me flamure de duar, dhe porsa

hyri Krishti atá ushteret pa dashur u unjne me gith flamuret dyke falur Krishtit, dhe Pilati kur pa kete u chudit dh' e nxori Krishtin jashte, dhe pa si thire atá qe e sualle Krishtin, ver te tjere njerës te shendoshe te mbajne flamuret, se atá qe ke vene flene be kembe.

Dhe ashtu Pilati vuri te tjere, dhe kur hyri Krishti gene edhe atá ju fale pa dashur, ahëre chifutet thire është Magistan dhe per andaj i ben tere keto. I thote Pilati Krishtit. Degjon! deshmonjesit chthone per ty; dhe Krishti upergeq. Xdo njeri mundet te thote si te doje. Dhe Iudhejnte i thane Krishtit. Kemi te themi per ty, se e para qe me mekate ulinde, dhe e dyta, se per ty kur ulinde u there katrembedhjetë mije foshnja ne Vithleem, dhe e treta áta dhe nena tende ikne de Egípt se nuku kishin sy de populli.

Kur degjoane keto fjale njadymbëdhjetë chifute qe kujtonin Perendi u odhe dhe thane. Neve e dime qe lindja e keti nuku është me mekate sich thuani jýve, nenja e keti Maria, nuk' u martua me Josifin, po mbeti sich ish vetem evleseruare, dhe qytetin te ketyrve edime shume mire. Dhe keta chifutet qyeshin kesi soj. Lazar, Samuil, Finne, Nikodhimo, Krispo, Dhagrippa, Evmese, Iudha dhe t.t. Dhe u thote gene Pilati atyrve: Per emrin te Qesarit te me thuani, qe a ulind pa mekate ky njeri. Dhe atá i thane, dyke bere be, qe ky njeri u lind pa mekate, dhe po te duash mbana neve dhe pyet, dhe de genjejme denona pas ligjes. (Nomit).

Ahëre u oth populli dhe i tha Pilatit: Keta nje dyzine njerës do besosh apo tere popullin; Per kete q' është nje Magistan dhe dyke qyotur veten e tij te bir' e Perendise; Dhe pastaj Pilati urdheroj te dalen jashte tere vech atyrve te dymbëdhjetë dhe

jutha fshetasi. Kete njeri sa kupetoj une chifutet nga nakëri i verbe duane ta vrasin, dyke thene qe nuku mban te shtunat, se sheronte te semure, ajo qe eshte nje mireberje. Dhe atá te dymbedhjete upergeqne me nje ze, vertet Zoti tone kjo esht' e drejta. Keshtu Pilati i zemëruare dolli jashte dhe u thote Annes dhe Kaiafes si dhe popullit. Chte lige ka bere ky njeri, dhe me chuare qellim e suallte ketu;

Populli upergqe dhe tha: po te mos ish ky fajtor dhe Magistan, qe ka share dhe ka bere te liga, nuku do ta sillnim de Madhesia Tende dhe te ta dorezonim.

Ahere Pilati ukthye be vendit te tij, dhe si e thiri Krishtin i tha: Ti je mbreti i Iudhejnve; Krishti upergeq dhe itha: Tine thua, apo te thane Iudhejnte te me pyech; Dhe ay i tha: As qe jam Iudhe une; Populli Iudhejn dhe Kryepriftijnte te dhane ne duarte teme, dhe me thane qe ti je mbreti Iudhejnve: Dhe Jesu Krishti i tha.

Mbreteria teme nuk' eshte nga kjo bote. Dhe Pilati e pyeti: Po je mbret; Upergeq Jesuj: Ti thua: une be kete u linda, te deshmoj te drejten: Dhe Pilati i tha: cilla esh' e drejta; Dhe Krishti upergeq: une jam e drejta, qe fjalos te drejten.

E la Krishtin Pilati dhe dolli jashte dhe u thote Iudhejnve: Une as nje shkak per vdekje nuk' i gejn keti njeriu: Chifutet u pergeqne dhe i thane: Ky ka thene qe mundet ta prishe kete Kishen dhe te tre dite ta ngrere gene, ate qe e ka bere Sollomoni ne dyzet e gjashte vjet. Dhe si u ngrit Kryeprifti i tha Krishtit: Te ve me be per Perendine te gjalle, qe te na thuash, tine je Krishti i biri Perendise? Ti po thua: Po une juthem, se qe thashi dote shikoni te bir' e njeriut ndenjor be te djathte te Fuqise dhe dyke ardhur bi rete be qjell.

Kete pyetje e beri Kaiafa se e dinte qe Krishti nuku dote mohonte chtha me pare, dhe si tha Krishti keto fjale, Kryeprifti ju kthe Pilatit dhe i tha, qe me te math deshmim te faitorit nuku mundeshe te kerkonte.

Qeveritari Pilat thiri Kryepriftijnte dhe Pleqte dhe u tha, qe nuku esht' e drejte te vritet kesi soj njeri, ay qe shume te mira i beri popullit Chifut, dhe u tha atyrve qe ti thone popullit mos threse po te urtesohet.

Dhe Kryepriftijnte upergeqne.

Po te chnderoje donje Qesare, fajtor per vtekje eshte, po ky shau perendine; Ahere Pilati, i thote Krishtit: Xdo, tete bej? Dhe ay i tha: bejme sich eshte vendosur: Moisiu dhe Profetet kane shkrojtur qe do me kryqjosen dhe do ngjallet: si degjoane keto Chifutet i thane Pilatit: Edhe me te madhe te share kerkon; nuku degjove prej tij se chtha per Perendine; Dhe Pilati tha, qe nuku eshte e share kjo fjale per Perendine, se keto fjale gjenden te shkrojtura ne librat.

Dhe Iudhejnte i thane: E shkrojtura jone thote: po te shaje njeriu njerine, mer dyzet plage me shkopin, dhe po te jete se shan Perendine, zihet me gure. . . . Dhe ne ate ore ardhi lajme nga e shoqja e Pilatit Prokli dyke thene, kujdesu dhe mos u ngadh-ero, per ate, se sonte endra te liga kam pare per ate.

Dhe Pilati u tha Iudhejnve: Po te jete e share de Perendia ajo fjale qe tha Krishti sich thuani jyve, mereni jyve ate dhe gykoheni pas ligjes tuaj.

Kryepriftijnte dhe Glykatesit i thone Pilatit: neve duame qe ta kryqjosesh ate. Dhe ay i tha: nuk' esht' emire kjo: chte lige beri; dhe atá i thane: mbret vetjen e tij e ben dhe te bir' e Perendise. Nje njeri Chifut, i qyatur Nikodhimo (I), qendroj de



mest dhe tha: Chfjale kini bi kete njeri; Ky shume chudira ben, ato qe sika bere as donje prej njerezive kure ger be sot per vech keti. Leshoheni kete dhe po te jete prej Perendie, tere ato sa beri, do te jene te gjalla, dhe po te mos jete prej Perendie, ato do treten, si kundre u be kur dergojti Perendia Moisine ne Egipt de mbreti Farao dhe beri nishane qe te besonte Faraoj dhe te linte Iudhejnte te dilnin jashte, po dhe Faraoj thiri Magistanet e tij Jannin dhe Jamvrine dhe keta bene nishane, po me njhere u tretne nga shkopi i Moisiut, se ato nuk' ishin prej Perendie, megith qe Egjiptasit i kishin atá Magistanet si Perendi. Po Krishti per vech chudirave te tjera qe beri, ngjalli dhe Lazare prej katre ditesh te vdekur dhe te varosur, dhe ay eshte i gjalle sot, dhe une edi ate fort mire.

Dhe dyke kthyere Pilatit dhe dyke lutur itha, qe punrat e ketij jane te gjalla, sot per nakere te Farisejnye dhe te Glykatesve, dhe per andaj te lutem qe te mos japesh leje te vritet nje i ketille Mjekes.

Si degjoane keto fjale Farisejnte dhe Glykatesit u zemberuane shume bi Nikodhimon dhe i thane: Per te vertetten? tine nga Krishti ndimon, dhe duket qe te jesh dhe ti me ate: dhe Nikodhimoa tha: vertet, vertet ka dhe te tjere te fjalosin, dhe u ngrit nje Chifut tjatre dhe i tha Pilatit: Zoti jem, te lutem degjome: une isha isemure be shtratin tem per tridhjet' e tete vjet, dhe kur me shpune de ky, menjhere me sheroj, kesi soj thirnin dhe te tjere qe i kish sheruare Krishti, dhe te tjere thane qe ky ngopi me pese buke dhe dy pisht de shkretetiren pese mije shpirt

Dhe Pilati i thote popullit: Zakoni eshte qe Pashkevet leshojme nga nje te burgosur, cillin duani te leshoj, Varavvane apo Krishtin; dhe atá uper-

geqne: Varavvane, Varavvane leshoje, dhe Krishtin mbaje: dhe Pilati thote: po chtabes Krishtin; Kryqjose ate, se ay e qyajti vetjen e tij mbret dhe bir te Perendise.

Pilati u keqesua kaqe sa u tha Chifutve: githnje kombi tuaj, keshtu kini qene diaij dhe te pa bese, dhe der atá qe u kane bere mire ligesite u kini dhene:

Dhe Chifutet i thane: cillit jane atá qe na kane bere mire; Pilati upergeq: Perendia qe u shpetojti nga dora e Faraojt dhe kaperzuhete detin e kuq si be stere, dhe dyke dergoare per te ngrene nga Qjelli dhe uije nga gur' i thate, dhe ay qe ligjet ja u dha, dhe po te mos ish falur Moisiu per jyve, vdekje te idhur do te gjenit tere, dhe tashi mohoni dhe Perendine.

Dhe Chifutet upergeqne, neve Qesare duame te mbreteroje dhe jo Krishtin, se per andaj dhe mbreti Irodhi kur ulind ky, desh ta vrase dyke pasur frike se mos i merte mbreterine e Tij, dhe per andaj i vrau tere foshnjat e Vithleemit qe prej tre vjeh e poshte, dhe Prindet e keti e shpetuane kete dyke ikur per ne Egipt. Dhe pas ketyrve populli zu thirte gene, kryqesoje, kryqesoje ate. Dhe Pilati u thote: Mbretin tuaj te kryqjos; Po atá me shume thirnin: kryqjose, kryqjose neve nuku kemi kete mbret po Qesare.

Pilati si pa keshtu qe vetem zera degjoshin, kerkovi uije nga ca ushtare, dhe dyke lare duarte per para popullit Chifut, tha: Ikulluare jam prej gjakut se keti te drejtit,, dhe jyve ta dini qe pa donje faj e vrisni. Dhe Iudhejnte upergeqne: Gjaku i ketij lete bjere bi neve dhe bi femihen tone. Kur beshin keto, Kryepriftijnte nxitonin ta ubisnin Krishtin nje ore me pare. Dhe Pilati i tha gene Krishtit: Mos je mbret' i Chifutve; po Krishti nuk' upergeq: dhe

Pilati i tha: Muva nuku me pergeqjesh; nuku shikon se kam pushtet tete kryqjos a tete beshoj. Dhe Krishti upergeq dhe i tha: "as donje pushtet nuku do kishe bi muva, po te mos ne ty qenke dhene prej larti."

Pas ketyrve ndejni Pilati be nje Fron te larte, qe te jape kuturine per Jesu Krishtin, urdheroj dhe ardhi Krishti perpara Tij, dhe dyke vene bi koken te Krishtit nje kurore prej gjembash dhe si e veshne me nje robe te kuqe purple i dhane dhe nje kallam de doren e djathte qe te dukshe si mbret, dhe si kuturisi Pilati i tha ati. Kombi tend deshmon per ty qe kerkon te mbreterosh, dhe per andaj urdheroj, qe tete lidhen per kollonen, dhe tete bejne se pari me shkopin plage dyzet, si pas ligjeve te mbreterise, dhe pa si tete perqeshen, me de fund tete kryqjosen. Dhe edha kuturin kesi soj.

---

## KUTURIJA

Mot i shtatembedhjete Tiverit Qesar mbretit Romaneve, Monarkut pamundur, Olymbikun nje qind e njezet enje, Djellit se tete prej berjes se Botes pas tones dhe me ndarjen te Chifutve katre mije e nje qind e shtadhjete e katre vjet, dhe hyrjes te Romanve mbreterise vjet shtatedhjet' e tre, dhe lirise se roberise Babilones vjet nentedhjet' e shtate, Sumfenderetvet te popullit Pomane Luqise dhe Pizonise, dhe Parkut Pavsaniut, dhe Sumfenderit se Illirianve Ballerit Palister, Kryegykates i qytetit Jerusalim i madhi Qeveritar Pilati, Perkujdesesi te se poshtmes Galile Irodhit se dyte, te se pares kryeshenterise Anna dhe Kaifa: Alinatit dhe Mail te madhit de Kishen Rambam Amabel Gjoktino, kryeqindarit Sumfender se Romanve dhe qytetit Jerusalim Kornili Sublima Seksit Boblio Rufa, de muajne

Mars 23, une Pondi Pilat Qeveritari prej Mbreterise Romane perbrenda Pretorit se Qeverise gykojn dhe bivotojn per vdekje Jesune te qyatur prej popullit Krisht, Nazaretasi, dhe prejatdheu Galile, njeri kryengrites te ligjes se Moisiut, dhe perbi madhendritjesine mbretit Tiveri Qesar.

Biurdherojn dhe kuturis per kete, qe vdekja e keti te jete be kryqin, po me perona pas zakonit per katilet, bi te bledhurit e tij me te shumtin njeres te pasur dhe te varfre, dhe as qe pushoj se beri trazira de tere Iudhene (Chifuterine) dyke bere vetjen e Tij te BIRE E PERENDISE dhe mbretin e Israilit, qellimezonte prishjen te Jerusalimit dhe te se shentes Kiske, dyke mohohur friken e Qesarit, dhe dyke kuturitur te hynje me lule, dafina dhe me madhesi dyke pasur dhe nje part njeres nga populli si donje luftethyenjes brenda de qytetin Jerusalem ne te shenten Kiske.

Per andaj urdherojme te parin dhe tonin kryeqindar Koidon Kornile ta shpjere de vendet te Jerusalimit te lidhur, dyke rahur, peshtelle me purple, kororezuar me kurore prej gjembash, dyke mbajtur kryqim e Tij be kuris, qe tu shembelleje terve sa bejne te liga, me kete shpini dhe dy kusare katile dhe dyke dale nga porta Ngaparola, tashi Antoniane. Mblidheni ate Krishtin de syte se tereve dhe ne malin te katilve i qyajtur Kallbari (I), ashtu i kryqjosur dhe i vdekur trup' i Tij be kryqin, dhe per te shikuaren te tere katilet, dhe sipre ni kryqin te vihet nje tittle, shkrojtur be tri gjuhe, Chifuche, Romanche, dhe Helinishte, Chifuche, "Gjesuna Nazori Meleh Geluntim, Romanche," "Jesus Nazoraeus Rex Iudaeorum" dhe Helinishte, (kthyer shqip) Jesuj Nazaretasi Mbret' i Iudhejnve." Dhe urdherojme qe as donje prej cillesdo radhe, soij a

ardhje, kuturise pa mentuare, te vonoje nje kesi soj gjyp, prej meje te urdheruare dhe perfunduare me tere drejtesine, pas votimit te ligjeve se Romanve si Chifut, de gjyqin te vetefajtorit te se Romaneve Mbretetise.

Deshmonjesit te kesaj kuturise Tone.

Per Sumfenderet dhe Gykatesit e Iudhejnve.

—Raban, Mandani, Benenrsol.

Per Farisejnte

—Barman, Simeon, Bonal.

Prej Mbretetise dhe Qeverise se Romanve.

—Luqio, Sekstilio, Masjemilio.

Per kritikanet te kombit Israil,

—Patam, Dhanijl, Sambinil, Jonao, Binikan, Patam,

Juavel Perikulam.

Prej Qryeshenterise.

—Rabam, Iudha, Bonkasoli Ligjetar se kesaj per

keqberesit.

—Ligjetor Betam.

Sich duket ketu Pilati ka shkrojtur de kuturine, si gjenche Jerusalmi, dhe cilit gjenchin atje de ate kohe te drames se Krishtit, dhe ketu na i provon Pilati vete me doren e tij qe Aleksandri i Math Shqipetar ka mbretetuare dhe de ato vise, dhe de kohen e Krishtit Iliriane (shqipetare) gjenchin atje, si dhe Sumfenderi Shqipetar Baleri Palisto, po lavdi Perendise qe as donje prej tyrve nuk u bashkuane me chifutet ne dramen e Krishtit. Sumfender d. m. th. njeri i larte, si Konsul, Ambasador dhe xhdo njeri mi larte de nje vend pas kombesise se tij.

Kjo libre gjenden Latinishte dhe sot ne Mosion e ZZ. Gesarini de Rome.

Chifutet si degjoane kete kuturine te Pilatit, zune ta goditen Krishtin, ca me rupa dhe te tjere me shtapijn, dhe te tjere e peshtynin, dhe dyke goditur i thoshin, Refena Krisht kush te goditi; dhe te tjere i binin be gjunje dyke perqeshur dhe dyke thene, gezohu, mbret' i Iudhejnve. Pa si bene dhe kryqin per Krishtin jadhane ati qe ta sjelle dyke mbajtur bi kurizin e Tij be vendin qe do kryqjoseshe. Po Krishti nga te rahurat dhe nga plaget si dhe nga rendesira e kryqit, nuku mundte te barase me, dhe nga qe deshin ta kryqjosin nje ore me pare, be udhe zune nje njeri i qyatur Simon prej Qyrine, ky po vinte prej arave me te dy djemte e Tij, Aleksin dhe Rufon, jadhane ati kryqin, jo se kishin meshire per Krishtin? po qe ta shpinte me pare, dhe te vinin ta kryqjosnin nje ore me pare. Pas ketyrve prej se largu po vinte dhe nje prej nxenesve te Krishtit, Joanni, tok me Virgjereshen Mari dhe Maria Magdhalini Martha, Sallomi dhe ca te tjera gra.

---

### GOLGOTHAJA

Kopeja qe kishin Krishtin arine be vendin me Krishtin dyke tallur dyke peshtyre dhe dyke rahur, ger de ate vend qe qyashe Golgatha dhe vend' i Kafkallave, be ate vend qe u be vrasja me frikshmjia dhe me e paudheta, prej te pabeseve Chifute, atje u derth ay gjaku i shente, dhe qe prej ati mbivi druri i fese se Krishterimit.

Virgjeresha bashke me shoqet dhe me nxenesin arine prane, po nga populli i shumte nuku mundnin te afroshin, dhe per andaj Shen-Maria me lotet ner sy, i luteshe popullit qe ti apin udhen dhe te shikoje te bir' e saj te emblin per heren e fundit, ate qe si donje shtere pa faj e shpinin ta theren.

De ate ore puna e gjakderdhjes kish mare fund prej Chifutve. Jesu Krishti ish mberthyere be kryqin, dhe katre Chifute te beshme po e shtorasnin kryqin qe ta ngulin dhe qe te qendronte bi dhene. Ushtaret Romane u mallengyene nga lotet e Shen-Marise dhe i apne udhe, dhe kur ajo ugend perpara kesaj tragetje dyke pare te emblin bir' e saj mberthyere be kryqin, dhe ay qe i shikonte Chifutet me nje emblesi si kur nuku i kishin bere donje te keqje, dhe si kur refente meshire te madhe per atá, dhe per te pavjeturin komb te Israilit.

Dyke gjendur perpara kesaj pamje Virgjeresha Mari, cfiliti dhe thiri me ze te dredhur.

“Mjer i embli biri jem, drita e syve tem, si mundet te duroj kur keshtu te shikojn Ty; Ajdeni popuij, dhe kombe shikoni dhe te degjoni, chuare te padrejte vdekje i japen birit tem, te pa vyejtyrit Chifute. Thuameni a de ka de tere boten tjatre nene qe te vuanje kaqe sa muva. Ku jane, evlati jem, te mirat, qe u bere Cgifutve; O komb i pabese dhe i pavyejtur? Thosh dyke cfilitur dhe dyke rene gjoksit te saj. Iudhejnte dyke degjoare keto, umunduane ta largojne q' andej, po ajo thirte: Vrameni muva me pare, o te paudhe Chifute, qe te mos shikoj kete te frikshme desmerim e tim biri.

De ate ninute, u degjua nje ze i emble, dhe i tha asaj: “Grua, ja biri tend.” Ish ay zeri i se emblit birit te saj, qe i jepte kurajo, dhe dyke refere Joannin nxenesin e Tij, dhe Joannit itha, “Ja nenja tende.”

Nuku degjovi as qe shikoj me Virgjeresha, se qe ate minute i ra zali, dhe ashtu e muare grat' e tjera me Joannin dhe eshpune lark Golgothase.

---

Iudhejnte si e mberthyene Krishtin be kryqin, zune gene ta goditen me rypa dhe ta perqeshen, dhe te tjerit po i ndanin robet e Tij me short, dhe ashtu mbusheshe fjala e Profetit: "I ndanin robet atá, dhe be robet vune short." Te peshturat dhe te sharat nuku kishin pushuare per Krishtin, dhe dyke thene. Gezohu o mbret' i Chifutve? dhe e goditnin me kallame.

Kaiafa bi krye te Glykatesve dhe Farisejnve, qendronte atje prane dyke shikuare dhe kenaqjur per ato qe beshin per Krishtin. Dhe populli qe ta kenaqnin me shume Kaiafen, i thoshin Krishtit: Po te jesh me vertet bir' i Perendise, xbrit prej kryqit, qe tete besojme. Tetjere shpetove, tetjere, mjeke-sove dhe shume shpetove dhe vetjen tende nuku shpeton dot;

Jesu Krishti kur egoditnin me rypat i ngriti syte be qjellt dhe tha: "Ate, ndjei keta per kete mekate, se nuku dine sehc bejne."

Pas ketyrve kryqjosne dhe dy kusare njerin be te djathte, dhe tjatrin be te mengjer. Kete e bene Chifutet qe te nemberoshe Krishti si kusar, po dhe per kete kishin thene Profetet "qe dhe me te paudhit u fjalos."

Vaj o qe prish Kishen dhe de tre dit' e ngre gene, shpeto vetjen tende dhe xbrit prej kryqit, thirnin populli. Dhe kryepriftijnte thoshin me urtesi: Tetjere shpetoj, vetjen e Tij nuku mundet ta shpetoje.

Jesu Krishti i duroj pa renkim tere keto, dhe i luteshe Perendise qe ti ndejeje atá se nuku dinin sehc benin, dhe de mest te ketyrve Krishti tha: "U sendisa" (me pihet uije). Me njhere rendi nje ushtar Roman dhe mori nje sfyngyer, dhe si e vuri de uthull pastaj e vuri be nje kalam dhe jazgjati Krishtit te





KRYQESIMI I KRISHTIT



pije, po porsa juvu de goje sfyngyeri Krishti nuku pivi.

Qjelli zuri te eresohet dhe dykshe si kur do prisheshe githesia. Populli Chifut edhe po bertiste bi Krishtin dyke mbledhur pas ushtarve. Nje prej kusarve dyke mos duruare me, te dhemburat e tij be kryqin Gica i qyatur, pa si u mundua dhe e kthevi koken nga Krishti, ati qe i tha.

“Po te jesh ti Krishti, i biri Perendise, shpetoje vetjen tende dhe neve.”

Po tjatri kusar upergeq: Nuku ke frike prej Perendise; nuku shikon se pas pak do vdeshem, po shikon te tallesh; Dhe neve me te drejte pesojme, dhe na jepen tere ato qe beme, po ky peson pa bere donje te lige? Apo nuku shikon imjere djellin te eresohet; Dhe dyke kthyere nga Krishti i tha: “Kujt-ome o Zot, kur te vish de mbreterine tende.” Jesuj upergeq dhe i tha, Mete vertet, mete vertet te them qe sot tok me muva do te jesh de paraist.” Dhe ora ish gjashte kur nje eresir' e dendur e mbuloj dhene.

Chifutet u frikesuane nga kjo eresire dhe pushuane ato qe benin per Krishtin: po Glykatesit dhe Pleqte i kuraizonin atá dyke thene, qe eresira vjen nga dhemonet qe ardhe ti maren shpirtin keti gengeshtoprofetit.

Eresira mbajti tri ore, ger be nente, kur Krishti thiri me ze te math dhe tha. Ili, Ili, lama savahthani; d. m. Perendia jeme, Perendia jeme pse me le; “Kur degjoane keto atá qe ishin atje thane: le te shikojme dote vijnje Ilia, qe e thret ta shpetoje;”

Krishti, shikojti be qjellin dhe tha: u mbarua: Ate, ne duarte tende jap frymen teme. Dhe koka juvar dyke rene bi krahun e djathte.

Syt' e tija shikoane an' e mbane githesine, si dhe popullin Chifut, dhe ajo e embla e fundme esh-

ikoare, dukshe si kur thosh: Ate ndjei keta se nuku dini sech bejne.

Eshtja e vdekjes u ap be tere sa ishin atje kur dha frymen njerezidashesi. Populli Chifut qe ger tashi thirte dhe qe bente ter' ato, dykshe si i vdekur, dhe as qe nxirnin fjale me, po dhe as qe livisnin dot. Nje frike e padukur i kish pushtuare te githe, dyke mbetur kesi soj Chifutet, pernjeresh u ap nje drite e madhe be stere, dhe zjar dykshe qe prej lindjes ger be perendim, dhe dukshe qjelli si kur dote diqte tere boten, dhe pas pak u degjua nje egymuare e madhe, si kur do u mbiste tere githesia, po kete te gymuare e preu nje e tundur e dheut e pa zakonshme be tere dhene, dhe prej kesaj qe, gure u chane Kisha unda be dysh, vare u apne dhe shume prej shentoreve u ngritne dhe hyne de qytetin e shente, dhe u refene de shume njeresh. Iudhejnte dhe Romanet ushtare ufrikesuane prej ketyrve ngjareve dhe rane perdhe de Golgotha:

Pas pak si ardhe ner mend dhe pane qe bota nuku ish prishur dhe si u shkoj frika e pare, u ngritne dhe shume e besuane Krishtin qe vertet ish bir' i Perendise. Dhe kryeqindari Longino de shesht tha qe "vertet i bir' i Perendise eshte ay." Dhe si vajti de Pilati jatregoj te tera me frike te madhe.

Po dhe Pilati ish frikesuare prej ngjarjeve, se thame qe ngjarjet u bene be tere dhene, dhe ne tere boten, dhe keshtu Pilati urdheroj te mblidhen Chifutet, dhe Farisejnve dhe Glykatesve u tha qe te japen chkoqitje per tere keto nishane. Dhe atá jupergeqne dhe i thane qe nuku shikojne donje nishan dhe chudi, sa per eresiren i thane qe ka ngjare dhe tjeter here: Dhe juluttne Pilatit qe te rezohen dhe te urdheroje qe te varosen trupet e se vdekurve me qe te nesermengdhi-

heshe Pashke dhe nuku ish mire ti linin te vdekurit te varur. Pilati urdheroj kryeqindare qe te veje vete de Golgotha dhe te mbaroje ate sherbim. Ushtaret si pane qe kusaret nuku kishin vdekur akoma ja thyene kersite dhe i rezuane nga kryqet qe ti mbulojne, po Krishtit nuku ja thyene se kish dhene shpirt.

Po nje nga ushtaret e ngkuli shishin e tij de rebrat e Krishtit dhe pernjheresh dolli uije dhe gjak. Dyke ngjare tere keto de Golgotha, Josifi nga Arimathia, nje prej te fsheurit nxenes te Krishtit, po nuku chfaqeshe nga frika e Chifutve, dhe si bisetuanane fsheura me Nikodhimon per varimin e Krishtit, Josifi vajti de Qeveritari Pilat dhe julut dyke kerkoare trupin e Krishtit qe ta varoste.

Falma kete te huajne i tha me lotet ner sy Josifi Pilatit, kete qe Chifutet nga nakeri e kryqjose, dhe kete qe Iudha Iskarioti e tradhetoj, dhe nxenesit e Tij u perndane dhe nuku ka kush ta varose si i huaj qe eshte, dhe prej tjater vendi. Falma ate te lutem, se me ate une kisha shume dashuri dhe ashtu duva ta varos sich duhet, dhe per andaj i lutem madhesise dhe kryepushtetsise Tuaj qe te me mbaroni kete te mire. Pilati sefte nuku desh, po si e pa Josifin me lotet ner syte dhe se Josifi ish kondrollor, dhe mbesimplotes u kandis Pilati dhe i tha.

Ja ku ta fal kete te vdekur, dhe beje si te duash. Ahere Josifi i puthi peqijnte dhe duarte Pilatit, dhe me lotet akoma ner syte, po me zemre te gezuare rendi de Nikodhimi dhe jatha tetera, qe dhe Pilati qenka njeri i ndershshme dhe qe refente dashuri per Krishtin.

Nikodhimi vajti dhe blevi aloj dhe myrbe (livando) dhe si ardhi dhe Virgjeresha, Maria Magdhalini, dhe Salomi dhe te tjera gra, si dhe nxenesi Jo-

anni, dhe keshtu si e lyene me aloje dhe myrbe e peshtualle me charcafe te bardhe, dhe e varosne pas zakonit de nje var prej guri, qe e kish gati Josifi per shtepin' e tij.

Dhe Virgjerasha dyke cfilitur thosh: si mos tete qjaj, i embli biri jem, dyke shikoare ty pa drejt-esi te vritesh; si te rojn pa ty? o drita e emble; Mjer une? Mjer une? ku pushteti Tend, biri jem idhemsur; si e durove therjen pa drejttesi; si nuku dergove zjar prej Qjellit ti djegesh te pa vyejturit Chifute; dhe ti tani i vdekur per shpetimim e tyrve; si nuk' u cha qjelli te shikoje tere keto; po kenaqem prej djellit Tend se e nxiu dhene dhe shume chudira te tjera u bene, ato qe i pane dhe te paudhit Chifute. Si mos lebetitem biri jem, eshte ajo qe me tha Profeti Simeon, qe prej dyzet ditesh foshnje de Kishe te shpune: Sich gjendet zemra jeme tashi o biri jem, kush do mi pushoje lotet teme; Jo tjtatre po vetem ti, kur te ngjallesh sich parathe te treten dite.

Dhe Maria Magdhalini dyke qjare dhe ajo thosh: Degjoni, o popuij, kombe dhe gjuhera mbesoni chuare vdekje dhe si e vrane Jesu Krishtin dhe si e gykoane, te paudhet Chifute ate qe me mijra u beri te mira, degjoni dhe chuditi, dhe tere botes thyajuni. Po une vete dote shkoj per de Rome, de Qesari, dhe do ti them tere sa beri Pilati dyke bindur ne te paudhet Chifute.

Dhe si e varosne Krishtin, Josifi me Nikodhimon shkoane ne te tyrvet, ashtu dhe Joanni me grat' e tjera dhe me Virgjereshen.

Keto qe u bene prej Josifit si imbesuane Chifutet u drodhe: dhe Kryepriftijnte e thire Josifin dhe i thane: Pse i bere kesisoj varim Krishtit; dhe Josifi u tha atyrve: Se une e njova ate per bure te drejte dhe te shente ne tetera: dhe si u sigurova qe per

maker i bete de ay ato, per andaj e varosa me nderime. Kryepriftijnte, u zemberuane dh' e odhe Josifin de burk, dhe i thane ati qe te djele de mengjest dote vritesh dhe ti si ay.

Kjo dit qe u bene keto ish e Premte, dhe te Shtune de mengjest vane Chifutet de Pilati dhe i thane. Zot, u kujtuame qe ay genjeshtari qe ronte tha, qe pas tre ditesh do te ngjallet: mos vijne nxenesit e Tij naten dh' e vjedhin ate dhe e genjejne popullin me tatilla genjeshta: per andaj te lutemi ver njeres qe ta ruajne ate. Dhe Pilati u dha atyrve pese qind ushtare, atá qe e vulosne vare dhe e rojtne ger te Djele de mengjest.

---

### TE DY KUSARET

Njeri prej ketyrve i kish thene Krishtit: "Po te jesh ti Krishti i biri Perendise, shpetoje vetjen tende dhe neve." Ky kusar qyashe Gicha: dhe tjatri qe i tha Krishtit, "Kujtome muva Zot, kur te vijsh de Mbretetine tende," qyashe Dimash.

I pari ish me shume se pesedhjete vjet, dhe i dyti tridhjet' e pese, dhe mi riu u kryqjos be te djathte te Krishtit, dhe me plaku be te mengjer.

Ky me plaku eshte i njohur ner neve, se e pame dhe me pare, dhe se ky qe kur ish i vogle fare kish zene te vjedhe xdo gjera te vogla: Prindet e tij ishin te ndershme dhe te pasur dhe u munduane shume qe te mos e linte skollen ky djali, po be kot, ky si iku vete nga skolla, merte dhe te tjere pas, dhe shume here i rinte po te mos i vinin pas.

Nje dite mori katre bashkenenes te tij dhe iku nga skolla: Ky u refevi atyrve nje pate qe kish vjedhur dhe si vane be nje vend te fshehur e poqne dh' e engren. Kete e mbesuane Prindet e tij dhe

mbesonjesi i tij, dhe u qertua per kete po be kot gene as qe i solli donje dobi kjo.

Gicha ish pesembedhjete vjet de kete kohe, dhe pas pates qe vodhi mori dhe emrin Patok, dhe ashtu zu vidhte chuaredo gjera, dhe ato qe i bente naten, dhe pas pak e la qytetin dhe shkoj de per malet, dhe nga qe dilte vetem naten kish mare emrin prej shokve se tij kusare njeriu i nates. Ky eshte qe e zuri Iudhen kur vravi te vellane e tij, dhe qe desh ta mare pas, po e umbi nga shkakui i Irodhit sich pame me sipre.

Dhe kusari qe kish emrin Dimash, ay e kish nga i ati tij, dhe ky ish bashkoare me Jesu Krishtin dhe tjater here vjete te shkoara kesisoj.

Kur sillche Jesuj prej shen-Marise dhe Josifit de Egipt, qe te largohet nga kordha e Irodhit, de kufite te Egiptit gjenche nje Ushe (kalive) de nje te dendur pyll. De kete ushen kerkovi miqesi Josifi dhe Virgjeresha Mari, dhe i zot' i kesaj ushe ish de ate kohe ky kusari Dimash. Ky kusar i egre kur e pa Virgjreshen dyke mbajtur te shenten foshnje u chudit me bukurin' e saj dhe me shume nderime i shpuri brenda de ushet, dhe se shoqjes i tha: Kujdesu ti shikosh mire sa te munch keta te mirit miqte tone, dhe une dote vete per gja dhe per pak kthehem prape: me dyket se ajo Zonja eshte prej te ndershme famile, dhe duhet ti shikojme pasurisht.

Dhe Virgjreshes i tha: me vertet po te kish Perendia nene une dote thosha qe tine je.

Dimashi dolli me gezim te math se kish per miq kesisoj njeres de te papaqmen ushen e tij.

Gruaja e tij gatiti uije dhe Virgjeresha e lavi foshnjen e saj. Ay kusari kish nje foshnje me nje semundje qe qjande githnje: dhe si e lavi foshnjen Virgjeresha, me te qjara desh te laheshe dhe ajo



foshnja e asaj gruas, dhe ajo qe ta pushoje foshnjen mori pak uije prej ati qe lavi Virgjeresha foshnjen e saj, e lavi dhe ajo foshnjen dhe ajo pushoj se qjari, po chudia ish se nuku qjajti me, me qe me pare qjante nat' e dite.

Paspak ardhni dhe Dimashi me gjane dhe dreke e pasur jushtrua se huajve. Dhe dyke ngrene kusari e pyeti te shoqen per foshnjen ku eshte qe nuku degjohet te qjaje.

Dhe ajo i tha si u be dyke vazgoare: me duket se kjo e ndershmja Zonje eshte plot gezime prej se Lartmit, dhe per andaj foshnja jone u sherua.

Kusari u chudit kur e pa foshnjen e tij te sheruare dhe te gezuare, dhe nuku dinte si te tregonte kenaqesine de virgjeresha.

Dhe kur u kthye Virgjeresha gene ay kusar i percholli lark ger sa dualle nga vendet te liga dhe sa u afruane de vendet te Jerusalimit te mira, kusare i percholli me kenaqesi shume te madhe, dhe Virgjeresha i tha. Shko de qetesi dhe dofta koha per chperblim sa qe na bere neve.

Ay djali i kusarit qe u sherua mori mjeshterin' e s'atit, dhe kishin bere shume te liga bashke me njerin' e nates dene kryesine te Varavvajt.

Varavvaj ish nje me katili kusar i asaj kohe dhe kish bere te liga pa mase, dhe per andaj Pilati e nxori baske me Krishtin perpara Iudhejnve, dhe i pyeti cillin duani te leshoj pas zakonit te Pashkeve Varavvane apo Krishtin, dhe ay besonte qe Chifutet dote kerkonin mbajtjen e Varavvajt pas se ligave qe kish bere, po jo, se u genye, se Chifutet nga nakeri i aruane te ligat e Varavvajt dhe ashtu e lesuane ate.

Dhe Dimashi eshte ay qe e besovi Krishtin dhe

i tha be kryqin: "Kujtome Zot kur te vijsh de Mbret-  
erine tende.

---

### CHENGELI

Akoma pa shpene Krishtin de Golgotha qe ta kryqjosen po porsa mbesovi qe u gykua per atje, nxenesi genjeshtar Iudha ati qe satanaj i kish hyre de zemret ay qe e tradhetoj me te puthur, dhe ay qe mori tridhjete ergente si chperblim, rendi gene de Kryepriftijnte dhe Pleqte atá qe ishin akoma de Kishe, dhe si hyri brenda u tha: Umekatosa dyke dhene gjak pafaj: Dhe bera shume liksh: merni prape ergendet qe me dhate per ate pune. Kryepriftijnte dhe Pleqte upergeqne. Chke me neve; ti shkaketon. Si degjoj keshtu Iudha, dhe shikoj qe Mbesonjesin e hoqne per de Golgotha, i flaku te hollat de mest te Kishes dhe shkoj me nxitim.

Kryepriftijnte i muare te hollat po nuku deshin ti vene de arket se ishin prej gjaku, dhe si bisetuane vendosne qe te blene me ato te holla aren e Qeramix-iut, dhe de ate te varosnin te huajte: dhe qe ahere ajo ara ka emrin ara e gjakut.

Iudha si dolli nga Kisha, dyke rendur dolli dhe nga qyteti, dhe si vajti dene kodren te Golgothase ne gradinen Gesthimani, atje be nje dru dhe be nje dege si chengel odhi nje litar dhe u var.

---

### VDEKJA E RAHILIT

Virgjeresha dyke lebetitur dhe qe ra perdhe sich pame me sipre kur e pa Krishtin be kryqin, dhe si u muar prej grave te tjera dhe prej nxenesit, pas-pak kish ardhur ner mend dhe eresira ish eqjur, per kete eresire qe i dituri prej Athine Dhionisi kur e pa

tha. "Panjohur peson Perendia, për andaj shuahet dhe dridhet githesia."

Dhe kur po varoseshe Krishti sich pame me sipre, nje grua me leshrat leshuare, dhe me roba te chara, dyke lojtur duarte dhe dyke thirur me ze te lebetitur thosh. Ndimomeni muva, meshiromeni jam nje grua pa fat jam nje grua fatzeze, une qe nuku bera donje faj kure, po pse te jem kaqe fatkeqe; Te githa gjarpijn me duken perpara, oh un' e zeza? Perendia jeme, pse tetera te keqihat de muva; une nuku i bera donjej te lige; pse fati jem te jete kaqe i zi; Dy ushtare Romane kur degjokane keto zerat te kesaj gruaje menjhere rendne atje: mos me afroj muva, jam fatkeqe jam e mallkuare pa faj, rendni atje prapa ati drurit dhe atje do ta gjeni te varur, dhe te vdekur? rendni de kerkoni ate dhe mos me trazoni muva. Nuku kam faj as per gje dhe pa faj mundohem.

Keto te thirurat e kesaj gruas i degjoj dhe Virgjerasha dyke kthyere nga varimi i se birit me zemret te chopetuare. Cheshte; u tha atyrve qe kish pas: degjova nje grua te theresse dyke lebetitur: paska dhe tjatre grua me zemre te choptuare si muva: Rendne dy gra dhe nxenesi Joanni dhe e ngritin ate, dhe e njoane qe ish Rahili e ema dhe e shoqja e Iudhes ajo qe e kish gjetur ate te varur dhe te vdekur.

Virgjerasha si mbesoj cilla ish ajo grua, i aroj te dhemburat e saj, dhe zu i jepte kurajo asaj gruas se tradhetorit. Korajo i tha dhe Perendia dote sherroje plaget tende: Rahili si mbesoj qe ajo gruaja ish e ema e ati qe u kryqjos de Golgotha, dhe qe shkaku ish i biri Iudha, ra e vdekur perdhe po me fjalet te embla te Virgjereshes de buzet e saja.

---

## KRYE IV.

### NGJALLJA

Pas mezit se nates te Shtune dyke gdhire e Djele atá qe ruanin vare te Krishtit ushtaret kupet-uane dhene te tundet dene kembet e tyrve, dhe pas-pak pane drite te madhe te xbrese prej qjellit, kjo drita ish kaqe e madhe, sa ja u zuri syte atyrve, dhe as qe shikonin dot, as qe iknin as qe fjalosnin fare nga frika.

Si shkoj drita u ngritne ushtaret, dhe kur shikoane be varin qe kapaku prej guri ish eqjur, dhe qendronte bi ate nje engijll me roba te bardha, dhe te dy grave qe ishin atje prane u thosh: Chkerkoni; Jesune te Kryqjosur; nuk' eshte ketu: u ngrit sich tha. Eani shikoni vendit ku ish Zoti.

Kryeqindari dhe ushtaret e tij u chuditne dhe u manitne per keto.

Grate me gezim te math vane tu thone nxenesve te Krishtit per Ngjalljen.

Chifuti Enea kesisoj e shkruan Ngjalljen e Krishtit. Si u gdhi e Djele, bene mbledhje Krye-priftijnte e Chifuteve me te tjerit, dhe dergoane ta nxjerin Josifin qe ta vrasen ate. Kur apne dyerte te dergoarit dhe nuk' e gjetin Josifin brenda u chuditne, qe si ka ikur kur dyerte jane te mbyllyra. Dhe dyke qene te bledhur Chifutet, nje prej ushtarve qe ish kur u ngjall Krishti, hyri brenda dhe u tha: Mbesuate se u ngjall Jesuj;

I thone ati Chifutet: Si; Dhe ay u tha: dheu u tunt per se pari, dhe nje Engijll xbriti si shkrepe-time prej Qjellit dhe e hoqi kapakun e varit, dhe



NGJALLJA E KRISHTIT

qendroj bi ate, dhe neve te githe u beme si te vdekur, as qe livisnim, as qe fjalosnim as qe iknim dot, po vetem degjoame Engijllin tu thote dy grave qe kishin ardhur atje, shikoni, ate qe kerkoni u ngjall, shkoni i thuani Petrit dhe nxenesve te tjere qe ta bashkonje de Galile.

Iudhejnte si degjoame keto, u thane ushtarve: cillat ishin ato gra qe ardhe de vari; dhe pse nuk' i mbajtte; ushtaret u thane: nga frika dhe nga pamja e Engijllit nuku mundnim te fjalosnim as qe te livisnim. Dhe Chifutet thane: ron Zoti Perendia e Israilit, dhe asnje besojme nga ato sa thuani: Dhe ushtaret upergeqne: Me tere keto chudira sa beri Ay Jesuj qe me pare, dhe nuku e besuate, dhe si dota besoni tashi; po mire thuani qe, ron Zoti Perendia, se dhe ky ron, ate qe jyve e kryqjoste.

Po neve degjoame dhe kete, qe ay Josifi qe e kishit mbyllur de burg, dhe kur apte dyerte nuk' e gjtte mbrenda, sillnani Josifin pa dhe neve do tu sjellem Krishtin. Dhe Chifutet u thane: Josifin ate qe iku nga burgu? ate e gjeni de Arimathi de atdhen' e tij. Dhe ushtaret u thane: Dhe Krishtin Ay qe u ngjall nga vari eceni de Galile dhe atje do ta gjeni Ate, sich u tha Engijlli grave.

Nga keto fjalet te ushtarve Iudhejnte u frikesuane shume, dhe atyrve u thane: Jyve do te merni te holla prej neve, po mos thuani te ketilla fjale jashte, po vetem te thuani qe sich flinim, ardhe nxenesit e Tij naten dhe a vuadhe prej varit. Dhe ushtaret upergeqne: kemi frike prej Qeveritarit Pilat se mos mbesoje qe muarme te holla, dhe mjer neve pastaj. Dhe Kryepriftijnte u thane: merni jyve keto, dhe beni sich themi neve, dhe neve u zotohemi, qe jo jyve po neve do ti japim chpengim per keto Pilatit. Ahere ushtaret muare te hollat, dhe

thane jashte sich u urdheruane prej Kryepriftijnve, ajo fjale qe mbahet edhe sot de per gojat e Chifutve.

Paspak ditesh ardhe prej Galileje de Jerusalim tre njerës, njeri prift i qyajtur Finees, tjatri Levit i qyajtur Anqeo, dhe tjatri ushtar i qyajtur Adda.

Keta ardhe de Kryepriftijnte, u thane atyrve dhe popullit: Jesune ate qe e kryqjoste jyve, neve e pame ate de Galile me te njembedhjete nxenesit e Tij sipre de malt te Ullijnve dhe atje i mbesonte nxenesit e Tij dyke thene:

Shkoni de per tere boten dhe chkoqitni Ungijlle dyke thene: Ay qe me beson dhe pagezohet shpeton: dhe ay qe nuk' me beson gyqmbahet: neve e pame ate dhe ishin dhe peseqind te tjere qe e pane kur fjaloste. Kryepriftijnte si degjuane keta te tre njerës thane: jepni lavdi Perendise dhe pendohuni per sa thuani, se genjeni: ron Zoti Perendia me atret tone Avraam, Isaak, dhe Jakov, dhe neve nuku genjejme po themi te drejten u thane atá: Ahere Kryeprifti si u dha te holla i vuri me be qe te mos i thone popullit per ngjalljen e Jesu Krishtit.

Po me qe u mblloth shume popull de Kisha dyke mbesuare ngjalljen e Krishtit, dhe degjoshin zera dyke thene, Jesuj u ngjall nga vdekja, jyve pse e kryqjoste; Dhe Kryepriftijnte, u frikesuane se mos ushtaret qe muare te holla prej tyrve i nxuare de shesht porosit' e tyrve, dhe popullit i thane: O Iudhejn, mos besoni, sa u thone ushtaret, dhe qe xbritne Engijt prej Qjelli, se sich u dhame neve te holla ushtarve qe te mos thone te ketilla genjeshta, ashtu dhe nxenesit e Jesujt u dhane atyrve qe te thone se u ngjall nga vdekja. Bi keto Nikodhimi u pergeq: O djemt' e Jerusalimit degjoni: Profeti Ilia u ngit be Qjellit me karoche te zjarte: ska dyshim qe dhe Krishti u ngjall: Dhe une u them kesisoj: Duhet te

dergojme ushtarë de Galile, atje ku keta tre njerë  
thone që e pane atë me nxënësit e Tij, dhe si ta bas-  
kojnë atë ti kerkojnë ndjese për sa i bëme.

Kjo fjale u pelqeu tërë, dhe si xguadhe ushtarë  
i dergoane de Galile, dhe si vane atje nuk' e  
gjetin Krishtin po vetëm Josifin de Arimathi: Dhe  
ushtaret u shkrojtne Kryepërfijtë për keto, dhe  
atë si bëne mbledhje i shkrojtin Josifit kësajsoj.

Paqe bë ty Josif, paqe bë shtëpine tënde, paqe  
de miqtë tënd. Nëve pame që u fajtuame de Per-  
endia dhe de ty shërbëtor' I Perëndisë, për andaj të  
lutemi të vijsh këtu, dhe nër djemte Tënd: shumë u  
chuditme si ike nga burgu, dhe mirë bëre, se mëndje  
të ligë kishim për ty: të shpëtoj tashi ty Zoti nga  
duarte tona: po ajde tashi se ti je nderi i popullit  
tone. Kete letër e dergoane de Arimathi Chifutet  
më të shtatë ushtaret, atë që ishin dhe miqt' e Jo-  
sifit: Dhe Josifi si e lechiti atë, u gezua shumë dhe  
i shtrëvi tërëse ushtarë, atë që se bashku engren e  
pëne dhe lavderonin Perëndinë, dhe të nesërmen  
shkoane për de Jerusolim, dhe dyke afruarë shumë  
njerë duallë për të pritur atë dhe e puthnin.

Dhe Nikodhimi e mori Josifin bë shtëpin' e Tij.  
Të nesërmen e thirë atë Chifutet de Kishë dhe i  
thane: Jëpi laydi Perëndisë se Israilit dhe thyana të  
drejten: Pame që Krishtin e varose, dhe për andaj  
të mbajtme ty de burg, dhe kur dëshme të të nxjer-  
em që të të vrasem, ty nukë të gjetme atje, dhe u  
chuditme më kete, u frikesuame, dhe Perëndisë i  
luteshim që të të gjejme, dhe tashi të na thuash të  
drejten. Për keto upërqej Josifi kësajsoj.

Une që kur më hohtë de burg dhe tërë ditën  
të Shtunë dhe tëjtren natë, nukë mbeta pa falur as  
pak, dhe të Shtunë de mëst të natës kur shikoj de  
të katër qjoshtë të burgut nga një Engjill, dhe hyri



Krishti de burgut si shkrepetime, dhe une nga frika rashe perdhe: Dhe Krishti me zuri per dore dhe me tha: Mos u tremb Josif: Dhe pastaj si me mori me shpuri de vari, dhe une dyke pare charchafin thashe: i bekoare eshte ay qe vjen me emrit e Zotit: dhe jufala ati. Pasketyrve me mori Krishti per dore me gith Engijllit dhe me shpuri be shtepine teme, dhe me tha: Ri ketu ger be dyzet dite: Une do vete de nxenesit ti mbesoj atá si dhe per ngjalljen.

Si tha keto Josifi thire Kryepriftijnte: Neve pame qe ay ka nene dhe áte, dhe si ta besojme qe eshte Krishti; Upergeq nje nga Levitet dhe u tha: Une e pashe sojne te Krishtit, njeres te ndershme dhe punetore, dhe te provuare de porosit' e Perendise. Enjojta dhe plakun Simeon ay qe e mori ate be krahet e Tij de Kishe, dhe bideshmoj per te dyke thene. "Tani perleshoje sherbetorin tent, Dhekovot, pas fjales Tente me paqje, se pane syt' e mia shpetimim Tent, qe pregatite be suratin se githe popujve, drite per xbulimim te kombeve dhe lavdi per popullin Tent Israil."

Dhe Kryepriftijnte thane: le ti gjejme atá te tre qe e pane ne Malt te ullijnve, dhe i pyesem atá sigurisht, dhe ti veme me be, per tere te drejten.

Si ardhe atá te tre upergeqne dhe thane: ron Zoti Perendia e Israilit, e pame Jesune be Malin e ullijnve. Ahere Kryepriftijnte thane. E Shkrojtura thote: Bi dy a tre deshmore qendron xdo fjale: Dhe Josifi thote qe e varosi me Nikodhimin, dhe si te jet' e vertete qe u ngjall; U thote Josifi: po ay ngriti prej katre ditesh tjatrin, dhe si te mos ngrishe vete de tre dite; Dhe jo vetem Lazare ngriti po dhe shume te tjere de Jerusalem? Dhe le te tjerjt dofta nuk' i dini, po plakun Simeon dhe dy djemt' e tij, si dhe te dy te vellezerit, qe nuku ka shume qe i varoste dhe

tashi varet e tyrve jane te apur dhe te xbrazur, dhe atá te gjalle po shetiten de per Arimathe.

Ahere Kryepiftijnte u ngritne dhe shkoane bashke me Josifin, Nikodhimin, Pamaele, dhe te tjere dhe vane de Arimathe, atje ku i gjetne atá te gjale, dhe Josifi u fal dhe u pershendosh me atá: Dhe dyke mare dhe atá tok u kthyene de Jerusalem de Synagogit, dhe si i mbylle dyerte, Kryepiftijnte u thane atyrve: Duame qe te kini perpara sysh Perendin' e Israilit, dhe te na thuani te drejten dhe kush u ngjalli jyv nga te vdekuret. Si degjoane keto, atá te ngjallurit thane: sillnani ca karte dhe gluke: dhe si u sualle keto, njeri prej ketyrve shkrojti keto.

Zot Jesu Krisht, ngjallja e se vdekurvet dhe jeta e botes, ndrichona neve qe te chkoqitem Ngjalljen tende, dhe chudirat qe bere de Sketeret.

Neve ishim de Sketeret, ora mezinates, de ate eresire te patreguare, dhe pernjeresh ndriti si Djelli, dhe prej asaj drites u pame te githe njeri me tjatin. Dhe menjere Ata Avraam u bashkua me te tjerit dhe me Profetet, dhe me gezim te math thane de mest te tyrve: kjo drite prej drite se madhe vjen. Dhe Profeti Isaia atje perpara tha: kjo drite prej Ates eshte, dhe Birit, dhe Frymes se Shente, per ate qe parathashe qe de ate bote.

Dheu i Zavullonit dhe dheu i Nefthalimit: Populli qe shkante de eresire pa drite te madhe. Paspak ardhi nje asketi si prej shkretetire, Joann i qyotur ate qe e pyetne Atret, cilli je ti; Dhe ay u tha: Une jam dergoare nga Perendia qe te lajmeroj Sketeren per ardhjen e Birit se Perendise, sich lajmerova dhe boten per ate. Porsa degjoane keto Atret u gezuane shume. De ate gezim qe gjenchim te githe ardhi Satanaj dhe i thote Sketeres: Xdongrenes dhe i pangopur, degjo fjallet qe do them: Prej kombit Chifut

nje njeri i qyotur Jesu Krisht, dhe e qyan vetjen e tijte Bir' e Perendise, po ay eshte njeri, dhe me bashkepunimin tem e kryqjosne ate Chifutet, dhe tashi i vdekur, gatitu ta mbyllem ate ketu.

Un' e di ate qe ay njeri eshte sich e degjova te thote, i helmuare shpirti tem gjer be vdekje. Ky na beri shume te liga de ate bote, dhe kujdesu te jesh gati ta mbyllem se ay kish shume fuqi de ate bote dhe mjekesonte xdo semundje vetem me fjalen e Tij, dhe shume ngjalli.

Dhe Sketera u pergeq: Po sa i fuqishme eshte ky? dhe vetem me fjale i ben tere keto; Ahere po te jete keshtu sich thua asnje nuku mundet ti kondreshtohet atij, as qe ti dale perpara. Bi keto fjale te Satanajt dhe Sketeres, dolli nje ze i math prej Kryengijve, Engijve dhe Fuqive dyke thene:

Chkulni dyerte arkondet tone, dhe mbani dyert' e jeteve, se do te hynje Mbret' i lavdise: Si degjoj keto Profeti Isaia tha: Une kete e parapashe prej Frumes se Shente dhe skrojta: Do ngjallen te vdekurit, dhe do ngrihen te vareve, dhe gene u degjua ze chkulni dyrte arkondet tone dhe t.t.

Dyke degjoare Sketera kete ze per se dyti tha: Cilli eshte ky Mbret i lavdise; Dhe Engijt e shente thane: Zoti i fuqishme te se githave: Dhe pernjeresh dyerte te bakerta dhe xdo gje e shendoshe de Sketeren u bene trimka, dhe ashtu u liruane tere te vdekurit me atá dhe neve bashke dhe hyri Mbret' i lavdise: me njehere Sketera gymoj, mjer neve? Cilli je ti qe ke kaqe pushtet; dhe cilli je ti qe ben tere keto te mbedha; si njeri de pamjet dhe Perendi de punrat; Valle ti je Jesuj qe na thosh kryesatanaj, qe me vdekjen tende be kryqin do te trashegosh tere boten;

Dhe dyke hyre Mbret' i lavdise dhe e mbajti per leshrash Satanane, dhe dyke dorezuare Engijve

u tha: lidheni kete kuspull kemb' e duar, dhe pastaj jadha Sketeres dyke thene: mere kete dhe mbaje me kujdes gjer be te dyten dukjen teme bi dhene: dhe Sketera si e mori Satanane i tha: Beelzevul, trashegonjesi i zjaret dhe i mundimeve, armiku i Shentoret, per cillin shkak bashkepunove qe te kryqjaset Mbret' i lavdise; apo qe te vinje ketu dhe te na xveshe; ktheu dhe shiko qe as nje i vdekur nuk' eshte.

Bi fjalet te sketeres me Satanane, Jesuj xgjati doren dhe e ngriti Adhamin, dhe te tjerve u tha: Ejane me muva se me anen e kryqit prej druri ijni te gjalle, dhe ashtu i nxori jashte. Dhavidh dhe tere Shentoret si dhe Profetet te kenaqur per shpetimim e tyrve lavderonin Zotin qe i shpetoj prej fundit se Sketeres. Dhe Shpetimtari Jesuj e bekovi Adhamin de ballet dyke bere nishan' e kryqit, si dhe te tjere dhe pastaj mori te githe jashte Sketeres, dhe dyke dale prej Sketeres Atret te Shente me gith Krishtin lygeronin, dhe i thoshin ati: I bekoare eshte ay qe vjen me emrin e Zotit. Allyluia.

Dyke hyre de Paraist Jesuj i dorezoi Stergyshin tone Adham Kryengjillit Mihail, dhe dyke hyre de dyerte gjetme dy Pleq atá qe Atret tone i pyetne, cillit ijni jyve qe nuku paski pare Sketere; Dhe atá u pergeqne: qe njeri ish Enohu, dhe Profet Ilia. Si pane dhe kusare ate qe u kryqjos baske me Krishtin dhe ay qe i tha Krishtit prej kryqit se tij, kujtome kur te vish de Mbreterine Tende, Shentoret me ze te math thire: I Math Zoti Perendia jone, dhe e madhe fuqia e Tij?

Cilla Perendi e Madhe si Perendia jone?

Keto dhe te tjera pame dhe degjoame, dhe ndergoame prej kryengjillit Mihail, dhe u urdheruame qe te lajmerojme per ngjalljen e Krishtit, vame

me pare dhe u pagezuame de lumin Jordan pas porosise se Tij me te githe atá qe u ngjalle prej se vdekuresh, dhe dyke ardhur ketu te bejme Pashken e Ngjalljes, tani esht' e pamundur te qendrojme de Jerusalem, dhe qe tani shkojme, dhe le te jete ner jyve dashuria e Ates, dhe Zoti tone Jesu Krishti, dhe e Shenda Fryme me jyve te githe Amen.

Dhe si shkrojtin atá keto, gysmat jadhane Kryepriftijnve dhe gysmat Josifit me Nikodhimon, dhe menjehere u bene te pa dukur prej tyrve.

---

## KRYE V.

---

### QESARI TIVER

Imberator' i Romes Tiver kish mbesuare me pare per gjerat dhe punrat te Jesu Krishtit, dhe qe ay e besonte si nje Profet dhe jo sich deshin te thoshne Farisejnte qe ay kerkonte te mirte Mbretlerine, dhe atá qe e gykoane per vdekje. Dhe keto i kish mbesuare prej Qeveritarit se Iudhese kesisoj.

Degjova o Qesar, qe desheron te mbesosh keto qe shkruaj per nje njeri shume te urte i qyojtur Jesu Krisht, ate qe populli e shikon si Profet, dhe nxenesit e Tij si Perendi, dyke thene qe i biri i Perendise eshte, i ati qe beri Qjelle dhe dhene dhe xdo gjeje qe gjendet bi ate. Me te vertet o Qesar, degjohen nga ditesh chudira prej Tij. Ngjall te vdekur dhe sheron te semure vetem me fjalen e Tij. Eshte bure mesatar, i mire dhe i ralle de te pamit sa kushdo qe e shikon ndjen dashuri dhe si frike. Leshrat e Tija ngyre kachke edhur bi supet pas zakonit te Nazaretasve. Surati dhe tere pamja e Tij refen

nje nga me te rallit njerës qe ka pare ky vend: e veshtuara e Tij është si e vretur dhe ben frike se ka forcat bara me nje xirit prej djellit. Asnje nuku mund ta shikoje de syt dreq per dreq, dhe thone qe e kane pare te qjaje po kure te qjeshe. De fjalimin është shume i sjelle dhe xbukuron se është i bukur si e Ema e Tij, ajo qe është me bukura grua qe u duk de keto vise.

Po te jete se desheroni qe ta shikoni kete sich me shkrojte tjetre here, lajmerome dhe une do ta dergoj me njehere. Dhe tere de Jerusalem chuditen me diturin' e Tij dhe asnje nuku e di qe te kete mare mbesime prej donjej dhe cillido qe i afrohet kupeton qe mbesimet e Tija jane te ralla dhe qe s' i kane degjoare tjetre here. Baret xbathur dhe jo gje be Krye, dhe shume qjeshin me kete po kur gjenden perpara Tij tremben dhe chuditen me Ate, dhe me vertet sich me thone chifutet kure nuku kane degjoare si mbesimet e Tij, dhe shume prej tyrve e besojne Ate si Perendi. Te tjere gjene me thone qe është armiku Tuaj o Qesar, dhe shume me merziten keta te merzitur Chifute. Dhe thone qe ay kure nuku ka bere donje te lige per vech se mire. Te githe sa ju afroane Ati te mire gjetne? Po denë urdherit te Madhesise Tuaj jam o Qesar, dhe si te me urdheroni ashtu dote bejn.

## **Ne Jerusalem Indikton 7 Hena II.**

### **I Madhesise Tuaj i beses**

#### **Publi Lendul**

#### **Qeveritar i Iudhese**

Si mori kete letre Qesari Tiver, dhe pa qe qetësia mbreteronte atje, as qe e kerkojti Krishtin dhe

as qe i shkrojti Qeveritarit per ate. Po keto qe u bene de Golgotha ish e pa mundur qe ti degjonte si pa donje te keqe Tiveri dhe te mos i gykoje atá shkaketaret. Dhe ato i mbesoj kesi soj.

---

### MARIA MAGDHALINI

Pak me von prej Drames se Golgothase de Jerusalim, arijti de Rome nje grua ngaj Iudhea, ajo qe kerkoj te degjohet prej Imberatorit. Po Imberatori nuku e nqjasi: Dhe kjo gruaja e deshperuare nuku la njeri prej Pallatit dhe jashte qe te gjente shkleken dhe te merte leje qe te degjoshe de Imberatori po gene be kot. Me de fund gjeti nje shkleke dhe e perndori: mori ca veze dhe i ckuqi dhe jadergoj si dhurate Imberatorit Tiver: Ky kur i pa keto u chudit me te ketille dhurate qe nuku kish mare kure kesisoj dhurate, dhe me njehere urdheroj qe te dale ajo gruaja perpara Tij. Imberatori u chudit me bukurin' e asaj gruas dhe e pyeti cilla eshte dhe prej ngaj vjen: Jam nga Paleshtina u pergeq gruaja, prej njej fshati Magdhal se Galilese, dhe qyahem Maria, dhe dhurata qe te dergova eshte lyere me gjakun e nje se kulluari, ate qe e derdhe duarte Tende de Golgotha. Imberatori u droth ngaj fjalet te aspra se kesaj gruas dhe i tha:

Mjer ti po te mos chkoqitesh fjalen de kete chast. Vertet Qesar u pergeq gruaja me kurajo, me madhe e lige qe u be keto dite de Golgotha, atje ku u kryqjos mi Madhi Mbesonjes dhe Mjekes i xdo semundjeje, prej perfaqesonjesit Tuaj Pondi Pilatit, te cillit qe emrin pasketaj do t' jakujtojne me frike si dhe te mallkuarin emre te tradhetorit Iudha.

Une isha nje me mekatarja dhe me semura grua,

si nga trupi ashtu dhe ngaj shpirti dyke shkuare jeten ner mekata, dhe Ay Mjekesi i shpirteve Jesuj Nazaretasi me sheroj, ate qe pa faj e kryqjosi Qeveritari Pondi Pilat. Dhe Maria ja tregoj tetera nje nga nje te Krishtit. Imberatori Tiver e degjoj Marine me kujdes de te githa, si dhe per nishanet qe u bene kur dha shpirtin Krishti, dhe ate te tunduren e dheut dhe eresiren qe e kish pare dhe vete Imberatori.

Be te mbaruare fjalen te Drames Maria, hyri nje Oficer i Pallatit dhe i dorezoi nje letre Imberatorit pa si e sallutoj dhe i tha, eshte prej Qeveritarit Pondi Pilat.

Imberatori si e mori dhe e api, zuri ta lechite me ze qe te degjonte dhe Maria, me qe ish shkrojtur dhe ajo per kete shkak, dhe dukshe qe renkonte per bi Pilatin.

Pondi Pilat i vendeve se lindjes.

Me se frikshmit dhe me se madhit Mbret Tiver Qesarit dhe dhekovotit tem (dhespotit) gezim.

Prej keti kalamit me ngyre te zeze, po te lajmeroj per nje me te panjerezishmen Drame qe nuku ka ngjare tjetre here te vendet Tuja, a de donje tjetre vent te botes, dhe kete qe e pashe me syt' e mija, dhe ajo qe me sjell frike be shpirtin dhe be trupin tem.

Ner te shkoarat dite se Pashkes te Iudhejnve, de qytetin Jerusalem, tere populli me sualle nje njeri, ay qe qyashe Jesu, dhe shume te liga thoshin atá qe kish bere ay, po te githa ishin genjeshta, se ay pervech se mirave qe i beri te pa vyejturit popull Chifut as nje te lige nuk' i beri.

Dhe Pilati si kish shkrojtur ca nga chudirat dhe vrasjen be kryqin si dhe Ngjalljen e kish mbaruare letren dyke edhur fajne Chifutve, dhe i thosh qe keto



desha ti mbesosh Tine i Madhi Mbret dhe Dhekovoti  
jem. PONDILAT.

---

Pas lechitjes se letres, dhe me gjakun te tur-  
bulluare Tiveri i tha Marise Magdhalini.

Kjo uidis me fjalet tuaja. Shume mire?

Me kete te shkrojtur Pilati shkroan gykimin e  
tij. Qertimi i shkaketarve nuku do te jete lark.

Pastaj thiri tere njerezin' e Tij, te nalltit dhe  
oficeret e Romes dhe ja u lechiti letren e Pilatit, dhe  
te githe atá thane se ishin trembur prej asaj eresires  
qe u be me tere boten. Dhe Tiveri i zemberuare  
urdheroj te gatitet me vrap oficeri Rahaav, me dy  
mije ushtare, dhe si hyri de Glykatoren shkrojti  
kesisoj per Pilatin.

---

## TIVERI QESAR, DHEKOVOT, I PAMUNDUR DHE I FRIKSHME

---

### Pondit Pilat Qeveritarit se Iudhese

Me qe pa drejtesi votove per vdekjen e Krishtit,  
dyke pranuar deshurat plot naker te se liqve Chifute,  
dhe more prej tyrve dhurata per kete vrasje, per  
andaj dhe une urdheroj: Qe te vish i lidhur, dhe te  
me japesh chpengime per ate shpirtin qe nga  
mendja jote e dhe per vdekje. Po nga brudallesia  
tuaj nuku muarte ner sy as nje prej chudirave te  
mbedha te Tijat, po kuturiste ta jepni te vritet be  
kryqin kete te pafajshme chudiberes.

Tine i aspri dhe kundra njerezidashjes, i levrire  
dhe i feliqur, si kuturise per kete dhe te bashke-  
pranosh ne te felliquren mbledhje te Chifutve; dhe  
tu japesh pushtet qe ta vrasin ate dyke mberthyere  
be kryqin; Per andaj dhe per se shpeti duva te me

pergegesh, se as qe me shkrojte muva per kete ngjarje qe te maresh leje, po bere sich deshe, dhe tashi me shkroan ligesite qe bere.

Po ja ku me shkroan dhe mendjeshkurtesine tende, qe as prej Perendive nuk' i ke pare ato chudira, ato qe neve i lavderojme, dhe chudirat e ketij kure nuk' i kishe pare. O nga nakeri dhe ligesite tuaja? Si Perendi nuk' e pranuate, po si mjekes nuku mundnit ta pranoni; Une me te degjoare per ate, dhe thashe qe Ay, jo vetem qe S' eshte njeri po eshte Perendi.

Qe te ngjalle te vdekur dhe te sheroje prej xdo semundje, keto vetem Perendia mundet ti benje dhe jo njeriu. Cilli u degjoa donjehere, qe te ngjalle prej katre ditesh te vdekur dhe te ape syt' e se verberve; Keto nuk' i mbesova vetem nga letra tuaj, po edhe me shume nga nje grua qe ardhi ketu perpara ca ditesh, dhe ajo qe mi tha nje nga nje, si dhe per sjelljet tende, dhe per andaj eshte e pa mundur qe ti aroj keto dhe kete pa drejtesi. TIVER.

---

## QERTIMI

Te neserme oficeri Rahaav u duk perpara Qesarit, dhe itha qe dy mije nga me te miret ushtare Romane jane gati.

Tiveri si e lechiti letren perpara oficerit Rahaav, e vuri de pliko e mbylli dhe jadha oficerit te beses dyke thene.

Muarte masat per kete dergate te pa dryshuare dhe qe vetem de ty dhe de duarte tende e le kete kuturi dhe detyrohesh ta mbarosh. Duva te githe shkaketaret te mi sjellesh te lidhur, dhe nuku do pranoj as do nje shkak de mos u befte dhe te mbarohet kuturia jeme. Shkoni.

Oficeri dyke unjur e sallutoj Imberatore dhe dolli. Mblodhi ushtaret dhe ne dy ore u nis per de Jerusalim. Te nalltit e Jerusalimit Romanet si dhe Iudhejnte, bisetonin akoma per kete ngjarje, qe shume prej Romaneve kishin besuare. Ketyrve me fanatiket Chifute u thoshin qe ay nuk' u ngjall po nxenesit e Tij e vodhe trupin naten dhe mos e besoni: Dhe eresira u be si dhe tjatre here dhe nuku ka lidhje me vdekjen e Nazaretasit.

Bashke me Romanet ish dhe Pilati se dhe ay e besonte pa si ja tregojti tetera sa u bene be ngjalljen kryeqindari. Chudi? Chudi, per te chuditur eshte thosh Pilati, sich me tregon Kryeqindari, kesisoj pa endre dhe gruaja jeme. Drite te madhe pa kur flinte, dhe prej qjelli lygeronin: osana o biri Dha-vidh: "I bekoare eshte ay qe vjen me emrin e Zotit." Kete lygerim dhe drite pa dhe Kryeqindari me gith ushtaret dhe kjo eshte mystirioze.

Ne de ketilla mentime gjenche Pilati kur i shkrojti Imberatorit se Romes Tiver per vrasjen e Krishtit. Dhe sa vinte aqe po e pushtonte frika Pilatin dhe si kur i refeshe qe nuku do ti dale be te mire ky bashkepunim me Chifutet dhe qe derdhe gjakun e ati te pa fajshmit, si dhe frika e Imberatorit nuk' e linte.

Kur arivi Rahaavi de Jerusalim dhe me qe desh te mbaroje detyren e tij me besnikeri, dhe me qe kish frike ngaj donje kundreshtim i Qeveritarit Pilat, e ndavi ushterine me disa paganja, dhe vete Xbriti per ne Dertesën e Qeveritarit pa simori dhe katre Kryeqindare pas. Pilati i priti mire de odat miqesore, dhe si jadorezozj urdherin e Qesarit me vrejteshi i tha.

Helmohem se ky urdher mu ngarkua muva, dhe qe prej kesaj minute ijni dene pushtetsine teme.

Pilati nuk' u kundreshtua, po u degjua dyke peshperitur. Nuk' u genjeva prej frikes qe kisha.

Thirni dhe Kryepriftijnte Annen dhe Kaiafen te duken ketu i tha oficeri Pilatit. Me njehere u dha urdheri dhe Kryepriftijnte ardhe perpara Ravaavit ay qe u tha atyrve. Ne emrin te Qesarit Tiver ijni te zene, dhe dene mbajtje bashke me Pilatit, dhe njejt prej atyrve qe kish pas i tha.

Kjo dertese eshte dene pushtetsine tende ger sa te kthehem une, dhe as donje nuku do te fjaloset me keta zoterijn. Xbriti ne vorot, dhe kerkoj nje oficer. Ne ate chast po ngiteshe be shkallet Kryefortesari i qytetit.

Do dergojnja tu thrisnin i tha oficeri: muarte tere masat per qetesine te qytetit; kini gati ushtaret sich u porosita; apo mos mbesojne Chifutet dhe na bejne donje trazire; Se une duva te mbaroj urdherin e Imberatorit pa derdhur gjak. Mbeti te qete upergeq Kryefortesasi: dhe une per andaj ardha qe tu siguroj per kete. Tere ushteria Romane eshte gati me arme ne dore per xdo ngjarje, sich u fjalosme. De nje dite ishin zene te githe shkaketaret, dhe pastaj u leshuane ushtaret ne per shtepit' e Chifutve, dhe bene si muntne. Dhe pastaj si i muare shkaketaret lidhur u nisne per de Rome, po kur arine de Krit me gjemit' e tyrve atje vdiq Kaiafa dhe kur deshin ta varosen, dheu nuku e nqjasi po e odhi jashte, dhe atá te vendit si pane keshtu zune ithnin gure per bi ate, dhe keshtu u mbulua dene guret.

Te tjerit kur i sualle de Rome Qesari nuku desh ti gykoje po urdheroj ti peshtellen me nga nje lekure prej kau dhe ti lene ne djellin e beharit dhe nxetesiren, dhe dyke thare lekura atyrve u doalle zoret dhe kesisoj vdekja e tyrve nuku ish nga te emblat. Po Pilatin nuk' e vune ne lekure se per ate kish mare

masa vete per me duart' e Tija Imberatori, dhe ashtu urdheroj qe ta mbyllen de nje fortese jashte qytetit. Nje dite kish dale per gja Imberatori, dhe dyke ndjekur nje sarkadhe me chargun ne dore, Pilati e nxori koken prej afsanes (penxeres) dhe Imberatori ne vend qe ti binte sarkadhes, i hoqi Pilatit ay qe u godit de syt dhe vdiq.

Tere keto u bene prej Qesarit Tiver de Rome, pas ngjalljes se Krishtit, dhe keshtu atá qe e kryqjosne gjetne sich bene.

Keshtu si ky Chifuti Ennea i kesaj libre, ka shkrojtur dhe nje tjatre i qyojtur Josif, si dhe te tjere Chifute, po de Librat e Shente te Kishes, atje do te gjeni ato me te bukurat dhe me te emblat fjale te Shpetimtarit tone Jesu Krishtit.

---

### MITHENJE

Thame me sipre qe lechitesit do ti gjejne me te bukurat fjale te Shpetimtarit de te Shentat Libra te Kishes, se ndrushe neve dushe te mbushnim koleksione ajo qe na eshte e pa mundur sot.

Po dhe atá Lechitesit e kesaj Libre, qe nuku mundin te zgjaten me shume, le te shikojne de Libren e sherbesave, dhe do te gjeni "Symbolin e Fese" qe thote: BESOJ ME NJE PERENDI, ATIN E TEREFUQISHME dhe t.t. po ta lechitni kete me kujdes dhe ta chkoqitni, per vech se tjerave do te shikoni qe Krishti do te vijnje gene, po jo si kete here, dhe te jepet de duart' e Chifutve te kryqjoset, po do vijnje me tere Madhesin' e Tij dhe an' e mbane plot Engjesh, dhe qe te gykoje te gjallit dhe te vdekurit, dyke ndare si Bariu qe ndan dhente nga dhite. Dhente do ti vere be te djathte dhe dhite be te mengjer, dhe do tu thote atyrve be te djathte. Ajdeni

te bekoarit e Ates tem de Paraisin ay qe eshte gatur qe sefte per jyve dhe atje ku do te gjeni chlodhje dhe jeten e pa sosur se i semure isha dhe arthte me pate, i pa ngrene isha dhe me dhate engra, i xveshur isha dhe me dhate te vishem, de burg isha dhe arthte meshikoate: Dhe atá do ti thone: Zot, kur te pame te pa ngrene dhe te dhame te ash; kur te pame te xveshur, dhe te dhame te vishesh; kur te pame ne burg; kur te pame te semure; dhe arthme te shikoame; Dhe Zoti do tu thote: ato qe bete de vellaj tuaj i bete de muva. Dhe atyrve be te mngjer do tu thote: shkoni te mallkoare, de zjart te pa sosur de sketeren, se per djalle kini punoare dhe de ay te vini, se une i pangrene isha dhe nuku me dhate, uije me pishe, dhe nuku me dhate, dhe t.t. dhe atá do ti thone: Zot, kur te pame neve kesisoj dhe nuku te ndimoame; Dhe Ay do ti thote: ato qe nuk' i bete de vellaj tuaj nuku i bete as de muva.

Dhe kesisoj neve duhet ta kemi ner mend githnje ardhjen e Krishtit, dhe mos jemi si Chifutet qe perpara e kishin dhe nuk' e besonin, me gith qe lechitnin te shkrojturat e Profetve dhe qe ato u tregonin per ate.

### VEZET E KUQE

Pas zakonit qe xdo Pashke ckuqen veze, ca thone qe zakoni ka mbetur prej dhurates qe i dha Maria Magdhalini Imberatorit Tiver sich pame me sipre. Po neve dyshojme per kete, se pas Istorive te tjera qe kemi pare, na thone kesisoj.

Ate ditën te Djele qe u ngjall Krishti, dy gra vinin de Jerusalem te shesin veze me shportat e tyrve bi kurizet, dhe qe ato grate rezoshin nga nje fshat rotull Jerusalimit, dhe udhes njera i thote tjatres: Degjove gje per ate Krishtin qe e kruqjosne dhe qe kish thene se do ngjallet gene; Jo, u prgeq shoqja

e saj: Chudi? tha ajo tjatra, une degjova qe ay u ngjall? fjale te kota tha ajo, kur te ckuqen keto vezet qe kam de shportet ahere do ngjallet dhe ay, dhe mori fund fjala, dyke fjalosur per gjera te tjera. Kur hyne de Jerusalem dhe lesuane shportat perdhe de vendit qe te shesin vezet, njera prej tyrve mbeti me goje apur kur i pa vezet e saja te tera te kuqe, dhe shoqes se saj i tha: cheshte kjo chudi? muva me qenkan ckuqur vezet; Dhe ajo tjatra itha: me te vertet per te chuditur eshte, po dhe une kur te thase udhes qe ay Krishti degjova se u ngjall, ti me the qe jane fjale dhe kur te ckuqen vezet tende ahere do ngjallet. Tashi te lutem nem te kupetoj dhe une: nuku di si tete pergegem i tha ajo: dhe kur zune te shesin vezet, ajo qe i kish te bardha i shiti, po ajo tjatra qe i ishin ckuqur nuku i shiti dot dhe shkoane per de fshatin e tyrve dyke refere dhe kedo qe gjenin chudine.

### TE DY CIMKAT

Esht' e ditur qe Librat tona dhe Gramatiken na i doqne armiket qe kur se Shqiperia ra de duart' e tyrve, shkakun qe do ta thote Istoria Shqipetare. Po sot lavdi Perendise gjendemi de rilindjen dhe jo pak te perparuare. Po me gith perparimin gigand qe kane bere shqipetaret ger be sot, dhe de nje kohe kaqe te shkurter, neve desherojme qe te mblidhet nuke Konklude prej shtatedhjet' e pese veta nga me te diturit Shqipetare, dhe ata do ta xbukurojne dhe ta mbarojne Gramatiken tone, dyke mos aroare qe te jet' e derdhur Gramatika jone dhe jo e ngrire. Dofta nuku do te benim fjale ketu per keto, si dhe per keto qe do te themi me poshte, po te ish qe te mosna rendonin dhe neve te dy cimkat qe kemi pare de chesa libra shqip bi ene (E) dhe qe te kete kupe-tim tjatre me cimkat per sipre, dhe qe na ngjasen si

artikullat e Djellit de kohen e luftes qe po ti perkisnin politikes, Redaksia e Djellit ish e shtrengoare ti perkthende Engleshte me doemos, si dhe tere gazetate e tjera. Neve keto dy (...) cimka i gjejme te pa aresushme per Gramatiken tone, dhe me shume kur kemi shkronjat qe te zene vendin e kupetimit te se dy cimkave. Neve na duket si kur eshte ndare nga shoqjet dhe ka mbetur vetem be nje qjoshe dhe pa donje shkak shkronja (w) ate qe mundet ta ngulim ne radhet kesisoj pas mendjes tone.

Ne vendit qe te radhitem te dy cimkat (...) bi (e) duhet te radhitem (y) dhe be vendit te (y) te radhitem (u) dhe be vendit te (u) te radhitem (w), ajo qe dofta do tu duket si chudi Lechitesve te kesaj Libre, po neve si per shembell do te shkruajme njady radhe me poshte dhe duhet te kujdesi.

Po me pare se te shkruajme ato radhe na vjen mire te t'emi dhe per Librat e Shenta te Kishes njady fjale. Me gith qe I perndershmi Kryevathesi (arhimandhrit) dhe e pritmja shenteria e Tij, Dhekovot (Dhespot) Fan S. Noli ka bere ate qe nuku mundet ta beje cillido, de Perkthimet e Librave, neve desherojme qe te mblidhet nje Konklute jo me pakte se ajo qe thame me sipre per Gramatiket nga ata qe do ti japen ate emblesiren qe i mireton Librave tona te Shenta.


(y)                      Psthynje                      (u)                      (w)


Kyjo Libry me q' yshty e apra pyr neve, dofta do ty kety dhe donjy gabim, dhe me qy w shtup prej shtupit Engles, po neve do ta lemy ny gjukimin ty Lechitysve. Fjala mbesim a Mbesonjes qe kemi perdorur ne kete libre pas letratures se sotme duhet te jete mesim a mesonjes.

**Fundi**

SP. A. THOMA.









Deacidified using the Bookkeeper process.  
Neutralizing agent: Magnesium Oxide  
Treatment Date: April 2007

**Preservation Technologies**  
A WORLD LEADER IN PAPER PRESERVATION

111 Thomson Park Drive  
Cranberry Township, PA 16066  
(724) 779-2111



LIBRARY OF CONGRESS



00027419331

LIBRARY OF CONGRESS



0 021 102 366 1